



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTARI TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T. 8/17

Z. EDIRAMA

N/KRYETARI I K.K.T. 8/17

Znj. EGLANTINA GJERMENI

Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Z. LAVDRIM SHEHU

Miratuarme Vendim të Këshillit të Bashkisë

Nr. 1 Datë 10.01.2017

Kryetari i Bashkisë

Z. BASHKIM SHEHU

PLANI IPËRGJITHSHËMVENDOR I BASHKISË KUKËS

(STRATEGJIA TERRITORIALE)

Miruar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.8, Datë 08.02.2017

DPKZHT: **Z.VULLNET CIKA**

STUDIOKONSULENTE "P.A.N.G.E.A & A&I design"

DREJTUES PROJEKTI : URB. DANIELE RALLO Nr.Lic.3133

P. A. N. G. E. A.
Società Cooperativa Consortile
Raffaele Gerometta
Vice-President



Ministria e Zhvillimit Urban

Ministri

Eglantina Gjermeni

**Agjencia Kombetare
e Planifikimit te Territorit (AKPT)**

Drejtori

Adelina Greca

Bashkia Kukës

Kryetari i bashkise

Bashkim Shehu

DPKZHT

Vullnet Cika

Drejtuesi I projektit

Prof. Urb. Daniele Rallo

Koordinatori I projektit

Ark. Urb. Indrit Hamiti

Stafi kryesor

Urb. Raffaele Gerometta

Prof. Ark. Francesca Calace

Prof. Ark. Anna Bruna Menghini

Prof. Ark. Michele Montemurro

Dott. Paolo Trevisani

Ing. Franco Di Biase

Ing. prof.as Hektor Cullufi

Ing. Elettra Lowenthal

Ing. Lirije Shqyti

Urb. Lisa De Gasper

Ing. Edmond Leka

Ekspertet

Av. Shpetim Beqiraj

Prof. as. Enver Isufi

Ing. Alush Mehmeti

Ing. Lino Pollastri

Agr. Giovanni Trentanovi

Konsulentet

Prof. Roberta Belli Pasqua

Prof. Geol. Arjan Beqiraj

Geol. Roberto Giannini

Prof. Adem Hyseni

Soc. Sergio Maset

Geol. Leonardo Moretti

Prof. Ark. Frida Pashako

Prof. Giovanni Schiuma

Econ. Altin Sulejman

Stafi mbeshtetes

Ark. Carlo Angelastro

Ing. Michele Brombal

Ark. Alessandro Cariello

Ark. Suela Dragovoja

Ing. Silvana Gashi

Urb. Valeria Polizzi

Ark. Adriano Spada

Urb. Fabio Vanin

Urb. Anila Voj

Ark. Chiara Durante

Ark. Gianluca Iaia

Ark. Sonia Paciolla

Ark. Francesca Papa

Ark. Maura Pinto

Ark. Pervito Pirulli

Ark. Giuseppe Resta

Urb. Fabio Roman



Tabela e Permbajtjes

1	HYRJE	6
1.1	Lista e perpunimeve te Fazes 2	7
2	REZULTATET E ANALIZES DHE VLERESIMIT TE TERRITORIT	8
2.1	Parashikimet e planit kombetar	8
2.1.1	Objektivat, politikat dhe vizioni i Planit	8
2.1.2	Parashikimet ne lidhje me Kukusin	13
2.2	Analiza metabolike dhe vleresimi I territorit	23
2.2.1	Treguesit demografik kryesorë	23
2.2.1.1	Karakteristika te popullise :	23
2.2.2	Te tjera informacione Socio - ekonomike	28
2.2.2.1	<i>Gjuha</i>	28
2.2.2.2	<i>Perberja etnike</i>	28
2.2.2.3	<i>Besimi fetar</i>	29
2.2.2.4	<i>Prezenca e aftesive te kufizuara</i>	30
2.2.2.5	<i>Madhesia mesatre e familjes</i>	31
2.2.3	STATISTIKA JURIDIKE	33
2.2.3.1	<i>Veprat Penale</i>	33
2.2.3.2	<i>Dhuna ne Familje</i>	34
2.2.3.3	<i>Të burgosurit</i>	35
2.2.4	SHËNDETËSIA	36
2.2.4.1	<i>Sherbimi shendetsore</i>	37
2.2.4.2	<i>ARSIMI</i>	38
2.2.5	Bujqesia	42
2.2.5.1	Peshkimi	44





2.2.6	Turizmi	44
2.2.7	Industria Minerare	47
2.2.8	Sinteze e relacionit mbi trashegimine kulturore	48
2.2.9	Sinteze e relacionit gjeologjik	51
3	PROJEKSIONE DEMOGRAFIKE 2030	54
3.1	Te dhena socio-demografike	54
3.1.1	Dendësia	57
3.1.2	Përberja gjinore	57
3.1.3	Gruposhat	57
3.1.4	Koeficientet e varesise	59
3.1.5	Lindshmeria	60
3.1.6	Indeksi sintetik i fekonditetit	60
3.1.7	Vdekshemria	60
3.1.8	Popullsia urbane/rurale dhe migrimi I brendeshem	60
3.1.9	Emigrimi dhe migrimi I brendeshem	61
3.1.10	Tendenca demografike – Projektion 2031	62
3.2	SHËRBIMET PUBLIKE ose me PERDORIM PUBLIK	63
4	PERCAKTIMI I TERRITORIT NE TE 5 SISTEMET DHE ANALIZA SWOT	66
4.1	Sistemi Urban (UB)	67
4.2	Sistemi Infrastrukturor (IN)	70
4.3	Sistemi Natyror (N)	75
4.4	Sistemi Ujor (U)	77
4.5	Sistemi Bujqesor (B)	80
4.6	Tema emergjente dhe ceshtje te ngrituara	82
5	VIZIONI DHE STRATEGJIA TERRITORIALE	85
5.1	Parashikimet e detyrueshme te planit kombetar te integruara ne strategji territoriale	85



5.1.1	Aeroporti i Kukësit	86
5.2	Vizioni i të ardhmes për Kukësin	88
5.2.1	Objektivi Strategjik 1 - Një cilësi e mirë e jetesës në territorin e Kukësit	91
5.2.2	Objektivi Strategjik 2 - Një akses më i mirë në brendësi të territorit të Kukësit dhe vlerësimi i lidhjeve ndër-rajonale dhe ndërkufitare	95
5.2.3	Objektivi Strategjik 3 - Vlerësimi i qëndrueshëm i burimeve ambientale si në terma turistike dhe energjitike e minerare	100
5.2.4	Objektivi Strategjik 4 - Vlerësimi i zinxhirit të prodhimit bujqësor	104
5.3	Strategjia insedative	107
5.3.1	Sistemi territorial	110
5.3.2	Sistemi urban	119
6	PLANI I AKSIONIT	124
6.1	Matrica e prioriteteve dhe e investimeve të nevojshme	124
7	SKEDAT E PROJEKTEVE STRATEGJIKE	130





1 HYRJE

Ky raport zhvillon Strategjinë hapësinore të bashkisë së Kukësit duke nisur nga vlerësimi i analizës territoriale zhvilluar në Fazën 1 në temat naturaliste, kulturore, gjeologjike, hidraulike, socio-demografike, socio-ekonomike, infrastrukturore, të trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit të vendbanimeve . Analiza gjithashtu përfshin identifikimin e parashikimeve dhe strategjive të Planit Kombëtar për zonën e Kukësit, që do të implementohen në PPV të qytetit.

Riperpunimi kritik i të dhënave të dalësive ka dhënë rrugë për punimin e analizës SWOT mbi të pesë sistemet e caktuara territoriale të percaktuara në normativat urbanistike si strukturuese të parashikimeve të planit: sistemin urban (UB), sistemin e infrastrukturës (IN), sistemin natyral (N), sistemi i ujit (U) dhe sistemin bujqësor (B).

Relacioni paraqet si më poshtë :

- Një kapitull i parë në të cilin janë përmbledhur rezultatet e kerkimeve të kryera në fazën e parë;
- Një kapitull i dytë që identifikon, në sajë të analizës SWOT, potencialin, pjesët kritike, kufizimet dhe nevojat për pesë sistemet territoriale të përmendura më sipër;
- Kapitulli i tretë në të cilin përshkruhet strategjia territoriale. Në veçanti, strategjia insedative territoriale integrohet me strategjinë për 5 sistemet duke percaktuar objektiva strategjike, veprimet dhe projektet për zhvillimin e territorit në përputhje me identifikimin e nevojave dhe mundësive;
- Një kapitull në lidhje me projeksionet dhe vlerësimet demografike për 2030
- Një plan veprimi që paraqet pamjen e përgjithshme të projekteve të identifikuara dhe në të cilat janë paraqitur:
 - o Akse strategjike të Planit
 - o Objektiva
 - o Aksione
 - o Projekte
 - o Prioritetet dhe korniza kohore (afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë)
 - o Tipologjia e investimit (Publik, Privat, Mix)
 - o Vlerësim i perafert i kostove
- Për çdo projekt janë redaktuar disa skeda implementimi që percaktojnë (Bashkëngjitur.01) :
 - o objektivi i projektit
 - o përbajtja e projektit
 - o kritika ose nderlidhje me projekte të tjera eventuale





PANGEA

- aktoret ne terma te perfituesve dhe zbatuesve
 - koha
 - kostot
- Për projektet strategjike të shkallës urbane që marrin një rëndësi të veçantë, janë hartuar projektet e duhura pilote në të cilën është bërë i mundur dhe grafikisht zhvillimi i mundshëm në terma fizike dhe hapësinore (Bashkengjitur.02)

1.1 Lista e perpunimeve te Fazes 2

Me poshte gjendet lista e plote e perpunimeve:

A.PERPUNIMET HARTOGRAFIKE

Perp.01 – Fl. 1.1 Analiza dhe vlerësimi i territorit. Sinteze Plani Kombëtar	shkalla 1: 50,000
Perp.02 – Fl. 1.2 Analiza dhe vlerësimi i territorit. Gjendja e mjedisit	shkalla 1: 50,000
Perp.03 – Fl. 1.3 Analiza dhe vlerësimi i territorit. Sistemi urban	shkalla 1: 50,000
Perp.04 – Fl. 1.4 Analiza dhe vlerësimi i territorit. Sistemi Infrastrukturor	shkalla 1: 50,000
Perp.05 – Fl. 1.5 Analiza dhe vlerësimi i territorit. Sistemi Natyror	shkalla 1: 50,000
Perp.06 – Fl. 1.6 Analiza dhe vlerësimi i territorit. Sistemi Ujor	shkalla 1: 50,000
Perp.07 – Fl. 1.7 Analiza dhe vlerësimi i territorit. Sistemi Bujqesor	shkalla 1: 50,000
Perp.08 – Fl. 2.1 Vizioni Strategjik. Sistemi Urban 2030	shkalla 1: 50,000
Perp.09 – Fl. 2.2 Vizioni Strategjik. Sistemi Infrastrukturor 2030	shkalla 1: 50,000
Perp.10 – Fl. 2.3 Vizioni Strategjik. Sistemi Natyror 2030	shkalla 1: 50,000
Perp.11 – Fl. 2.4 Vizioni Strategjik. Sistemi Ujor 2030	shkalla 1: 50,000
Perp.12 – Fl. 2.5 Vizioni Strategjik. Sistemi Bujqesor 2030	shkalla 1: 50,000
Perp.13 – Fl. 3.1 Strategjia e ndertimeve. Strategjia Territoriale	shkalla 1: 50,000
Perp.14 – Fl. 3.2 Strategjia e ndertimeve. Strategjia urbane e kryeqendres	shkalla 1: 50,000
Perp.15 – Strategjia e ndertimeve. Albumi i Strategjise se ndertimeve te vendbanimeve kryesore.	

B. MATERIALI NARRATIV

- Perp.16 - Relacioni i Strategjise se Territorit
- Bashkengjitur.01-Skedat e Projekteve Strategjike
 - Bashkengjitur.02-Albumi e Projekteve Pilot
- Perp.17 – Raporti i Takimeve



2 REZULTATET E ANALIZES DHE VLERESIMIT TE TERRITORIT

2.1 Parashikimet e planit kombetar

Plani i Përgjithshëm Kombëtar përcakton kuadrin e referimit për të gjitha planet e hartuara në Shqipëri; në fakt, ai përcakton parimet dhe udhëzimet për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, duke vendosur supozimet për krijimin e kushteve territoriale për zhvillimin rajonal.

Përveç kësaj, Plani i Përgjithshëm Kombëtar përcakton kuadrin e përgjithshëm për zhvillimin e infrastrukturës publike kombëtare, dhe përcakton kushtet për ruajtjen e ekosistemeve dhe burimeve territoriale, nga ato nëntokësore në ato natyrore e kulturore, në lidhje me ndikimet e sistemeve urbane dhe të aktiviteteve ekonomike.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar drejton objektivat ndërsektoriale të planifikimit rajonal, dhe koordinon objektivat e zhvillimit të sektorial me efekt mbi territorin; së fundi, një funksion i rëndësishëm qendror që zhvillohet nga Plani ka të bëjë me kontrollin logjik në lidhje me udhëzimet dhe orientimet e perspektives së zhvillimit të hapësirës Evropiane.

Lidhja me dimensionin evropian të qeverisjes së territorit është perceptuar si një çështje shumë e rëndësishme, duke supozuar për të ndërtuar në mënyrë sa më të mirë marrëdhëniet strategjike me shtetet fqinje që lindin nga stabiliteti politik, por edhe bazat për krijimin e një platforme që lehtëson aksesin e fondeve të alokuara në kuadër të programit evropian.

Ndërsa për sa i përket qeverisjes territoriale në dimensionin e saj të brendshëm, plani zhvillohet në brendësi të një procesi me të gjerë reforme administrative e cila ka prodhuar një ridefinim të hierarkive territoriale mes qendrave urbane dhe territoreve, se cilave i korrespondon një unifikim dhe riorganizim mjeteve planifikimi hapësinor në shkallë të gjerë.

2.1.1 Objektivat, politikat dhe vizioni i Planit

Në nivel strategjik, Plani Kombëtar shpalos objektivat e mëposhtme:

1. Integrimi hapësinor në kontekstin evropian,
2. Përforsimi i konkurrueshmërisë ekonomike të Shqipërisë në nivel rajonal,
3. Sigurimi i integritetit fizik e territorial të peizazhit historik, kulturor, natyror dhe urban në të gjithë territorin kombëtar.
4. Rritja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës nëpërmjet promovimit të rritjes ekonomike, eliminimit të pabarazive hapësinore dhe heqjen e pengesave për qasje në infrastrukturë dhe njohuri.



Për arritjen e këtyre objektivave, plani evidenton direktivat e projektimit në nivel politik, të cilat kanë të bëjnë me:

1. Zhvillimi i infrastrukturave kombëtare të lidhjes me korridoret e transportit ndërkombëtar;
2. Zhvillimi i rolit të Shqipërisë si pikë lidhëse për infrastrukturat energjetike të rajonit të Ballkanit;
3. Zhvillimi i Sistemeve Urbane Inteligjente;
4. Mbrojtja dhe zhvillimi i burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore, edhe në aspektin e identitetit, duke përmirësuar aksesin dhe përdorimin;
5. Zhvillimi i sistemit të transportit multimodal që lidhet me qëndrueshmërinë dhe transportin e integruar, i cili mbështet zhvillimin territorial policentrik;
6. Zhvillimi i infrastrukturave energjetike funksionale në përdorimin e burimeve energjetike të ripërtëritshme;
7. Projektimi dhe zhvillimi i një hub-i për të integruar flukset që lidhen me komunikimet, transportin, energjinë dhe produktet ushqimore i cili do të mundësonte efektivitetin e korridoreve të përmendura në paragrafin 1.

Politika të tilla përshkruajnë "vizionin" e përgjithshëm të Planit, i cili shtrihet në nivele dhe fusha të ndryshme, duke mbajtur të forta dy referenca të kontekstit të cilit i asociohen dy shkallë diskutimi, njëra e lidhur me kontekstin e gjerë evropian, dhe të tjera me ato të hapësirës ballkanike.

Në rastin e parë, skenari i propozuar nga plani merr në konsideratë krijimin e lidhjeve të infrastrukturës kombëtare që lidhin Shqipërinë me rrjetin e transportit trans-evropian, duke synuar forcimin e lidhjeve strategjike të vendit me anë të disa korridoreve që do të zhvillohen sipas një arsyetimi multi-sektorial:

- Korridori gjelbër (Shkodër, Hani Hotit - Kakavijë ,Gjirokastër)
- Korridori Blu (përgjatë bregdetit)
- Korridori VII, i cili lidh Detin Mesdhe me Detin e Zi
- Boshti qendror Elbasan, Berat - Jug
- Rruga e Arbrit

Në kontekstin Ballkanik, Shqipëria ka qëllim për të zhvilluar centralitetin e saj në lidhje me tematika të ndryshme, ndër të cilat qendron **tema e energjisë**: Shqipëria është në fakt vend kalimi për korridore të ndryshme ndërkombëtare, të tilla si: Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP), Gazsjellësi Jonian Adriatik (IAP) dhe IAP i KOSOVES për furnizimet në Kosovë përmes unazës së Ballkanit Perëndimor (WBR), të cilave i shtohen funksionet e shkëmbimit tregtar dhe logjistik të kater



porteve kryesore shqiptare, nder te cilat ai i Vlores paraqitet me i rendesishmi ne frontin energjistik.

Plani evidenton gjithashtu pesë sisteme rajonale:

- Sistemi Urban
- Sistemi Bujqësor
- Sistemi Ujor
- Sistemi Natyror
- Sistemi i Infrastrukturor

Moto e sistemeve urbane është zhvilluar sipas një logjike "smart", pra e lidhur me rritjen e sistemeve urbane inteligjente, duke u zhvilluar ne baze te tre parimeve, zhvillimit policentrik, dendësimit të indeve urbane dhe gjithpërfshirjes.

Në fakt, plani evidenton një hierarki të qendrave urbane, sipas te cilave identifikohen profilet perkatese ekonomike me qellim per te zhvilluar potencialitetin ekzistues sipas perspektives rajonale.

Në fakt, këto strategji ballafaqohen me një fenomen që ka karakterizuar 25 vitet e fundit, pra migrimin progresiv drejt rajoneve të Tiranës dhe Durrësit , në kontekst më të përgjithshëm kemi spostimin e popullsisë nga zonat malore lindore drejt ultesires perendimore: ky është një proces që ka induktuar pabarazi të forta territoriale dhe ka dëmtuar cilësinë e jetës së zonave urbane të prekura nga fluksi i njerezve.

Per te zbutur pabarazine e krijuar, Sistemi Urban sipas Planit Kombetar propozon :

- 6 rajone ekonomike parësore
- 9 qendra kryesore primare
- 10 qendra të specializuara
- 42 qendra lokale

Zhvillimi urban policentrik, propozon një raport të ri mes zonave urbane dhe rurale, duke u fokusuar nga njëra anë në kontrollin e zgjerimit fizik të qytetit, për të penguar dendësimin e gjendjes ekzistuese, dhe nga ana tjetër në nje qasje më të mirë, mbi aksesibilitetin, multifunksionalitetin dhe komplementaritetin e zonave bujqësore dhe natyrore dhe te trashëgimnise historiko- kulturele; një pjesë e rëndësishme ka të bëjë me menaxhimin e ekosistemeve "urbane" dhe në mënyrë të veçantë me mbylljen e cikleve të ujit, energjisë dhe mbeturinave.

Sektori bujqësor prodhon 20% të GDP-së kombëtare dhe siguron punësim për rreth 50% të popullsisë aktive: sistemi bujqësor i identifikuar nga plani mbulon 40% të sipërfaqes së



përgjithshme të Shqipërisë, me 34% të tokës bujqësore të lokalizuar në luginat e lumenjve dhe 23% në zonat malore. Ky sistem territorial investohet në dy angazhime themelore të përcaktuara në Planin Kombëtar: atë të ndalimit të urbanizimit në zonat rurale dhe ai i promovimit të një modernizimi që kalon përmes krijimit të zinxhirit të furnizimit fitimprurës, të cilat ofrojnë produkte me një shkallë më të lartë përpunimi dhe rafinimi, por edhe përmes investimeve të cilat kanë për qëllim për të zvogëluar kostot e prodhimit dhe për të rritur cilësinë, përballë risive teknologjike, sidomos në aspektin e infrastrukturës dhe të teknikave të ujitjes. Pjesa e fundit, por jo për nga rëndësia, është integrimi me sektorët e tjerë (turizëm, transport, energji) dhe vlerësimi i tregut të produkteve tip, edhe nëpërmjet futjes dhe fuqizimit të markës "Made in Albania", në lidhje me prodhimet karakteristike (bimët mjekësore, arrat, ullishte dhe vreshta, perime tipike si dhe produktet përkatëse të tyre të përpunuara).

Sistemi natyror i Shqipërisë aktualisht karakterizohet nga prania e 15 parqeve kombëtare, 22 rezervave natyrore të cilave i shtohen peisazhe të tjera të mbrojtura, monumente natyrore, etj. Në këtë kontekst, plani angazhohet për të rritur përqindjen e zonave të mbrojtura natyrore (mbi 20% në rastin e zonave tokësore dhe mbi 15% në rastin e atyre detare), duke përmirësuar në të njëjtën kohë aksesibilitetin; në mënyrë të veçantë konsiderohet strategjik projekti i Rrjetit Kombëtar të çiklizmit, dhe i tre parqeve të Alpeve, Vjosës dhe Bunës.

Në mënyrë më të përgjithshme, drejtimi i përcaktuar nga plani është për të mbrojtur zonat natyrore të pakufizuara nga funksionet e tyre mjedisore, duke forcuar në mënyrë të veçantë korridoret lidhës përgjatë bregdetit, me funksione të ngjashme për ruajtjen e rezervave ujore.

Çështjet që lidhen me furnizimin me ujë, dhe në veçanti me aksesibilitetin dhe rindarjen e balancuar të burimeve në nivel kombëtar, shfaqen thelbesore në raport të planit që lidhet me sistemin hidrik, të cilat fokusohen si mbi kërkesat e kontrollin e tërheqjeve në lidhje me bujqësinë dhe industrinë, ashtu dhe mbi çështjet e burimet perkatese, si në rastin e shkarkimeve të mbeturinave urbane dhe shfrytëzimit intensiv të zhavorrit të lumit. Gjithashtu propozohen strategjitë ndërsektoriale në lidhje me fusha të tjera, si në rastin e zgjedhjes së luginave lumore si korridore kryesore ekologjike lidhese, të riorganizimit të sistemit të furnizimit me ujë dhe të infrastrukturës higjeno-sanitare, në lidhje me sistemin e ri hierarkik të qendrave urbane dhe nevojave të menaxhimit të qytetit.

Sa i përket sistemit të infrastrukturës, çështjet kryesore kanë të bëjnë me transportin dhe energjinë.

Në rastin e parë tema kryesore është ajo e krijimit të një sistemi të integruar multimodal, në fushën e transportit, në kuader të se ciles parashikohet realizimi i:

- 2 aeroporte të reja (në veri dhe jug),
- 3 stacione kombëtare intermodale (Fier, Elbasan, Berat),



- 10 stacione ndërkombëtare intermodale (Tiranë, Durrës, Leshë, Shkodër, Kukës, Pogradec, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë).

Ajo gjithashtu synon në zhvillimin e porteve të Durrësit, Vlorës, Sarandës dhe Shëngjinit, me funksione të ndryshme e të ndara ne brendi te secilit, duke filluar nga logjistika, energjia, peshkimi, turizmi.

Në të dyja rastet kemi të bëjmë me strategjitë lidhëse dhe plotësuese për sa i përket realizimit të korridoreve të mëdha te lidhjes evropiane.

Energjia konsiderohet si fushë kryesore per sa i perket realizimit te gazsjellësve ndërkombëtar, tregtise detare të lëndëve të para, por edhe për sa i përket efikasitetit energjitik (kursimit të energjisë, përdorimit të energjisë së rinovueshme, efizienzës energjetike, reduktimit të emetimit të CO2 në atmosferë), siç parashikohet nga Strategjia Kombëtare Energjetike 2013-2020.

Më në fund, plani synon të ndërtojë një strategji të zhvillimit rajonal në lidhje të ngushtë me programin evropian, duke u bazuar në identifikimin e:

- rajonet ndërkufitare;
- rajone ekonomike kombëtare;
- rajone të specializuara

Në veçanti rajonet ndërkufitare janë të prekur nga financimi IPA ndërkufitar, i cili për 2014-2020 do të sigurojë Shqipërisë 75 milionë euro ,për projektet në kufirin midis Shqipërisë dhe Greqisë (rreth 42 million euro), Shqipëria dhe Mali i Zi (rreth 12 milionë euro), Shqipëria dhe Maqedonia (rreth 12 milionë euro), Shqipëria dhe Kosova (rreth 8.5 milionë euro). Behet fjale per fonde të lidhura me projekte në fushën ekonomike, të lidhura me infrastrukturën rrugore, trashëgimnine natyrore, historike e kulturore, shëndetësinë, arsimin dhe kulturën.

Siç i përket rajoneve kombëtare ekonomike, zona e vetme që aktualisht mund të cilësohet si nje rajon i tillë i mirfillte është ai i Tiranë - Durrës, por Plani Kombetar percakton projekte strategjike për fuqizimin edhe te 6 rajoneve të tjera të rëndësisë kombëtare.

Në veçanti jane formuluar strategjitë në lidhje me projektet:

- Porta e Veriut (rajoni Shkodër, Lezhës dhe rajoni i Kukësit)
- Motori Qendror (rajoni ekonomik i Tiranës dhe Durrësit)
- Rajoni ekonomik i Vlorë-Berat-Lushnje-Fier
- Porta e Jugut (rajoni ekonomik i Gjirokastrës dhe Sarandës)



2.1.2 Parashikimet ne lidhje me Kukesin

Ne paragrafin e meposhtem do te pershkruajme permbajtjen e materialit hartografik me parashikimet per territorin e Kukesit dhe nje pershkrim te shkurter te parashikimeve te planifikuara ne planin kombetar.

Materiali grafik i analizuar me poshte vijon:

1. Vizioni
2. Energji – Industri
3. Mjedis
4. Mbivendosia Energji-Mjedis
5. Modalitet Hub
6. Infrastruktura Transport
7. Qendrat Hierarkia
8. Qendrat Nderlidhja Hapesinore
9. Qendrat Nderlidhja Motoret Ekonomike
10. Qendrat Nderlidhja Motoret Nderkufitar


VIZIONI



Parashikimet strategjike te planit nxjerrin në pah aksin ndërkufitar me Kosovën identifikuar mes Kukësit dhe Prizrenit, dhe ne vazhdim me Prishtinën.

Në Kukës evidentohet prania e një aeroporti (aktualisht jo aktiv), një qendër inovacioni, dhe një pol logjistik.

ENERGJI_INDUSTRI




Vihet re prania e dy stacioneve të mëdha hidroelektrike (nga të cilat një është në kufi me Kukësin) dhe katër nënstacioneve.

Gjithashtu e rëndësishme është dhe prania e depozitave të kromit dhe depozitave jo-metalike (mermer, gips), të cilat përfaqësojnë një nga burimet kryesore natyrore me të cilat është i pajisur rajoni.

Zona përshkohet edhe nga një shumëllojshmëri e linjave të transmetimit të energjisë, ndërmjet të cilave plani TAP dhe një linjë e transmetimit (aktualisht në ndërtim e sipër) që lidh centralin hidroelektrik qendror me nënstacionin fqinj.



MJEDIS




Shihet prania e zonave të mëdha të mbrojtura përgjatë kufirit, e cila është e lidhur me identifikimin në planin e përgjithshëm të zonave prioritare për zhvillimin e turizmit; gjithashtu e rëndësishme prania e një korridorit lumor dhe pyje, sisteme komplekse të kultivimit në afërsi të qendrave urbane dhe përgjatë rrjedhave ujore.


Në hartën që vijon, mbivendosja e dy temave të mëparshme thekson problemet e mundshme që lidhen me praninë e depozitave minerale dhe sistemeve për prodhimin, transformimin dhe trasmetimin e energjisë hidroelektrike të vendosura brenda zonave të mbrojtura.



MBIVENDOSJA ENERGI-MJEDIS



MODALITETET HUB




Kukësi është i konfiguruar si një qendër multi-modale: në fakt analiza e linjave që kalojnë territori tregon praninë e një aeroporti, rrugë të gjata që sigurojnë lidhjen "butë" në perëndim, me Shkodrën, dhe në veri, me Has, Torpoje dhe Valbonë.

Nderkohe egziston dhe një linjë transporti nepermjet liqenit nga Kukësi në Fierze e pastaj me poshte në drejtim të Pukës dhe Vaut të Dejes.

Lidhja me qytetet jugperëndim (duke përfshirë Lezhë, por edhe Durrës dhe Tiranë) është e garantuar edhe me anë të transportit automobilistik, me autobus dhe hekurudhe.


INFRASTRUKTURE TRANSPORT



Në hartë Kukësi është identifikuar si një nyje ndërkombëtare: duke menduar për praninë e aeroportit (nuk është ende në funksion) dhe vendosjen e rreth tre vendkalimeve kufitare në Kosovë (Zhub veri, Morinë-Vërmicë dhe Shishtavec në jug).

Kukësi përshkohet edhe nga (rruga nacionale), që lidh qytetet e mëdha bregdetare me Prizrenin dhe Kosovën, ndërsa rrugët interurbane janë të ndara përgjatë tre linjave që lidhin me Tropojën në veri nga këtu me qytetin ndërkufitar, me Shkodrën perëndim dhe jug me Dibren dhe vende të tjera qendra përgjatë kufirit lindor. Përgjatë këtij kufiri është lokalizuar edhe Brezi i Gjellbër Evropian (i cili kalon edhe në Diber Kukes): është një lidhje shumë e rëndësishme ekologjike, një nga shtyllat e rrjetit pan-evropian ekologjik, detajet e të cilit janë të bazuara në praninë e zonave të mëdha natyrore që u zhvilluan në mungesë të aktivitetit të vendbanimeve të njeriut që ka karakterizuar prej kohësh në "perden e hekurt", dmth kufirin fizik mes dy blloqeve të shteteve të kundërta. Gjithashtu përgjatë dy rrugëve kryesore drejt Shkodres dhe Tropojës shihet prania e "rrugëve të veçanta të lidhjes." Në afërsi të zonave të mbrojtura natyrore të vendosura përgjatë kufirit me Serbinë janë lokalizuar dy vende turistike të lidhura me zonat natyrore: Maja dhe Pashtrikut, dhe (mali) Korab.


QENDRAT HIERARKIA



Hierarkia e qendrave urbane qe del nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar parashikon një klasifikim prej katër nivelesh : metropole, qendra kryesore, qendra të specializuara, qendra lokale.

Kukesi hyn ne kategorie e qendrave kryesore dhe perfaqeson kryeqendren e nje rajoni ne te cilen eshte perfshire dhe Dibra. Kjo hierarki është vendosur nga lidhja e Planit të Përgjithshëm me sistemin e ndërlidhjeve dhe nga lidhjet ekzistuese territoriale mes qyteteve shqiptare.

QENDRAT NDERLIDHJA HAPESINORE




Harta e qendrave të ndërlidhjeve ilustron lidhjet ndërmjet qendrave kryesore, të specializuara dhe atyre lokale, duke theksuar gjithashtu dhe rrjetin e lidhjes me fshatrat e vogla (nënnjësi administrative).

Përveç këtyre lidhjeve, Kukësi duket i futur në një model të marrëdhënieve kryesore me qendrat shqiptare të Dibrës, Mirditës, Hasit dhe Tropojës, si dhe me qendrën kosovare të Prizrenit, e me tej me Prishtinë.



QENDRAT NDERLIDHJA MOTORET EKONOMIKE



Në lidhje me zbulimin e zonave motorike dhe fushave të specializuara të zhvilluara nga plani, Kukësi është së bashku me Tropojën fokusi i nje zone bipolare që përfshin një pol logjistik dhe tre zonat turistike, si dhe duke qenë një (potencial) zonë ekonomike, e cila lidhet me projektin strategjik te portes së veriut. Në veçanti, projekti i portes se veriut ndikon në gjithë pjesën veriore të vendit, përkatësisht në qarqet e Lezhës, Shkodrës dhe në veçanti në zonën e Kukësit dhe Dibrës. Projekti është përqëndruar në aksin Transport / Turizëm / Ekonomi dhe degëzohet përgjatë linjave te mëposhtme:


- fuqizimi i portit turistik të Shëngjinit dhe më në përgjithësi dhe i lidhjeve funksionale te Lezhës me rrjetin e qendrave lokale,
- artikulimi i rrjetit te gazsjellesve drejt Malit te Zi dhe Kosoves (serbise)
- zhvillimi i poleve bujqesore ne zonen e Shkodres , qe perfshijne qendra te transformimit industrial
- zhvillimi i turizmit në lidhje me burimet historike dhe kulturore te qendrave urbane dhe burimeve natyrore në lidhje me ekosistemet e malit dhe liqenit.

Projektet me vlere strategjike jane:

- Permiresimi i hyrjes ne lokalitetet malore ne kufirin ndewrmjet Shqiperise , Malit te Zi dhe Kosoves(Projekti Alpet)
- Zhvillimi i projekteve te bashkepunimit nderkufitar me Malin e zi te perqendruara tek turizmi dhe mbi dy nyje te reja turistike kufitare ne bune dhe zogaj

- Zhvillimi i projektit "Transporti i ujit" (Liqeni i Fierzes :rezerve ujore e parkut energjistik me nje vlere te madhe skenike natyrore)

QENDRAT NDERLIDHJA MOTORET NDERKUFITAR



Në lidhje me identifikimin e qendrave ndërkufitare, Kukës përfaqëson qendrën e aksit ideal me qytetin e Prizrenit në Kosovë.

Këto ndërveprime mund të përfshijnë qasjen në fondet IPA (bashkëpunime ndërkufitare), por mund të jetë gjithashtu pjesë e shkëmbimeve ekonomike, njerëzore, kulturore, ambientale të lidhura me politikën dhe qeverinë lokale dhe me partneritete të tjera të përcaktuara nga shoqëria private dhe civile.





2.2 Analiza metabolike dhe vleresimi I territorit

2.2.1 Treguesit demografik kryesorë

2.2.1.1 Karakteristika te popullsise :

- 1- **Numri I Popullesise ne renje – Gjate periudhes 1989- 2011, si rezultat I levizjeve te brendeshme te popullsise (migrimi I brendeshem), kemi pasur nje renje prej gati 40% te popullsise edhe pse rritja natyrore ka qene positive dhe prej me te lartave ne vend.**
 - **Ritmi I renjes se popullsise gjate dekadave 1989-2001 dhe 2001-2011 ka qene ne rritje : shpopullimi ka filluar ne periudhen e pare(89-01) por ka vijuar me ritme akoma me te larte ne periudhen ne vijim(01-11). Renja e popullsise I prek te gjitha komunat me perjashtim te bashkikese se Kukesit e cila ka regjistruar nje rritje te lehte.**
 - **Trendi I ndyshem I ndyshimit te popullsise midis zonave urbane dhe atyre rurale: Si rezultat I migrimit te brendeshem, popullesia rurale ka pasur renjen ndersa ajo urbane eshte rritur edhe pse fare pak! Migrimi ka pasur natyre te dyfishte: nga njera ane, banoret e zonave periferike migrojne drejt qytetit te Kukesit dhe nga ana tjeter, kemi nje migrim nga qyteti I Kukesit drej qendrave urbane kombetare (Tirana dhe Durresi) apo edhe jashte vendit. Si rezultat , popullsia rurale ka pesuar renje te ndjeshme , ne disa raste edhe mbi 80%, ndersa popullsia urbane ka pesuar rritje (qytreti I Kukesit +1%)**
- 2- **Dendesia mesatarisht e ulet , sidomos ne zonat rurale malore, Dendesine me te madhe e ka qyteti I Kukesit me 1222 banore/km2.**
- 3- **Popullsia urbane/rurale: Popullsia e zones se Kukesit ka qene dhe eshte kryesisht rurale. Duke filluar qe nga fillimi I viteve '90 kemi nje tendence evidente te reduktimit ne numer te popullsise si dhe levizje te popullsise nga fshati ne drejtim te qytetit, duke shkaktuar luhatje te ndjeshme te raportit popullsi urbane-popullsi rurale.**
- 4- **Perberja gjinore: Dominace e meshkujve me raporte gjinor mesatar > 105. Disa zona rurale kane raporte >110**
- 5- **Perberja sipas grupmoshave : Popullsia e Kukesit, eshte nje popullsi e re, me grupmoshen 15-64 vjec qe ze peshen kryesore te totalit te popullsise banuese, e ndjekur me pas nga grupmosha 0-14 vjec dhe ne fund te moshuarit Ky fenomen karakterizon te gjitha komunat.**



- 6- **Raportet e varesise:** Zona e Kukësit ka një koeficient të varesise se përgjithshme prej 54%, ku koeficienti i varesise se të rinjve ze peshën më të madhe ndërsa koeficienti i varesise se të moshuarve është relativisht i ulët
- 7- **Lindshmeria:** ka koeficientin bruto të lindjeve më të larta në shkallë vendi prej 14 lindje për 1000 banorë. Kjo zonë vijon të ketë norma të larta të lindjeve por sidoqoftë në rangje në krahasim me periudhat e mëparshme. Situata paraqitet e ngjashme në të gjitha komunat.
- 8- **Vdekshmeria:** Për shkak të përmirësimeve të mëdha në sistemin shëndetësor dhe në shëndetin publik, vdekshmëria ka pasur rënie të qëndrueshme për të gjitha moshat vdekshmeria luhet në intervalin 6-7 vdekje për 1000 banorë. Situata paraqitet e ngjashme në të gjitha komunat.
- 9- **Emigrimi dhe migrimi i brendshëm:** Kukësi është një zonë ku migrimi i brendshëm drejt zonave urbane është po aq i rëndësishëm sa migrimi ndërkombëtar. Kjo zonë ka pasur dhe vazhdojnë të kenë një shpopullim të fshatrave të zonave malore drejt qytetit të Kukësit dhe në të njëjtën kohë një spostim të brendshëm nga qyteti i Kukësit drejt qendrave kombëtare si Tirana dhe Durrësi. Siç e theksuam edhe më lart, flukset dalëse të popullsisë tejkalojnë ndjeshëm flukset hyrëse që do të çojnë në një reduktim të popullsisë në të ardhmenë. Kjo ka sjellë në një rangje të numrit të popullsisë, pavarësisht rritjes natyrore që rezultojnë pozitive.
- 10- **Trendi i popullsisë - Tranzicion demografik me një popullsi drejt plakjes :** Rangje e numrit të përgjithshëm të popullsisë në vitet në vijim si dhe ndryshim i strukturës së popullsisë si rrjedhojë e rritjes së numrit të lindjeve me ritme të larta dhe rritjes së jetegjatesisë si pasojë e përmirësimit të nivelit të jetesës
- 11- **Te tjera karakteristika socio-demografike**
- **Kombësia dhe pakica kombëtare:** Sipas të dhënave të censusit të vitit 2011, zona e Kukësit përbehet kryesisht nga shtetas me kombësi Shqiptare, ndërsa kemi një presencë minimale të etnive Maqedonase në Shistavec dhe Zapod.
 - **Gjuha e folur dhe pakicat linguistike:** Shqipja është gjuha që flitet nga thuajse 99% e popullsisë. Pakicat linguistike ekzistojnë por në raport me totalin peshë e tyre është mjaft e limituar. Pakicat linguistike kryesore kemi në Zapod dhe Shistavec (Gjuhe Maqedonase)
 - **Perkatesia Fetare:** kjo zonë rezultojnë me dominancë të theksuar të fesë Muslimane e cila historikisht ka qenë besimi fetar në pothuajse totalin e popullsisë. Në komunat Arren dhe Kolsh kemi presencë të besimit Katolik.





12- **Prezenca e aftesive te kufizuara: *Niveli mesatar I zones*** i popllsise qe me te pakten nje aftesi te kufizuar eshte 5.3%. Disa komuna, ndyshe nga te tjerat, kane perqindje me te larta se mesatrja e zones ne pergjithesi dhe per anomali te caktuara ne vecanti.

Lloji I aftesise se kufizuar qe mbizotron ne te gjitha komunat eshte anomalia ne ecje, e cila perben gati nje te treten e anomalive fizike prezente ne popullate. Me pas renditen kufizimet ne komunikim problemet ne kujtese ne kujdesin ndaj vetvetes dhe ne fund kufizimet ne degjim dhe ne shikim.

13- **Statusi civil , lloji berthamave familjare dhe madhesia mesatre e familjes**

- **Satusi civil:** dominon familja tradicionale patriakale dhe lidhjet farefisnore jane mjaft te forta. Fenomenet e urbanizimit si per shembul divorci apo shtyrja e moshes se martesës jane mjaft te kufizuar ne te gjithë zonën. Kjo vlen si per qendrat urbane po ashtu edhe per ato rurale. Siaps censusi 2011, mesatarisht 60% e meshkujve rezultojne te martuar dhe kjo perqindje eshte akoma edhe me e larte tek femrat.
- **Madhesia mesatare e familjeve** eshte 5.4 persona per familje. Kjo eshte nga me te lartat ne vend dhe vjen nga niveli i larte i lindjeve qe vijon te mbetet nga me te lartit ne vend, 14 lindje per cdo 1000 banore. Vihet re se zonat rurale kane madhesi mesatare me te larte se zonat urbane si dhe madhesia e familjes lidhet ne perpjestim te drejte me nivelin e jeteses dhe verferine.
- **Llojet e berthamave familjare:** Forma dominuese eshte cift I martuar me femije.
- **Familje me me shume se gjashte persona:** perbejne tipologjine dominuese ne pjesen me te madhe te komunave. Ne disa raste te vecanta regjistrohen perqindje mjaft te larta.
- **Kryefamiljar femer:** eshte nje forme jo e zakoneshme ne keto zona me perqindje relativisht te uleta.
- **Kryefamiljar pensionist:** Familjet ku kryefamiljari eshte pensionist perbejne nje pjese te vogel totalit te familjeve.
- **Cift me femije :** Nen ndikimin e vlerave te forta konservatore , familja tipike patriakale vijon te jete forma dominuese e organizimit familjar, me shifra qe ne varesi te komuave kane vlera nga 60-70%. Keto zona kane numer te larte te martesave si dhe moshe mesatare martesore me te ulet se mesatarje e Shqiperise, sidomos tek femrat.
- **Cift pa femije:** frekuence e ulet ne pergjithesi ne te gjitha komunat, zakonisht nen 10%. Mospasja e femijve vjen vetem si pamendesi fiziologjike sesa si zgjedhje ekonomiko-sociale apo menyre jetese.

14- **Statistika Juridike**

- **Numri I veprave penale dhe lloji I tyre:** Kukesi regjistron ne total 732 vepra penale per vitin 2014 dhe ka nje mesatre prej 8.5 vepra penale per 1.000 banore qe koicidon me mesataren e vendit (8.5). Peshen me te madhe , ashtu sikurse ne te gjithë qarqet e



Shqiperise, e zene aktet kunder rendit dhe standarteve te sjelljes me 71.3% te totalit. Ne vend te dyte per nga frekuenca vije krimet ne fushen ekonomike dhe finaciare me 10.8%, ndjekur nga krimet ne fushen e korrupsionit me 8.2%, ato ne fushen e droges 3.1% si dhe kunder personit 3.1% . Kategorite e tjera kane peshe specifike relativisht te ulet. Interesant eshte numri i ulet i krimeve kunder prones dhe i trafikqeve te paligjeshme.

- **Numri I te burgosurve dhe norma e ndyshitimit:** Kukësi është qarku me normën më të lartë prej 34,4 të burgosur për 10.000 banorë, vlerë kjo e cila është relativisht e lartë në krahasim me normën mesatare në rang vendi. Pësha e te burgosurve nën 18 vjeç është relativisht e ulet në të gjitha qarqet. Norma ndryshimit në numrin e të burgosurve : Në qarkun e Kukësit numri I te burgosurve për periudhën 2010-2014 është rritur me 80%! Kjo është norma e rritjes me e madhe në shkallë vendi dhe përben një element shumë të rëndësishëm në analizën e strukturës sociale.
- **Dhuna në familje:** Tendencën e raportimeve është në rritje nga viti në vit pasi raportimet e vitit 2014 janë pothuajse sa dyfishi I atyre të vitit 2010. Në qarkun e Kukësit, nga 349 raportime të dhunës në familje gjithsej gjatë 2010-2014, 18% janë raportuar gjatë vitit 2010, 13.7% gjatë vitit 2011, 17.6 % e tyre janë raportuar në vitin 2012, 22.4% në 2013 dhe 26.8% gjatë vitit 2014.

15- Statistika të Shëndetësisë:

Sherbimi shëndetsorë

Shumica e banorëve të Kukësit shërbimet bazë publike i përfiton në qytetin e Kukësit ku gjendet spitali rajonal i Kukësit I cili është qendra më e madhe që mbulon gjithë zonën.

- **Numri I shtreterve:** Gjatë viteve të fundit numri i shtretërve në dispozicion në spitale në shkallë vendi ra ndërsa në qarkun e Kukësit numri I shtreterve u rrit nga 39 në vitin 2009 në 43 në vitin 2013. Rritja e numrit të shtreterve nga njëra anë dhe pse fare e vogël sidhe ulja e numrit të popullsisë në mënyrë të ndjeshme nga ana tjetër, kanë bërë që raporti I shtretrve në spitale për 10.000 banorë në qarkun e Kukësit të rritet duke kaluar nga 39 shtreter në 2009 në 43 shtreter për 10.000 banorë në 2013.
- **Numri I poliklinikave :** Numri poliklinika ve ka mbetur I pandyshuar gjatë viteve të fundit. Vijnë të mbeten mesatarisht 2 poliklinika ashtu si në shumicën e qarqeve të Shqipërisë. Krahasuar me nivelin mesatar në shkallë vendi, për vitin 2013 kemi një poliklinike për çdo 43.222 banorë ndërkohë që mesatarja e vendit është 1 poliklinike për 62.986 banorë.
- **Numri I Qendrave shëndetsore:** Gjatë viteve 2009-2013 numri I qendrave shëndetsore është reduktuar duke zbritur nga 29 qendra në vitin 2009 në 27 qendra shëndetsore në vitin 2013. Krahasuar me mesataren kombëtare kjo zonë pozicionohet me lartë.
- **Numri I ambulancave:** Numri ambulancave ka ardhur në rritje edhe pse në mënyrë tepër modeste modeste, duke kaluar nga 118 në vitin 2009 në 125 të vitit 2013. Mesatarisht kemi



PANGEA

nje ambulance per 692 banore nga 733 ne 2009, nderkohe qe mesatrja e vendit ne 2013 eshte 1450 banore/ambulance.

- **Numri I konsultorit te femijeve dhe I gruas :** Situata rezulton thuaje e pandryshuar gjate te njetes periudhe, me 62 qendra ne 2013 nga 61 qe ishin ne 2009. Krahasuar me mesataren e vendit , ne vitin 2013, kemi nje konsultore per cdo 1394 banore nga 1380 qe eshte mesatarja kombetare.

16- Statistika Arsimore

- **Perqindja e analfabeteve** eshte relativisht e ulet edhe pse disa komuna kane vlera me te larta se te tjerat. Eshte rasti I komunave Kallis (4%), Zapod (3.98%), Topojan (3.5%) dhe Malzi (3.3%). Sidoqofte mesatarisht analfabetizimi eshte nen kuoten 2%.
- **Ndjekja e Arsimit:** *Ndjekja e arsimit fillor baze* eshte relativisht e kenaqeshme me shifra qe variojne nga 70%-85% ne pjesen me te madhe te Komunave. Mesatrja e viteve te arsimit eshte rreth 9 vjet. Kjo tregon qe pjesa dermuese e popullsisë ndalet ne arsimin 9 vjecar dhe nuk vijon me tej. Mjaft problematike rezulton ndjekja e *arsimit te mesem* sidomos ne ato komuna malore qe paraqesin veshtiresi komunikimi me perqindje shpeshhere nen 15%. *Arsimi universitar* eshte ne nivele mjaft te uleta ne pergjithesi.
- **Indikatore te Arsimit 9 vjecar:** Gjate periudhes 2009-13 indikoret e arsimit 9 vjecare tregojne per nje renje te konsiderueshme qe tregon shume per situaten demografike dhe sociale te zones. Konkretisht , *numri i shkollave 9-vjecare* ka rene me 21% gjate periudhes 2009/10-2013/14, ndersa *numri I mesuesve ne shkollat 9-vjecare* ka rene me 11% , *numri I nxenesve te regjistruar* ka rene me 20% dhe *numri I nxenesve te diplomuar* ka rene me rreth 9%. *Mesatrja nxenes per mesues* ne arsimin 9 vjecar ne vitin 2013/14 eshte 13 nxenes per mesues nga 15 qe ishte ne vitin shkollor 2009/10. Pjesa me e madhe e shkollave 9 vjecare , rreth 90% e tyre, ndodhen ne *zonat rurale* . Edhe numri I te regjistruarve dhe te diplomuarve ne zonat rurale eshte mjaft me I larte se ne zonat urbane
- **Indikoret e arsimit te mesem** ne pergjithesi kane ndryshuar pozitivisht. Gjate kesaj periudhe, *numri I shkollave te mesme* ka rene vetem me 1 njesi (nga 20 ne 19) ndersa eshte rritur *numri i mesuesve* (nga 222 ne 253). *Numri i nxenesve te regjistruar* ne arsimin e mesem eshte rritur me nje rritje prej 2% si dhe *numri I nxenesve te diplomuar* gjithashtu eshte rritur. Numri I te diplomuarve ne arsimin e mesem, gjate periudhes 2009/10-2013/14, ka regjistruar nje rritje te rendesishme prej rreth 33%. *Raporti nxenes per mesues* eshte rritur eshte ulur ne 22 nxenes per mesues ne 2013/14 nga 24 qe ishte ne 2009/10. Ne arsimin e mesem *mbizoterojne te regjistruarit ne gjimnaze* per te gjitha vitet me rreth 95% te te regjistruarve.
- **Mungesa e theksuar e ndjekesve te arsimit profesional** perben nje fakt shqetesues qofte nga pikpamja e kualifikimit te forces se punes por edhe nga e edukimit shoqeror ne



pergjithesi, pasi perqindja e atyre qe ndjekin studimet e larta ne pjesen me te madhe te komunave rezulton te jete me pak se 4%.

- **Arsimi i larte**(universitar dhe pas universitar): Me perjashtim te bashkise se Kukesit ku figurojne me arsim te larte 14.1% e popullise, pjesa tjeter e komunave rezultojme me perqindje minimale. Disa komuna malore si per shembull Arren, Bushtrice, Ujmisht dhe Surroj, arsimi universitar rezulton nen kuoten 2%. Ky fakt ka ndikim te menjehershem ne punesimin aktual por qe do te ndikoje negativisht edhe ne nje optike afatmesem dhe afatgjate ne punesimin e forces se punes.
- **Pjesmarrja gjinore ne arsim:** si ne pjesmarrjen ne shkolle ashtu edhe ne mesidhenje,te dy gjinite ndjekin te njetin trend dhe nuk rezultojne disbalanca gjinore. Numri i meshkujve eshte lehtesisht me l larte por sidoqofte ne linje me raportin gjonor te zones.
- **insitucionet e arsimit privat:** mungojne plotesisht! Mungesa e tyre eshte e kuptueshme duke pasur parasysh nivelin e te ardhurave per fryme dhe pjeses se dedikuar nga konsumi i familjeve arsimimit te femijeve.

2.2.2 Te tjera informacione Socio - ekonomike

2.2.2.1 Gjuha

Mbi 99% e popullise se zones se Kukesit flet gjuhen Shqipe dhe pakicat linguistike pothuajse nuk ekzistojne. Komunitete linguistike te ndyshme nga gjuhfolesit e Shqipes, gjejme vetem ne Komunat Shistavec dhe ne Zapod. Ne Shishtavec kemi presence te nje perqindje te vogel te popullise, rreth 2.7% e cila flet gjuhen maqedonase dhe ne Zapod perseri nje pakice linguistike maqedonase prej 1.3%.

2.2.2.2 Perberja etnike

Sipas te dhenave te censurit te vitit 2011, zona e Kukes perbehet kryesisht nga shtetas me kombesi Shqiptare. Nga grupet etnike prezente ne territorin Shqiptar, zona e Kukesit ka ne perberjen e saj kryesisht Maqedonas te cilet l gjejme me se shumti ne komunen Zapod me 11.7%, Shishtave ku perbejne rreth 8% te totalit (7.7%) dhe nje sasi mjaft te vogel ne Kukes (1%). Kombesite te tjera kemi ne Kalis rreth 1% te deklaruar me kombesi Greke si dhe ne Kukes e Surroj ku kemi presence minimale te Arumuneve dhe te Romeve.

Nr	Komuna /B.	Perberja Etnike					Gjuha e folur	
		Shqipetar	Greke	Maqed -onas	Arumun	Rom	Shqip	Maqedon.
1	ARRËN	96.8%	-	-	-	-	100.0%	-
2	BICAJ	77.0%	-	-	-	-	99.9%	-





3	BUSHTRICË	98.4%	-	-	-	-	100.0%	-
4	GRYKË ÇAJË	75.7%	-	-	-	-	99.9%	-
5	KALIS	73.4%	1.0%	-	-	-	100.0%	-
6	KOLSH	97.0%	-	-	-	-	99.7%	-
7	KUKËS	85.8%	-	1.0%	-	0.3%	99.6%	-
8	MALZI	90.2%	-	-	-	-	99.9%	-
9	SHISHTAVEC	68.3%	-	7.7%	-	-	59.2%	2.7%
10	SHTIQËN	72.1%	-	-	-	-	99.9%	-
11	SURROJ	90.0%	-	-	0.1%	-	99.9%	-
12	TËRTHORE	90.0%	-	-	-	-	99.9%	-
13	TOPOJAN	96.6%	-	-	-	-	100.0%	-
14	UJËMISHT	83.6%	-	-	-	-	99.9%	-
15	ZAPOD	79.4%	-	11.7%	-	-	80.1%	1.3%

2.2.2.3 Besimi fetar

Edhe sa i takon perkatesise fetare, sipas censusi 2011, kjo zone rezulton me dominace te theksuar te fese Muslimane ku ne shumicen e komunave rezulton mbi 90%. Perjashtime bejne komunt Arren, ku kemi rreth 4.5% te popullsisë qe eshte deklarur e krishtere e besimit Katolik si dhe ne Kolsh kemi 1.8% perseri katolik. Ka presence te besimit katolik edhe ne disa komuna te tjera por qe perqindjet jane marxhinale si per shembull: Surroj 0.27%, Malzi 0.2% , Bicaj 0.1% dhe Kalis 0.1%. Besimin ortodoks e gjejmë present ne Kalis por qe perfaqson vetem 0.6% te totalit. Ne Kalis dhe ne Ujmsisht kemi presence minimale te besimit Bektashi, respektivisht 0.12% dhe 0.06% .

Nr	Komuna/B.	Musliman	Bektashi	Katolik	Ortodoks
1	ARRËN	92.9%	-	4.5%	-
2	BICAJ	84.3%	-	0.1%	-
3	BUSHTRICË	97.7%	-	-	-
4	GRYKË ÇAJË	89.6%	-	-	-
5	KALIS	86.2%	0.12%	0.1%	0.60%
6	KOLSH	94.4%	-	1.8%	-
7	KUKËS	86.4%	-	0.4%	-
8	MALZI	90.6%	-	0.20%	-
9	SHISHTAVEC	90.0%	-	-	-
10	SHTIQËN	83.8%	-	-	-
11	SURROJ	85.0%	-	0.27%	-
12	TËRTHORE	90.6%	-	-	-
13	TOPOJAN	95.6%	-	-	-
14	UJËMISHT	97.6%	0.06%	-	-
15	ZAPOD	96.9%	-	-	-

**2.2.2.4 Prezenca e aftesive te kufizuara**

Kufizimet e aftesive te popullates jane nje element i rendesishem ne te kuptuarit e cilesise se nje popullate te caktuar, pasi ajo prek drejteperdrejte jeten e individeve te shoqerise. Shpeshhere prezenca e tyre pertej normave normale lidhet me standartine e jeteses, mungesen e kujdesit shendetesor, faktore ambiental natyror apo mundet te jene edhe derivate te veprimtarise njerzore. Nga ana tjetere, evidentimi i llojit te kufizimit dhe frekuences se tyre, luan nje rol vendimtar ne percaktimin e llojit, numrit dhe vendodhjes se insituteve te specializuara ne trajtimin e tyre. Hulumtimi i prezences se anomalive fizike ne individet e nje popullate eshte i rendesishem per te evidentuar frekuenca anormale ne menyre qe te analizohen faktoret potencialisht percaktues.

Nr	Komuna/Bashkia	Persona me te pakten nje naaftesi	Ne shikim	Ne degjim	Ne ecje	Ne kujtese	Ne kujdesin ndaj vetes	Ne komunikim
1	ARRËN	9.0%	12.5%	2.1%	37.5%	18.8%	16.7%	12.5%
2	BICAJ	5.6%	10.9%	13.4%	23.7%	17.0%	19.1%	15.8%
3	BUSHTRICË	2.5%	16.4%	4.9%	34.4%	19.7%	9.8%	14.8%
4	GRYKË ÇAJË	5.1%	10.6%	15.4%	27.6%	15.4%	13.0%	17.9%
5	KALIS	7.2%	13.4%	12.4%	26.8%	19.6%	14.4%	13.4%
6	KOLSH	3.1%	11.0%	11.0%	22.0%	17.6%	18.7%	19.8%
7	KUKËS	4.4%	16.2%	11.6%	32.2%	15.8%	13.2%	11.1%
8	MALZI	4.7%	12.1%	8.4%	33.2%	17.9%	18.9%	9.5%
9	SHISHTAVEC	10.4%	15.4%	14.4%	26.4%	16.7%	13.2%	13.8%
10	SHTIQËN	3.3%	15.1%	15.1%	19.2%	18.3%	16.4%	16.0%
11	SURROJ	3.9%	16.9%	13.8%	27.7%	18.5%	9.2%	13.8%
12	TËRTHORE	3.0%	7.2%	10.1%	31.2%	20.3%	14.5%	16.7%
13	TOPOJAN	5.8%	11.7%	12.2%	26.9%	17.3%	19.3%	12.7%
14	UJËMISHT	6.9%	7.3%	11.2%	25.7%	20.9%	18.9%	16.0%
15	ZAPOD	9.8%	12.7%	13.4%	28.2%	18.3%	13.4%	14.0%
	Mesatarja mbi popullsine totale	5.3%	1.6%	1.6%	3.4%	2.1%	2.1%	1.7%
	% e kategorise mbi totalin e kateg.		13.5%	12.5%	28.0%	17.3%	15.1%	13.7%

Niveli mesatar i zones i popllsise qe me te pakten nje aftesi te kufizuar eshte 5.3%. Ne rast se studjojmë prezencen e aftesive te kufizuara ne secilen komune, vihet re qe disa komuna, ndyshe nga te tjerat, kane perqindje me te larta se mesatrja e zones ne pergjithesi dhe per anomali te caktuara ne vecanti. Ne kete rast eshte e nevojshme te kryehen studime me te thelluara mbi arsyet e ketij fenomeni sidhe popullsia duhet asistuar me ndihme te specializuara ne trajtimin e tyre



PANGEA

Nje prej komunave qe rezultojne me frekuence me te larte te prezences se aftesive te kufizuara ne raport me popullsine banuese te komues eshte komuna Shishtavec, ku krahas numrit te larte te aftesive te kufizuar ne vlere absolute, eshte gjithashtu komuna ku shuma e te gjitha aftesive te kufizuara prezente ne populate eshte rreth 30%, si dhe popullsia me te pakten nje aftesi te kufizuar eshte 10.4%. Ne kete rast, peshen me te madhe e zene anomalite ne ecje, te cilat perbejne 26.4% ne totalin e anomalive te popullsisë se komunes, me pas renditen problemet me kujtesen me 16.7%, ne komunikim 14.4% ,ne komunik 13.2% dhe me radhe te tjerat.

Te tjera komuna qe rezultojne problematike ne treguesin e prezences se aftesive te kufizuar ne raport me popullsisne banuese jane : Komuna Zapod, ku rreth 10% rezulton me te pakten nje kufizim ne aftesi ndersa shuma e te gjitha kufizimeve ne aftesi prezente ne popullsi perben 26% ; Arren, ku shuma e te gjitha aftesive te kufizuara ze 16% ndersa 9% e popullsisë rezultojne me te pakten nje kufizim; Komunat Kalis,Ujmisht kane gjithashte vlera pak me te larta se mesatarja e zones. Zonat qe kane prezencen me te ulet te aftesive te kufizuara ne raport me popullsisë banuese jane: Bushtrice(2.5%), Terthore(3.0%) dhe Kolsh(3.1%).

Lloji I aftesise se kufizuar qe mbizotron ne te gjitha komunat eshte anomalia ne ecje, e cila perben gati nje te treten e anomalive fizike prezente ne populate (28%). Me pas renditen kufizimet ne kujtese me 17.3% te totalit, ne kujdesin ndaj vetvetes 15.1% dhe ne fund kufizimet ne komunikim(13.7%) ,ne shikim(13.5%), dhe ne degjim (12.5%).

Ne vlere absolute , ne prezencen e personave me te pakten nje aftesi te kufizuar, kryeson bashkia Kukes me 742 dhe me pas renditet komuna Maqellare e Bicaj me perkatesisht 400 e 315 banore.

Duhet theksuar si institutet e trajtimit te ketyre anomalive lene mjaft per te deshiruar. Kjo problematike behet akoma me e ndjeshme ne rastin e femijve ku rreziku I izolimit dhe mostrajtitimit ne formen e duhur eshte shume I madh. Hapat per tu bere ne kete drejtim jane akoma shume dhe sfida nuk eshte e lehte qofte per mundesite buxhetore te pakta, lloji i kualifikimit te personelit, veshtiresite infrastrukturorte,etj.

2.2.2.5 Madhesia mesatre e familjes

Satusi civil

Zona e Kukesit shquhet per sundimin e tradites sa I takon aspekteve te lidhura me familjen. Keto jane zona ku dominon familja tradicionale patriakale dhe lidhjet fafaisnore jane mjaft te forta. Fenomenet e urbanizimit si per shembul divorci apo shtyrja e moshes se martesës jane mjaft te kufizuar ne te gjithë zonen, si ne qendrat urbane po ashtu edhe ne ato rurale.

Siaps censusi 2011, mesatarisht rreth 60% e meshkujve rezultojne te martuar dhe kjo perqindje pergjithesisht pak me e larte tek femrat. Emblematik eshte fakti I numrit mjaft te reduktuar te divorceve qe ne disa komune eshte nen nivelin 1% . Ne rast se nga njera ane ky fenomen tregon

lidhjet e forta dhe peshen e tradites apo opinionit publik, nga na tjetër mundet të fshehe veshtiresi në gjendjen e gruas brenda familjes dhe emancipimit të saj në përgjithësi.

Nr		mesatare e familjes	Te martuar - meshkuj	Te martuar - femra	Te divorcuar	Familje me një pjestar	shume se 6 persona	Kryfamiljare Femer	Cift pa femije	Cift me femije	Kryefamiljar ne pension
1	ARRËN	5.1	63.2%	63.1%	2.2%	4.4%	45.6%	2.2%	7.8%	72.2%	2.2%
2	BICAJ	5.3	60.4%	60.7%	1.4%	1.6%	43.6%	6.0%	8.5%	68.1%	3.2%
3	BUSHTRICË	5.5	56.5%	58.6%	1.3%	0.7%	48.0%	1.5%	3.3%	83.0%	0.7%
4	GRYKË ÇAJË	6.4	61.5%	62.1%	0.7%	0.0%	62.4%	3.1%	6.2%	67.7%	0.0%
5	KALIS	5.9	55.2%	60.4%	2.4%	1.4%	57.6%	5.8%	5.8%	72.7%	2.9%
6	KOLSH	5.5	56.3%	64.7%	1.6%	0.9%	46.0%	4.9%	5.8%	74.8%	2.7%
7	KUKËS	4.6	64.6%	62.6%	4.0%	2.1%	26.4%	9.0%	8.7%	70.8%	3.1%
8	MALZI	5.4	52.8%	57.5%	3.6%	4.2%	52.0%	11.2%	7.3%	68.5%	6.9%
9	SHISHTAVEC	4.6	62.7%	56.8%	1.0%	2.9%	33.1%	9.8%	13.9%	69.3%	9.1%
10	SHTIQËN	5.7	55.1%	61.0%	0.9%	1.5%	51.2%	6.9%	4.2%	67.4%	1.5%
11	SURROJ	5.8	57.3%	57.4%	0.9%	0.0%	53.4%	3.7%	9.0%	68.3%	1.6%
12	TËRTHORE	6.0	57.2%	61.0%	0.3%	1.0%	54.2%	6.9%	5.1%	70.6%	1.8%
13	TOPOJAN	5.9	52.4%	56.0%	1.7%	1.0%	56.4%	5.4%	4.4%	77.5%	2.3%
14	UJËMISHT	5.8	59.6%	60.0%	3.3%	0.6%	52.7%	2.9%	2.3%	75.6%	1.0%
15	ZAPOD	5.1	62.2%	57.7%	5.9%	2.8%	42.3%	10.4%	10.2%	63.3%	6.7%

Madhesia mesatare e familjeve është 5.1 persona për familje. Kjo është nga më të lartat në vend dhe vjen nga niveli i lartë i lindjeve që vijon të mbetet nga më të lartit në vend. Vihet re se zonat rurale kanë madhesi mesatare më të lartë se zonat urbane si dhe madhesia e familjes lidhet në përpjestim të drejtë me nivelin e jetesës dhe verferinës. Madhesinë mesatare më të madhe e gjejmë në komunën Gryke Çaje me mesatarisht 6.4 pjestare për familje, ndërsa numrin më të vogël e ka qyteti i Kukësit dhe komuna Shishtavec me 4.6 pjestar. Vlen për tu përmendur se përgjithësisht, komunat që rezultojnë me madhesinë më të madhe të familjes janë të njëjtat që

gjate dy dekadave te fundit, jane dalluar nga pjesa tjeter per renje ne numrin e popullsisë, si rezultat I migrimit apo edhe renjes se lindshmerise, papunesi te larte si dhe indikatorë te varferise me te larte se mesatnja.

Ne te njeten kohe vihet re se qendrat urbane kane madhesi mesatare me te vogel sesa zonar rurale malore. Konkretisht, bashkia e Kukesit dhe komuna Shishtavec ka madhesi mesatare prej 4.6 banore ndersa Koma e Gryke Cajes per shembull, e ka mesatren 6.4 persona per familje.

Perberje e berthamave familjare

Vihet re gjithashtu se me perjashtim te qytetit te Kukesit pjesa tjeter e komunave dominohen nga **“familjet me me shume se 6 persona”** ndersa familjet me nje pjestare perbejne nje minorance. Ne disa komuna, si per shembull: Gryke Cajë, Kalis, Terthore, Topojan, Ujmisht, , familjet me me shume se gjashte persona me shume se gjysmen e familjeve ndersa ato me vetm nje person ne rastin me te mire perfaqsojne 1% .

Po keshtu, edhe tipologjite **“ kryefamiljare femer”** dhe **“cift pa femije”** perbejne minorance ne kuadrin e pergjithshem social. Mundet te permendim si perjashtime komunat Malzi(11.2%) dhe Zapod(10.4%) ku familjet me kryefamiljare femer perbejne me shume se 10 % ,ndersa tipologjia **“Cift pa femije”** ka frekuence me te larte ne komunt Shishtavec(13.9%) dhe zapod(10.2%). Ne te kundert, komunat Bushtrice , Ujmisht paraqesin vlerat minimale per keto dy tipologji familjeje.

Tipologjia **“cift me femije”** eshte forma mbizotruese ne secilen komune me frekuence mesatare prej 70%. Komuna Bushtrice(83%) ka vleren me te larte ndersa komuna Zapod(63.3%) ka vleren me te ulet te kesaj tipologjie. Tipologjia **“ Kryefamiljar pensionit”**, perjashtuar komunave Shishtavec(9.1%),Malzi(6.9%) dhe Zapod(6.7%), perben nje perqindje minimale ne tipologjine e familjeve.

Vlen per tu theksuar se ne qendrat urbane , qyteti I Kukesit per rastin ne fjale, vihet re nje lloj evulimi i struktures familjare drejt formave ma pak tradicionale ndryshe nga pjesa rurale e cila mbetet. Brenda kornizes se familjes patriakale, me shume femije, ku divorci eshte tabu dhe ku familjet me vetem nje prind perbejne perjashtime te vecuara. Ndersa ne rastin e komunave rurale malore si psh Gryke Cajë, Shtiqen, Surroj, Terthore, perqindjet e divorceve jane nen 1%.

2.2.3 STATISTIKA JURIDIKE

2.2.3.1 Veprat Penale

Numri I veprave penale eshte nje indikator I rendesishem ne vrojtimin e ambientit social te nje shoqerie. Cilesia e jetes shoqerore eshte e lidhur ngushte me prezencen e veprave penale, frekuencen dhe llojin e tyre. Sa i takon llojit dhe frekuences se veprave penale, ne shkalle qarku, numrin më të madh të krimeve e zënë grupveprat **“Krimet kundër rendit dhe standardeve të**



sjelljes”, ndjekur më pas me “Krimet ekonomike- financiare” ndersa “Krimet kundër pronës”, përbëjnë grupveprën me numrin më të ulët të krimeve të evidentuara. Në grupveprën “Krimet kundër personit” përfshihen krimet kundër jetës, kundër shëndetit dhe lirisë. Kjo grupvepër është shumë e rëndësishme dhe rëndësi shumë e madhe i kushtohet edhe zbulimit të tyre.

Kukesi regjistron ne total 732 vepra penale per vitin 2014 dhe ka nje mesatre prej 8.5 vepra penale per 1.000 banore qe koincidon me mesataren e vendit (8.5). Numrin me te larte ne terma relative e ka qarku i Gjirokastrës me 13.8% .

Peshen me te madhe , ashtu sikurse ne te gjithë qarqet e Shqipërisë, e zene aktet kunder rendit dhe standarteve te sjelljes me 71.3% te totalit. Ne vend te dyte per nga frekuenca vije krimet ne fushen ekonomike dhe finaciare me 10.8%, ndjekur nga krimet ne fushen e korrupsionit me 8.2%, ato ne fushen e droges 3.1% si dhe kunder personit 3.1% . Kategorite e tjera kane peshe specifike relativisht te ulet. Interesant eshte numri i ulet i krimeve kunder prones dhe i trafikëve te paligjeshme.

Lloji I veprave Penale (viti 2014)	SHQIPERIA	KUKES	Pesha specifike e seciles kategori
TOTALI	24,536	732	100.0%
Kunder personit	485	23	3.1%
Kunder Prones	115	1	0.1%
Trafiqe te paligjshme	653	16	2.2%
Ne fushen e droges	1,533	23	3.1%
ekonomike dhe finaciare	2,107	79	10.8%
korrupsion	1,121	60	8.2%
pastrimi I parase	392	8	1.1%
Akte kunder rendit dhe standardeve te sjelljes	18,130	522	71.3%


2.2.3.2 Dhuna ne Familje

Të dhënat e raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, tregojnë se gjatë viteve 2010-2014 ne Shqipëri ka një rritje të numrit të raportimeve për dhunën në familje. Në rang vendi, në vitin 2014 janë bërë 14,4 për 10 mijë banorë raportime për dhunën në familje. Ne qarkun e Kukës, nga 349 raportime të dhunës në familje gjithsej gjatë 2010-2014, 18% jane raportuar gjate vitit 2010, 13.7% gjate vitit 2011, 17.6 % e tyre janë raportuar në vitin 2012, 22.4% ne 2013 dhe 26.8% gjate vitit 2014. Sic shihet qarte tendenca e raportimeve eshte ne rritje nga viti ne vit pasi raportimet e vitit 2014 jane pothuajse sa dyfishi I atyre te vitit 2010. Sidoqofte ky mbetet nje problem


shqetesues akoma I patrajtuar mire ne kompleksitetin e tij dhe duhen marre masa per parandalimin si dhe trajtimin me ndihme te kualifikuar per personat te cilet e kane vuajtur.

2.2.3.3 Të burgosurit

Të dhënat për të burgosurit përfshijnë personat e mitur, të rritur dhe shtetasit e huaj të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë në të gjitha llojet e qendrave të burgimit. Kukësi është qarku me normën më të lartë prej 34,4 të burgosur për 10.000 banorë, vlerë kjo e cila është relativisht e lartë në krahasim me normën mesatare në rang vendi. Përsa për të burgosurit nën 18 vjeç është relativisht e ulët në të gjitha qarqet. Në Kukës në vitin 2010 nga 163 të burgosur asnjëri nuk kishte minoren, ndërsa në vitin 2014, nga 295 të burgosur vetëm dy prej tyre ishin persona nën 18 vjeç. Ky është për tu konsideruar një fakt pozitiv duke pasur parasysh rritjen e madhe të numrit të burgosurve që ka regjistruar qarku i Kukësit gjatë periudhës 2010-2014.



Norma ndryshimit në numrin e të burgosurve në vitin 2010 dhe 2014 ka trend në rritje për vitet në fjalë për secilin qark. Në Shqipëri norma e ndryshimit midis vitit 2010 dhe 2014 është 18,5 %, që do të thotë se në vitin 2014 kemi 18.5 % më shumë të burgosur sesa në vitin 2010, ose shprehur në terma absolut në 2014 kemi 850 të burgosur më shumë se në vitin 2010. Në qarkun e Kukësit numri i të burgosurve për periudhën 2010-2014 është rritur me 80%! Kjo është norma e rritjes më e madhe në shkallë vendi dhe përben një element shumë të rëndësishëm në analizën e strukturës sociale.




Nga sa thame me lart, Kukesi ka normen me te larte ne shkalle vendi te te burgosurve per 10.000 banore (34.4) si dhe ritmin e rritjes se numrit te te burgosurve kater here me te larte sesa mesatarja e vendit (80%). Eshte mjaft e rëndesishme te kuptohen arsyet e kesaj rritje ne menyre qe te merren masat e duhura per frenimin e fenomenit. Duke pasur parasysh se se frekuencen me te larte ne veprat penale e kane aktet kunder rendit dhe standartet te sjelljes nga njera ane dhe numrin e larte te popullsise ne moshe te re nga ana tjeter, nevoja per institute te edukimit dhe te perfshirjes se te rinjve ne jeten sociale behet nevojë e domosdoshme ne rast se duam te reduktojme numrin e veprave penale si dhe te ulim rrezikun e prezences se minoreneve ne burgje. Institute te tilla mundet te jene shkollat profesionale, qendrat sportive dhe kulturore, qendrat rinore,etj.

2.2.4 SHËNDETËSIA

Jetëgjatësia ne Shqiperi vazhdon të rritet dhe kjo pjesërisht mund të shpjegojë ndryshimet demografike në strukturën e popullsisë, si dhe stilin e jetesës. Vëmendje e politikave ka qenë gjithnjë e fokusuar në cilësinë e jetës. Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor është filtri i parë ku adresohen problemet shëndetësore dhe ku jepet shërbimi. Institucionet bazë që ofrojnë këto shërbime jane: Spitalet, poliklinikat, qendrat shëndetësore, ambulancat dhe shërbimet e veçanta të konsultorit të fëmijëve dhe të gruas, të përfshira në këto institucione.

Gjatë vitev të fundit numri i shtretërve në dispozicion në spitale ne shkalle vendi ra ndersa ne qarkun e Kukesit numri i shtreterve u rrit nga 39 ne vitin 2009 ne 43 ne vitin 2013. Rritja e numrit te shtreterve nga njera ane dhe pse fare e vogel sidhe ulja e numrit te popullsise ne menyre te

ndjeshme nga ana tjetër, kanë bërë që raporti i shtrëtrve në pitale për 10.000 banorë në qarkun e Kukësit të rritet duke kaluar nga 39 shtrëtrë në 2009 në 43 shtrëtrë për 10.000 banorë në 2013.



2.2.4.1 Shërbimi shëndetësor

Shumica e banorëve të Kukësit shërbimet bazë publike i përfiton në qytetin e Kukësit ku gjendet spitali rajonal i Kukësit i cili është qendra më e madhe që mbulon gjithë zonën.

Numri i poliklinikave : Numri i poliklinikave ve ka mbetur i pandryshuar gjatë viteve të fundit. Vijnë të mbeten mesatarisht 2 poliklinikave ashtu si në shumicën e qarqeve të Shqipërisë. Krahasuar me nivelin mesatar në shkallë vendi, për vitin 2013 kemi një poliklinikë për çdo 43.222 banorë ndërkohë që mesatarja e vendit është 1 poliklinikë për 62.986 banorë. Sidoqoftë këtu duhet marrë parasysh jo vetëm numri i banorëve por edhe shpërndarja e popullsisë sipas zonave. Akseset në zonave malore në shërbimet shëndetësore mbetet problematike.

Numri i Qendrave shëndetësore: Gjatë viteve 2009-2013 numri i qendrave shëndetësore është reduktuar duke zbritur nga 29 qendra në vitin 2009 në 27 qendra shëndetësore në vitin 2013. Krahasuar me mesataren kombëtare prej 7085 banorëve për qendër shëndetësore, kjo zonë pozicionohet me lartë pasi rezulton me 3201 banorë për qendër shëndetësore.

Por në rast se marrim në konsideratë numrin e fshatrave dhe largësinë e tyre me qendrat urbane një pjesë e madhe e popullsisë së zonave malore e ka mjaft të vështirë aksesin në qendrat shëndetësore.



Insitucioni shendetesor	viti 2009	vit 2010	viti 2011	viti 2012	viti 2013	ndyshimi 2013-2009
Numri i poliklinikave	2	2	2	2	2	0
Qendra shëndetësore	29	29	29	27	27	-2
Ambulanca	118	123	123	125	125	7
Konsultori i fëmijëve	61	63	63	62	62	1
Konsultori i gruas	61	61	59	62	62	1

Numri i ambulancave: Numri ambulancave ka ardhur ne rritje edhe pse ne menyre teper modeste modeste, duke kaluar nga 118 ne vitin 2009 ne 125 te vitit 2013. Mesatarisht kemi nje ambulance per 692 banore nga 733 ne 2009, nderkohe qe mesatrja e vendit ne 2013 eshte 1450 banore/ambulance.

banore per / insitucion	viti 2009	vit 2010	viti 2011	viti 2012	viti 2013
Numri i poliklinikave	43,222	43,222	43,222	43,222	43,222
Qendra shëndetësore	2,981	2,981	2,981	3,202	3,202
Ambulanca	733	703	703	692	692
Konsultori i fëmijëve	1,417	1,372	1,372	1,394	1,394
Konsultori i gruas	1,417	1,417	1,465	1,394	1,394

Numri i konsultorit te femijeve dhe i gruas : Situata rezulton thuaje e pandryshuar gjate te njetes periudhe, me 62 qendra ne 2013 nga 61 qe ishin ne 2009. Krahasuar me mesataren e vendit , ne vitin 2013, kemi nje konsultore per cdo 1394 banore nga 1380 qe eshte mesatarja kombetare.

2.2.4.2 ARSIMI

Si rezultat i trashigminise se periudhes komuniste (1945-1990) analfabetizmi nuk perben problem shqetesues. Situata arsimore ne fakt paraqitet problematike ne rast se konsiderojme arsimin e larte(universitar dhe pas universitar). Me perjashtim te bashkise se Kukesit ku figurojne me arsim te larte 14.1% e popullise, pjesa tjeter e komunave rezultojme me perqindje minimale. Disa komuna malore si per shembull Arren, Bushtrice, Ujmisht dhe Surroj, arsimi universitar rezulton nen kuoten 2%. Ky fakt ka ndikim te menjehershem ne punesimin aktual por qe do te ndikojte negativisht edhe ne nje optike afatmesem dhe afatgjate ne punesimin e forces se punes.





Nr	Bashkia/Komuna	% e analfabetizimit	Mesatarja e Viteteve te shkollimit	Filllore	E mesme	E larte dhe me tej
1	ARRËN	1.13%	8.99%	85.38%	11.63%	0.66%
2	BICAJ	2.13%	9.86%	65.36%	23.96%	6.54%
3	BUSHTRICË	2.88%	8.88%	82.78%	10.82%	1.51%
4	GRYKË ÇAJË	1.69%	9.11%	80.10%	13.30%	2.94%
5	KALIS	4.01%	9.27%	80.40%	11.33%	2.52%
6	KOLSH	1.18%	9.19%	78.73%	15.26%	3.45%
7	KUKËS	1.58%	11.34%	45.45%	37.34%	14.12%
8	MALZI	3.33%	9.70%	67.98%	23.75%	3.50%
9	SHISHTAVEC	2.02%	9.37%	73.49%	18.92%	3.88%
10	SHTIQËN	1.94%	9.78%	65.46%	26.78%	5.07%
11	SURROJ	3.20%	8.87%	79.77%	13.71%	1.31%
12	TËRTHORE	1.92%	9.42%	70.38%	24.55%	2.34%
13	TOPOJAN	3.54%	8.92%	78.62%	11.93%	3.28%
14	UJËMISHT	2.38%	8.88%	84.28%	10.15%	1.75%
15	ZAPOD	3.98%	9.02%	72.37%	19.62%	2.12%

Perqindja e analfabeteve eshte relativisht e ulet edhe pse disa komuna kane vlera me te larta se te tjerat. Eshte rasti i komunave Kalis (4%), Zapod (3.98%), Topojan (3.5%) dhe Malzi (3.3%). Sidoqofte mesatarisht analfabetizimi eshte nen kuoten 2%.

Ndjekja e Arsimit fillor baze eshte relativisht e kenaqeshme me shifra qe varijojne nga 70%-85% ne pjesen me te madhe te Komunave. Mesatrja e viteve te arsimit eshte rreth 9 vjet. Kjo tregon qe pjesa dermueese e popullise ndalet ne arsimin 9 vjecar dhe nuk vijon me tej. Mjaft problematike rezulton ndjekja e arsimit te mesem sidomos ne ato komuna malore qe paraqesin veshtiresi komunikimi me perqindje shpeshhere nen 15%. Arsimi universitar sic e thame eshte ne nivele mjaft te uleta ne pergjithesi.

Nr	Bashkia/Komuna	% e analfabetizimit	Mesatarja e Viteteve te shkollimit	Filllore	E mesme	E larte dhe me tej
1	ARRËN	1.13%	8.99	85.38%	11.63%	0.66%
2	BICAJ	2.13%	9.86	65.36%	23.96%	6.54%
3	BUSHTRICË	2.88%	8.88	82.78%	10.82%	1.51%
4	GRYKË ÇAJË	1.69%	9.11	80.10%	13.30%	2.94%
5	KALIS	4.01%	9.27	80.40%	11.33%	2.52%



6	KOLSH	1.18%	9.19	78.73%	15.26%	3.45%
7	KUKËS	1.58%	11.34	45.45%	37.34%	14.12%
8	MALZI	3.33%	9.70	67.98%	23.75%	3.50%
9	SHISHTAVEC	2.02%	9.37	73.49%	18.92%	3.88%
10	SHTIQËN	1.94%	9.78	65.46%	26.78%	5.07%
11	SURROJ	3.20%	8.87	79.77%	13.71%	1.31%
12	TËRTHORE	1.92%	9.42	70.38%	24.55%	2.34%
13	TOPOJAN	3.54%	8.92	78.62%	11.93%	3.28%
14	UJËMISHT	2.38%	8.88	84.28%	10.15%	1.75%
15	ZAPOD	3.98%	9.02	72.37%	19.62%	2.12%

Indikatore te Arsimit 9 vjecar: Gjate periudhes 2009-13 indikoret e arsimit 9 vjecare tregojne per nje renje te konsiderueshme qe tregon shume per situaten demografike dhe sociale te zones. Konkretisht , numri i shkollave 9-vjecare ka rene me 21% gjate periudhes 2009/10-2013/14, ndersa numri I mesuesve ne shkollat 9vjecare ka rene me 11% , numri I nxenesve te regjistruar ka rene me 20% dhe numri I nxenesve te diplomuar ka rene me rreth 9%.

Indikatore te arsimit	viti 2009/10	viti 2013/14	ndryshimi ne numer	Ndryshimi ne %
Shkolla 9 vjecare	105	83	-22	-21%
Mesues ne shkollat 9 vjecare	1,252	1,115	-137	-11%
Nxenes te regjistruar ne arsimin 9 vjecar	18,584	14,948	-3,636	-20%
Nxenes te diplomuar ne arsimin 9 vjecar	2,015	1,825	-190	-9%
<i>Nxenes per 1 mesues ne arsimin 9 vjecar</i>	15	13	-1	-10%
Shkolla te mesme	20	19	-1	-5%
Mesues ne shkollat e mesme	222	253	31	14%
Nxenes te regjistruar ne arsimin e mesem	5,372	5,479	107	2%
<i>Nxenes per 1 mesues ne arsimin e mesem</i>	24	22	-3	-11%
Nxenes te regjistruar ne gjimnaz	5,031	5,287	256	5%
Nxenes te diplomuar ne arsimin e mesem	1,241	1,645	404	33%
Nxenes te diplomuar ne gjimnaz	1,132	1,611	479	42%

Mesatnja nxenes per mesues ne arsimin 9 vjecar ne vitin 2013/14 eshte 13 nxenes per mesues nga 15 qe ishte ne vitin shkollor 2009/10. Sic mundet te vihet re nga te dhenat, permiresimi I indikatorit arsimor nxenes per mesues nuk ka ardhur si rezultat I shtimit te numrit te mesuesve, numer I cili ka pesuar renje nga 1252 ne 2009/10 ne 1115 ne 2013/14, por si rezultat I numrit te



nxenesve te regjistruar ne arsimin 9-vjecar i reduktuar me 20%. Renja e numrit te nxenesve ne arsimin 9 vjecar, ne fakt eshte nje fenomen i pritshem ne rast se analizojme te dhenat demografike te cilat na tregojne per nje renje gjithnje e me shume te grupmoshes 0-14 vjec si rezultat i renjes se lindshmerise dhe emigrimit te popullise.

Pjesa me e madhe e shkollave 9 vjecare , rreth 90% e tyre, ndodhen ne zonat rurale . Konkretisht , ne vitin 2013/14, nga 97 shkolla te arsimit 9-vjecar , 86 jane ne zonat rurale dhe vetem 11 jane ne zonat urbane. Edhe numri i te regjistruarve dhe te diplomuarve ne zonat rurale eshte mjaft me i larte se ne zonat urbane

Indikatoret e arsimit te mesem ne pergjithesi kane ndryshuar pozitivisht. Gjate kesaj periudhe, numri i shkollave te mesme ka rene vetem me 1 njesi (nga 20 ne 19) ndersa eshte rritur numri i mesuesve (nga 222 ne 253). Per fatin e mire, numri i nxenesve te regjistruar ne arsimin e mesem eshte rritur nga 5372 ne vitin 2009/10 ne 5479 ne vitin 2013/14, me nje rritje prej 2% si dhe numri i nxenesve te diplomuar gjithashtu eshte rritur, duke kaluar nga 1241 te diplomuar ne 2010/13, ne 1645 te diplomuar ne 2013/14. Numri i te diplomuarve ne arsimin e mesem, gjate periudhes 2009/10-2013/14, ka regjistruar nje rritje te rendesishme prej rreth 33%.

Raporti nxenes per mesues eshte rritur eshte ulur ne 22 nxenes per mesues ne 2013/14 nga 24 qe ishte ne 2009/10. Kesaj radhe ndryshe nga arsimi i mesem , indikatori eshte permiresuar si rezultat i rritjes ne numer te mesuesve pasi numri i nxenesve te regjistruar gjithashtu eshte rritur.

Ne arsimin e mesem mbizoterojne te regjistruarit ne gjimnaze per te gjitha vitet me rreth 95% te te regjistruarve. Mungesa e theksuar e ndjekesve te arsimit profesional perben nje fakt shqetesues qofte nga pikpamja e kualifikimit te forces se punes por edhe nga e edukimit shoqeror ne pergjithesi, pasi perqindja e atyre qe ndjekin studimet e larta ne pjesen me te madhe te komunave rezulton te jete me pak se 4%.

KUKES	viti 2009/10			viti 2013/14			ndryshimi ne numer	Ndryshimi ne %
	Gjithsej	Qytet	Fshat	Gjithsej	Qytet	Fshat		
Shkola 9 vjecare	105	9	96	83	10	73	(22)	-21%
Mesues ne shkollat 9 vjecare	1,252	309	943	1,115	289	826	(137)	-11%
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Gjithsej
Nxenes te regjistruar ne arsimin 9 vjecar	18,584	8,807	9,777	14,948	6,862	8,086	(3,636)	-20%
Nxenes te diplomuar ne arsimin 9 vjecar	2,015	937	1,078	1,825	862	963	(190)	-9%
	Gjithsej	e mesme	Shkolla Profesio	Gjithsej	e mesme	shkolla profesio	Gjithsej	Gjithsej

		pergjith.	nale		e pergjith.	nale		
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Gjithsej
Shkola te mesme	20	20	-	19	19	-	(1)	-5%
Mesues ne shkollat e mesme	222	121	101	253	150	103	31	14%
Nxenes te regjistruar ne arsimin e mesem	5,372	2,504	2,868	5,479	2,558	2,921	107	2%
Nxenes te regjistruar ne gjimnaz	5,031	2,278	2,753	5,287	2,500	2,787	256	5%
Nxenes te diplomuar ne arsimin e mesem	1,241	673	568	1,645	837	808	404	33%
Nxenes te diplomuar ne gjimnaz	1,132	589	543	1,611	818	793	479	42%

Sa i takon **aspektit gjinor**, si ne pjesmarrjen ne shkollë ashtu edhe ne mesidhenje, te dy gjinite ndjekin te njetin trend dhe nuk rezultojne disbalanca gjinore. Numri i meshkujve eshte lehtesisht me larte por sidoqofte ne linje me raportin gjinor te zones.

Vlen per tu permendur qe ne kete zone mungojne plotesisht **insitucionet e arsimit privat**, te cilat potencialisht mundet te ishin institute arsimore te nje cilesie me te larte duke ndihmuar ne kualifikimin arsimor te nxenesve. Mungesa e tyre eshte e kuptueshme duke pasur parasysh nivelin e te ardhurave per fryme dhe pjeses se dedikuar nga konsumi i familjeve arsimimit te femijeve.

2.2.5 Bujqesia

Bujqësia mbetet sektori që siguron nivelin më të madh të të ardhurave dhe sektori kryesor i punësimit në Kukësit. Kjo zonë njihet për zhvillimin e bujqësisë dhe sidomos blegtorisë falë një klime mjaft të përshtatshme për zhvillimin e saj. Klima dhe terreni gjeografik janë faktorët kryesorë që garantojnë zhvillimin e bujqësisë. Bujqësia zë një vend shumë të rëndësishëm në zhvillimin e tregut të brendshëm, ku operojnë një numër i madh tregtarësh me prodhimin vendas. Terreni malor i zonës ndikon dhe në strukturën e tokës, ku pyjet zënë rreth 62% të territorit të zonës, ndërsa toka bujqësore zë vetëm 16% të territorit. Pyjet përbëjnë një nga pasurinë natyrore me te rendesishme. Llojet e drurëve janë, ah, pishë, mështekën, shkozë, rraboll etj. Kjo është një mundësi për shtimin e numrit të blektorisë dhe shfrytëzimin racional të kësaj sipërfaqe duke i dhënë jetë ekonomisë pyjore, me prodhimet e dyta të pyllit, bimët mjekësore dhe turizmi malor.

Perberja e tokes: Pjesa e tokës e shfrytëzueshme për bujqësi përbëhet në një mase të madhe nga kullotat 56% ndërsa toka arë zë vetëm 34%. Ndërsa sipërfaqet e mbjella me vreshta dhe pemtoret



zënë një përqindje shumë të vogël (3% dhe 4%). Ndër bimët e arave pjesa më dërrmuese e sipërfaqes së mbjellë dominohet nga foragjeret, e ndjekur nga drithrat, patatet dhe perimet.

Foragjeret janë në funksion të blegtorisë, ndërsa drithërat përdoren kryesisht për konsum familjar dhe nuk janë të orientuar drejt tregut. Këto të fundit paraqesin rendimente relativisht të ulëta. Kurse në aspektin e prodhimit, patatja dhe perimet zënë peshën më të madhe të prodhimeve bujqësore në këtë zonë.

Prodhimi i bimëve të arave në krahasim me rrethet e tjera të qarkut të Kukësit (Has, Tropojë) është në nivele më të larta, gati dyfish më shumë të prodhimit të patates, perimeve, drithërave, thekrës, etj. Ka zona për shembull që relievi është mjaft i favorshëm për kultivimin e bimës së arës si në Komunën e Tërthorës ku toka gëlqerore mundëson rritjen e misrit, fasules e grurit.

Pemët frutore rriten pothuajse në gjithë territorin, por zonat ku përqëndrimi i tyre është më i madh janë Bica, Shtiqen dhe Ujmisht. Malzi, dallohet për rritjen e gështenjës. Zonat e Ujmsht dhe Shtiqen janë komunat ku prodhohet edhe sasia më e madhe e arrave, të ndjekur nga Bicaj. Bicaj dhe Kukës dallohen si zona ku vreshtaria është më e zhvilluar. Pemët frutore kanë edhe orientimin më të lartë drejt tregut. Kulturat e drithërave të bukës dhe foragjeret kanë shumë pak fitim ose aspak, dhe kultivimi i tyre bëhet për shkak të traditës dhe përdoret për nevojat e familjes dhe foragjeret për blegtorinë. Rendimenti më i lartë është në pemëtari, perime dhe patate.

Agro-përpunimi: Agro-përpunimi ka filluar të intensifikohet këto vitet e fundit. Investitorët dhe fermerët kanë investuar në linja të vogla, të mesme dhe të mëdha për përpunimin agrobujqësor sidomos për përpunimin e qumështit dhe të frutave për lëngje dhe pije alkolike.

Bimet medicinale: Zona e Kukësit ka potenciale shumë të mëdha përsa i përket bimëve medicinale, pasi është mjaft e pasur me këto burime. Janë mbi 100 bimë medicinale që rriten në Zonë, për të cilat ama mungon drejtimi teknik dhe duhen bërë studime të theksuara për të nxitur kultivimin e tyre dhe rritur përfitimet. Gjithashtu në vende si Shishtavec, Topojan, Bicaj dhe Tërthora ku mjedisi i kësaj zone është mjaft i larmishëm, rriten në formë natyrore bimë medicinale si, boronicë, shkëm, qershizë lule basani, sherebela.

Aktualisht bimët mbledhen kryesisht nga banorët e fshatrave në territoret e të cilëve ato ndodhen dhe pastaj grumbullohen nga tregtarë lokalë apo të tjerë që jo të gjithë janë të licensuar. Fermerët lokalë nuk i kultivojnë këto bimë por thjesht i mbledhin në natyrë.

Megjithatë vështirësitë në tregtimin e bimëve medicinale, ka potenciale që këto prodhime të jenë konkurrese jo vetëm në tregun lokal por edhe atë rajonal e ndërkufitar.

Sistemi i vaditjes: 68 % të tokës bujqësore mungon sistemi i vaditjes pasi ka probleme me kanalet e vaditjes ose burimin e ujit. Ka një sipërfaqe të konsiderueshme tokë të papërdorur apo të refuzuar. Kjo vjen për arsye të mungesës së vaditjes dhe konfliktit të pronësive. Sipërfaqja e ujitur

sipas ministries se Bujqesise eshte 32% e tokes se punueshme port e dhenat ne terren tregojne probleme ne vaditje.

Infrastruktura bujqësore është nën standartin e kërkuar. Teknologjia dhe mekanika bujqësore mbetet e kufizuar si në numër dhe në larminë e saj. Për shkak të terrenit në zonat malore toka punohet me kafshë ose me krah.

2.2.5.1 Peshkimi

Peshkimi në Liqenin e Fierzës, përbën një veprimtari të rëndësishme për gjithë zonën. Nga Liqeni është marrë deri në 5 mijë tonë peshk në vit, por prodhimi ka pësuar rënie në dhjetëvjeçarët e fundit për shkak të mos shtimit, por edhe për arsye të peshkimit të pa kontrolluar, shpesh dhe me mjete shfarosëse si dhe ndotja e liqenit.

Ujrat janë tipike për kultivimin natyrorë të popullatave peshkore që në këtë zonë marrin një zhvillim vërtetë të dukshëm. Që nga formimi, struktura peshkore u tjetërsua me lloje peshqish liqenore, e shoqëruar me largimin e llojeve të ujërave të rrjedhshëm që më parë popullonin lumin Drin, si trofta, ngjala dhe gjetën mjedis të përshtatshëm shumimi dhe ushqimi, peshq si ballëgjeri i bardhë dhe ai larosh, krapë, luçiperka, karasi dhe gjuhca (cironka), sharmaku.

2.2.6 Turizmi

Turizmi është një nga potencialet madhore të Zonës Funktionale të Kukësit. Kjo Zonë ka asete të mjaftueshme për të tërhequr turistët, veçanërisht burimet e jashtëzakonshme natyrore në majat e maleve, kullotat alpine, luginat e thella, si dhe liqenet dhe lumenjtë spektakolarë. Atraksionet që tërheqin më shumë turistë janë, Liqeni i Fierzës, Shishtavec, kanionet e Gjallicës, etj. Zona e Kukësit ka gjithashtu histori e kulturë të gjerë, tradita vendase, shumëllojshmëri e produkte bujqësore, kulinari, të cilat janë potenciale mjaft të vlefshme për zhvillimin e turizmit në vend. Ka një gamë të gjerë veprimtarish kuturore-artistike që zhvillohen në këtë zonë, kryesisht në qendrën e saj të Kukësit si manifestime, festivale, konkurse, letrare, panaire, ekspozita, festa e ditë festive. Natyra e bukur, peisazhet, folklori tradicional, vendet kulturore e historike, parqet natyrore e pyjet, liqenet, lumenjtë, zonat e mbrojtura, janë të njohura tashmë, por pak të shfrytëzuara. Në Strategjinë Rajonale të Kukësit 2012, por edhe në Planin e Zhvillimit të Bashkisë së Kukësit 2011-2015, turizmi qëndron si një nga prioritetet kryesore.

Turizmi Kulturor

Prodhimet e artizanatit të sotëm kuksian, janë në vazhden e traditave shekullore që datojnë nga koha Ilire. Tradita e poçarisë ka qenë një traditë e lashtë. Gdhendja e gurit, drurit, punimi i hekurit janë përdorur gjerësisht dikur për zbulimin e shtëpive, duke filluar që nga periudha e mesjetës e në vazhdim.



Prodhimet qillimave të artizanave Kuksiane , kanë qenë po aq të famshme, sikurse dhe prodhimet e artizaneve të Korçës dhe të Krujës. Një vend të rëndësishem ka zënë përgatitja e kostumeve tradicionale popullore të grave dhe burrave. Kostumet popullore, sidomos të grave, shquhen për bukurinë, elegancën, koloritin e pasur dhe shumëllojshmerinë dhe janë unike në llojin e tyre. Tradita e prodhimit të artikujve të tillë të artizanatit sot po humbet pasi numri i personave që merren me këto mjeshteri po zvogëlohet së tepërmi.

Ka një gamë të gjerë veprimtarish kulturore-artistike që zhvillohen në këtë zonë, kryesisht në qendrën e saj të Kukësit si manifestime, festivale, konkurse letrare, panaire, ekspozita. Festa të veçanta si Festa e Gështenjës, Festa e Patates, Dita e Artizanatit, Dita e Bujarisë, Festat e Komunave, Ditë Peshkimi, Festa e Mjaltit, Pelegrinazh Pashtrik, Dita Rajonale e Arsimit, Kolonia Kombëtare e Piktoreve "ArtKukës" janë aktivitete të cilat shërbejnë për të mbledhur komunitetin e zonës, por edhe për të tërhequr turistë.

Kjo zonë ka disa **monumente të trashëgimisë kulturore** por mirëmbajtja e tyre dhe shfrytëzimi i potencialve të tyre për promovimin e turizmit kulturor dhe historik ende nuk po realizohet në nivelet që kërkohen. Disa nga Monumente e historike janë: Banesa e Hasan Rexhepit, Kalaja e Lekes (Mal Zi), Gradishta e Bardhoci (Tërthore), Banesa e Asllan Fetahut, Banesa e Rustem Shahinit, "Hisari" ne Domaj, Kështjella e Bushatit, Shkolla e Vjetër e Bicajve (Bicaj), Kalaja e Vilës (Bushtricë).

Turizmi rural

Zona funksionale e Kukësit ka potenciale të rëndësishme të zhvillimit të turizmit rural e në mënyrë të veçantë të turizmit malor. Sasati në lartësinë e mbi 1700 metrave mbi nivelin e detit, është një vend mjaft tërheqës pasi në stinën e verës ai mbushet plot me vizitorë që qëndrojnë deri sa vjen dimri.

Disa nga **Monumentet Natyrore** janë: Pisha e Gjergjanit, Gryka e Çajes, Cirku akullnajor i Zepes, Kroj i Bardhe, Kanioni i Bicajt, Kanioni i Vanave, Lisat e Kalisit, Karsti i Arnit, Keneta e Kukësit, Kroj i Kuq, Gjallice, Guri i Mengjesit, Shishtavec, Guri i Shqipes (Borje) Burimi i Kolosianit, Dushkajat e Novoseit, Meshtekna e Shishtavecit (liqeni I Kallabakut), Rrobulli i Lakut te Topojanit

Zhvillimi i turizmit malor ka bërë hapa të rëndësishëm përpara duke çuar në shtimin e numrit e banesave turistike në zonat rurale. Po ashtu edhe ndërtimi i autostradës, dhe i aeroportit të Kukësit kanë krijuar mundësi efikase për zhvillimin cilësor të turizmit malor, për të cilin kërkesat janë gjithnjë në rritje si nga vizitorët nga shqipëria dhe zonat e Kosoves, si Prizrenit e Dragash.

Turizmi Natyror -Dimëror

Zona e Shishtavecit njihet si një nga zonat ku, edhe pse modest, zhvillohet turizmi dimëror. Në se flasim për turizmin ndërkufitar apo marrëdhënie të tjera në këtë hapësirë, sërish Shishtavecit ka përparësi të dukshme, për shkak të pozicionit, potencialeve njerëzore, ekonomike e



kulturore. Turizmi përbën prioritetin e parë për zhvillimin e Komunës së Shishtavecit, e cila zotëron burime të virgjëra natyrore e të pa shfrytëzuara

Gjithashtu edhe në Komunën e Tërthorës, megjithëse infrastruktura ka bërë që bjeshka të mos frekuentohet, mbetet një resurs i pashfrytëzuar për turizmin alpin për vitet e ardhshme. Në Bicaj për shembull, e gjithë pjesa e bjeshkës është një vend i mrekullueshëm për vizitorët dhe turistët që janë të interesuar për klimën e freskët malore. Para disa vitesh në këtë zonë kalonin pushimet verore mjaft vendas dhe të huaj. Duke pasur parasysh natyrën shumë të pasur të kesaj zone, zhvillimi i turizmit mund të jëtë gjithëvjeter duke u shfrytëzuar për gjatë gjithë stinëve të vitit.

Turizmi Liqenor

Zona e Kukësit shtrihet në anën juglindore të liqenit artificial të Fierzës. Ekzistenca e liqenit në këtë zonë është një potencial i madh për zhvillimin e turizmit, pasi pika të caktuara të tij mund të shfrytëzohen gjatë verës si plazhe që mund të përdoren nga banorët vendas si pika për larje dhe banjo dielli, por njëkohësisht mund të frekuentohen edhe nga banorët e zonave kufitare më Kosovën, të cilëve të tilla vende ju mungojnë. Po kështu, edhe zhvillimi i akuakulturës është një potencial për t’u konsideruar pasi liqeni i Kukësit njihet për peshkun që rritet aty, i cili sot preferohet nga turistët që vizitojnë qytetin. Sporte të tilla si garat me kanoe mund të jënë një mundësi e mirë për t’u zhvilluar nisur nga sipërfaqja e madhe e liqenit dhe lidhja e tij me degët e Drinit. Por marrja e masave për pastrimin dhe mbajtjen pastër të liqenit dhe krijimin e infrastrukturës së duhur për sportet liqenore apo pikat e plazheve përgjate liqenit duhet të jenë në vemëndjen e autoriteteve lokale.

Analizë e sektorit te turizmit mund ta permbledhim shkurtimeisht si me poshte:

Anët e Forta
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Pasuri natyrore dhe biodiversitet i pasur qe lejojne zhvillimin e disa llojeve turizmi; ▪ Tradita e pasur me doket dhe zakonet e lashta, ▪ Tradita të forta të artit popullor;Vlera Historike e kulturore; ▪ Kulinaria e zonave malore dhe produkte BIO; ▪ Akses i afërt në rrjetin rrugor kombëtar nëpërmjet aksit Durres – Kukës
Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Infrastrukturën e përshtatshme; ▪ Mungesa ne aftesite akomoduese dhe cilësi jo e lartë shërbimi; ▪ Kapacitete të ulëta njerëzore për shërbime turistike; ▪ Mungesa e Investimeve në sektorin e turizmit; ▪ Mungesa e promovimit turistik të zones; ▪ Mungesa e sigurisë dhe shërbimit shëndetësor të shpejtë nëpër zona malore te largëta; ▪ Bashkëpunim i dobët mes autoriteteve publike dhe industrisë së turizmit; ▪ Mungesë paketash Turistike konkurruese ;





- Menaxhim jo I qendrueshem I pasurive turistike

Mundësitë

- Përmirësimi i infrastrukturës;
- Përvoja e suksesshme rajonale;
- Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve akomoduese dhe të shërbimeve turistike;
- Zhvillimi I mëtejshem i sektorit të agroturizmit;
- Promovim i kulinarisë vendase bazuar në shfrytëzimin e produkteve BIO të zonës dhe prodhimeve të certifikuara;Kerkese ne rritje nga tregu vendas per turizmin dimeror dhe te natyres;
- Mundësi për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit ;
- Mjedis I virgjër dhe pa ndotje industrial;
- Prodhimeve artizanale

Kërcënimet

- Konkurenca Rajonale dhe nderkombetare;
- Mungese promovimi dhe plani strategjik;
- Sistem jo i integruar sic duhet me tregun ndërkombëtar;
- Menaxhim I papershtatshem i pasurive natyrore;
- Mosorientim drej turizmit të qëndrueshëm;
- Humbja e traditave kulturore, artizanatit, dokeve,etj

2.2.7 Industria Minerare

ZF e Kukësit dallohet për burimet e shumta minerale. Nder mineralet me kryesoret mundet te permendim:

Minerali I kromit: Rezervat kryesore të kromit ndodhën shkëmbejtë Ultrabazik të Zonës së Kalimashit. Miniera kryesore e nxjerrjes së kromit janë në zonat Kalimash 1 dhe 2, por edhe zonat përreth. Burime të mineralit të kromit ka dhe në zonën e Surroit .

Minerali i bakrit: Minerali i bakrit nxirret në zonën e Gjegjanit dhe Ngdhesht. Në zonën e Shënmbisë ndodhet miniera e bakrit në Lerpoj, e pashfrytëzuar deri tani.

Hekur-Nikel dhe Nikel-Silikat: Hekur-Nikel dhe Nikel-Silikat: përqëndrimi kryesor në Kolsh, Surroj dhe Arren. Këto miniera janë sot në potencialin e tyre më të madh (rezerva maksimale), të cilat llogariten në masën prej 74 milion ton rezerve minerali. Pjesa me e madhe e Mineralit të hekur - nikelit eksportohet në Kosovë, në Uzinën e Shkrirjes së Hekur-Nikelit në Drenas,

Boksidet dhe alumini: Boksidet dhe alumini shtrihen në Qafë- Bëne, ndërsa mineralet radioaktive (ende rezervat të pa përcaktuara) ndodhen në Nimce, ndërsa kuarцитet në Kallabak e Shishtavec.

Rëra e bardhë: Në Komunën e Bicaj ndodhet edhe masivi i shfrytëzimit të rërës së bardhë e cila furnizon gjithë zonën e Kukësit dhe Hasit. Kjo pasuri përbën një burim shumë të rëndësishëm për popullsinë e zones.



Anët e Forta
<ul style="list-style-type: none">▪ Rajon është i pasur me shumëllojshmëri mineralesh metalore dhe jo- metalore;▪ Zona e kukesit ka eksperiencë të mëparshme me nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve qe para viteve '90;▪ Fuqi puntore e disponueshme;▪ Biznese të interesuara drejt mundësive minerare të rajonit
Dobësitë
<ul style="list-style-type: none">▪ Bashkëpunim i dobët mes autoriteteve publike dhe industries së nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve;▪ Mungesë investimesh në rimëkëmbjen e industries; Infrastrukturë e vjetëruar;▪ Mungesë teknologjish moderne të kërkimit dhe nxjerrjes së mineraleve;▪ Mungesë sensibilizimi ambjental nga bizneset minerare ekzistuese
Mundësitë
<ul style="list-style-type: none">▪ Mundesi per rivitalizimin e industrise se perpunimit (sidomos hekur nikelit) ;▪ Rimëkëmbja e minierave të vjetra dhe investimin në minierat e reja;▪ Tërheqja e investimeve publike si dhe bizneseve të reja;▪ Mundësi eksporti jashtë vëndit; Investim kapitalin njerezor (në trajnimin, edukimin dhe rritjen e kapaciteteve);▪ Ndërgjegjësim i komunitetit të bizneseve minerare për mbrojtjen e ambjentit nga ndotjet e minierave
Kërcënimet
<ul style="list-style-type: none">▪ Aktivitete të paligjshme si pasojë e braktisjes së disa minierave apo mungesës së subjekteve të liçencuara;▪ Kushte të dobëta pune dhe siguri e ulët e jetës së puntorëve të minierave▪ Ndotje ambjentale prej mbetjeve minerare dhe mungesës së hapsirave për depozitimin apo përpunimin e tyre;▪ Zhvillim i vonuar i rajonit për shkak të mos-shfrytëzimit të plotë të pasurive minerare të cilat do ndikonin konsiderueshëm në rritjen e ekonomisë dhe punësimit

2.2.8 Sinteze e relacionit mbi trashëgimime kulturore

E vecanta e qytetit të Kukësit qëndron në historinë e tij. Fillimisht u ndërtua Kukësi i Vjetër i cili kishte karakterin e një qëndre krahinore. Në vitin 1923, Kukësi kishte 28 shtëpi me 186 banorë. Pas viteve 1925 Kukësi merr statusin e një qyteti për shkak se numri i banorëve filloj të rritej ndjeshëm, duke bërë që Kukësi të merrte një pamje të re përmes ndërtimeve të reja, aktivitete sportive dhe kulturore, tregtisë, prodhimit vëndas, shërbimeve postare, përpunimit të metalit etj.

Ne dhjetor të 1944 u vendos administrata e re e perfekturës dhe qyteti filloi të levizë me shpejtësi drejt një qendre të vërtetë administrative, politike, ekonomike, kulturore e sportive. Me 1962 merret vendimi i qeverisë për përmbytjen e Kukësit dhe fillon ndërtimi i qytetit të ri.

Me 1970 Kukësi arrin 6073 banorë. Me 1978 behet plotësisht zhvendosja në qytetin e ri të Kukësit ku banorët u vendosen në apartamente të ndryshme. Ndërtimi i Kukësit të Ri erdhi me një frymë të re, i bazuar në modelin Sovjetik, ku mbizotëronte ndërtimi i strukturave të reja të cilat i dhanë zonës fizionomine e mirefilltë të një qyteti. U ndertuan pallate, shkolla, spitale, shtëpi kulture, parqe, shtëpi leximi, skena shfaqjeje, kinema, librari, teatri, muzeu i rrethit etj. Pjesë e rëndësishme e ndërtimit të Kukësit të Ri ishte dhe industria. Kjo bëri të mundur që të rritej klasa punëtore dhe qyteti të hynte në jetën ekonomiko-shoqërore. Deri në vitet '90, Kukësi kishte një industri të nxjerrjes dhe shkrirjes së bakrit, nxjerrjes dhe koncentrimit të mineralit të kromit, nxjerrjes së mineralit të kuarcit, prodhimit të materialeve të ndërtimit, përpunimit të lëndës drusore dhe prodhimit të mobiljeve, prodhimit të qilimave dhe sixhadeve, industrinë e blojës, uzina mekanike, prodhimeve ushqimore mbledhjes dhe përpunimit të bimëve mjekësore, prodhime të industrisë mekanike, shërbim hotelier përmes dy hoteleve turistike të cilat pritnin dhe përcillnin dhe disa qindra turistë të huaj. Shumica e këtyre industrive janë mbyllur, ndërsa një pjesë e vogël e tyre vazhdon të jetë në funksion akoma. Duke u bazuar tek mineralet e shumta që ndodhen në zonën e Kukësit, mund të ishte një mundësi që të rishikohej hapja ose rihapja e këtyre industrive të cilat mund të jepnin një kontribut të veçantë në jetën ekonomike.

Gjatë ndërtimit të Kukësit të Ri, u ndërtua dhe **Obelisku Përkujtimor, Lagja e Dëshmorëve**. Të gjitha varrezat e dëshmorëve të atdheut janë ndërtuar me mermer dhe ishte mermeri i parë i cili u bë për të rënet e banorëve të atdheut. Në ditët e sotme numërohen së paku 120 varre të cilat është e vështirë të identifikohen pasi thyerja dhe degradimi i pllakave ka sjellë fshirjen e emrave. Duke konsideruar rëndësinë historike që kjo lagje ka, është e rëndësishme rikonstrukcioni i plotë si dhe riorganizimi i këtyre varrezave pasi duhet të behet dhe zhvendosja e varreve të 20 dëshmorëve nga varrezat publike tek Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut.

Kukësi i Nëntokës, një qytet i ndërtuar paralelisht me qytetin e ri në vitin 1978. Frika nga ndonjë sulm i mundshëm i jugosllavëve e detyroi shtetin komunist të Enver Hoxhës, të ndërtonte paralelisht me Kukësin e Ri, këtë qytet të nëndheshëm. Qyteti i nëndheshëm është 2.4 kilometra, aq sa është edhe shtrirja e qytetit sipër, pa zgjerimet e viteve pas '90-tës, në formën e tuneleve që lidhen me pikat kyçe të qytetit dhe 7 lagjet e tij. Ka disa hyrje të vendosura në lagje dhe në qendër janë institucionet, e në momentet e një alarmi për sulm, i gjithë Kukësi do të kishte mundësi të mbrohej nga qyteti i nëndheshëm, i tëri i ndërtuar në beton si dhe ishte ndërtuar për të përmbushur nevojat elementare të një qyteti. Në Kukësin e nëntokës shtrihen: spitali, materniteti, shtypshkronja, ujësjellësi, komiteti ekzekutiv, ai i partisë, sallë e madhe për mitingje apo takime me popullin, burgu, hetuesia si dhe komiteti i partisë. Çdo lagje e qytetit ka një tunel që e bashkon me qendrën dhe ka të gjitha strukturat për të pasur formën e një qyteti të mirefilltë. Deri në vitin



1991, qyteti i nëndheshëm është ruajtur dhe mirëmbajtur nga strukturat shtetërore, ndërsa pas saj nisi degradimi. Aktualisht në qytetin e nëntokës mungon ndriçimi e ka dëme të konsiderueshme, megjithatë me ane të investimeve mund të rikthehet në jete duke u bërë pikë e rëndësishme turistike.

Relievi i rrethit të Kukësit dallohet për një larmishmëri në aspektin morfologjik dhe kontrastet e mëdha hipsometrike. Këto tipare gjeografike kanë ndikuar në formimin e një natyre tepër të ndërlikuar me zhvillim të vrullshëm, që ka çuar në formimin e vlerave të veçanta, unikale, që kushtëzojnë një trashëgimi shumë të pasur natyrore. Ku tek trashëgimi natyrore mund të përmendim: **Liçeni i Kukësit, Gryka e Çajës, Guri i Mëngjezit-Shishtavec, Kroji i kuq-Gjallice, Çirku akullnajor i Zepës, Karsti i Arnit, Mështekna e Shishtavecit, Kanioni i Bicajt, Kanioni i Vanave, Këneta e Kukësit.** Një rëndësi të veçantë për qytetin e Kukësit kanë dhe rrethet dhe zonat arkeologjike, të cilat dëshmojnë lashtësinë e këtij vëndbanimi. Ndër to mund të përmendim: **Vëndbanimi në Kodrën e Pecës, Kalaja e Gradishta e Bardhocit.** Ndërsa fortifikimet në këtë qytet zënë një vend të rëndësishëm në trashëgiminë kulturore dhe arkitektonike. Fortifikimet në qytetin e Kukësit janë: **Kështjella e Bushatit, Kalaja e Lekës në fshatin Vau-Spas, kalaja Hisari në Domaj, kalaja e Kosturit, Kalaja e Viles në Kukës.** Të një rëndësie të veçantë janë gjithashtu dhe banesat tradicionale, ku mund të përmendim: **Banesa e Asllan Fetahut, Banesa e Hasan Rexhepit, Banesa e Rustem Shahirit, Shkolla e Vjetër Bicajt, Kulla e Shaqir Pulashit, Kulla e Ismail Aga Lumës, Kulla e Rezistencës.**

Qyteti i izoluar në liqen, marrëdhënia e tij me frontet malore që e rrethojnë atë në një distancë, sigurojnë mundësitë të ndryshme të përdorimit të liqenit. Zonat gjeografike të liqenit shprehin një njësi hapësimore në formë gjeografike unike dhe të kompletuar: një pjesë e qytetit është e rrethuar me ujë dhe kufizohet nga kodra dhe male. Këto dy kufij krijojnë hapësirën e brendshme, struktura e të cilët përcaktohet nga marrëdhëniet në mes të qytetit dhe vlerat e tij topologjike, në formën e ujit duke kufizuar zhvillimin e saj dhe gjeografine gjeologjike natyrore.

Qyteti i ujit, i vendosur tek lumenjte si dhe tek liqeni artificial bën të mundur që uji të fitonte vlerë si një burim energjie i qëndrueshëm, burim prodhimi, duke marrë parasysh dhe tek lidhjet infrastrukturore në male, janë elemente referuese të një peisazhi formal të qytetit si dhe burim turizmi.

Format e identifikuar urbane paradigmatisht, si bulevardit, kalaja dhe kështjella janë pika të konsiderueshme, të rëndësishme, të përputhjes së natyrës me hapësirat urbane të themeluara.

Duke u bazuar tek pikat e lartëpërmendura, rigjenerimi për formën e qytetit nëpërmjet ndërtimit të vendeve përfaqësuese kolektive, vende në frontet kryesore të saj, të rikonstruksionit të Lagjjes së Dëshmorëve si dhe të Kukësit të nëndheshëm, rishikimit të Zonës industriale, si dhe konsiderimin e pasurive dhe monumenteve të Natyrës, të ndërtimeve fortifikuese si dhe të banesa



tradicionale, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në aspektin historik, kulturor, arkitektonik, ekonomik.

2.2.9 Sintezë e relacionit gjeologjik

Territori administrativ i bashkisë së Kukësit, përfaqson një hapsirë të larmishme, në të gjitha aspektet e gjeologjisë dhe gjeomorfologjisë të vëndit tone. Këtu ndërthuret tektonika e thellë krahinore gjatsore me atë tërthore dhe lokale, tektonika mbihipëse luspure deri ajo e shariazhuar. Këtu janë të pranishme struktura të rendeve të ndryshme dhe haset një gamë e gjërë formacionale, që zë fill nga ato më të vjetërat e njohura në vëndin tonë (Paleozoit), deri në Kuaternar; të përfaqsuar nga formime magmatike, kimike dhe ato terrigjene. Është edhe një territor me relief mjaft të aksidentuar dhe hipsometrikisht me disa lartësi të rendit mbi 2000m.

Në aspektin strukturor, fal edhe zhvillimeve të fuqishme tektonike në kohë, dukuria e tyre në sipërfaqe përfshin / ndërton larmi formash strukturore: nga ato të rregullta, pjesë a fragmente të tyre, luspa tektonike, mbihipje..., e deri masa shkëmbinjsh të shariazhuara në disa kilometra.

Ndër pasuritë nëntoksore të rajonit përmëndim ato të Bakrit, Boksidet, Fekurit, Fe-Ni, Kromit, Polimetalet {Pb-Zn}, Uraniumit, gurët dekorativ, olivinitet, etj. Po ashtu, i pasur është territori në fjale edhe në ujëra nëntokësore ku diferencohen pesë tipe akuiferësh që bashkë me ato sipërfaqësore, përbëjnë pasuri të madhe komunale e industriale (H.C.) lokale dhe kombëtare.

Llojshmëria e shkëmbinjve të pranishëm në territor, mbi bazën e treguesit gjeoteknik "Rezistenca në shtypje", është kategorizuar në këto grupe kryesore: *shkëmbinj të fortë; shk. mesatar; shk. të butë; dhera pa kohezion*

Mbi bazën e kategorizimit të mësipërm, në mënyrë të përgjithshuar, jepen edhe disa nga parametrat gjeoteknikë kryesor të shkëmbinjve që ndërtojnë territorin e B. Kukës, si më posht:

- **Shkëmbinj të fortë**, me rezistencë në shtypje $> 500 \text{ kg/cm}^2$, të përfaqsuar nga llojet e shkëmbinjve magmatikë ultrabazikë, intruzivë dhe efuzivë (lu, lb, lma, Eb, Ema), metamorfikë rreshporë (Rm) rreshporo-gëlqerore (Gr), ata gëlqerorë (G), gëlqerorë-silicorë (Gsi) dhe ata brekçioze-konglomeratikë (B) me këta tregues gjeteknik të përgjithshuar:

Pesha volumore	$\Delta = 2,0 - 2,85 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 2,0 - 45,0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	$R_{sh} = 500 - 1100 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i elasticitetit	$E = 10^2 - 5 \times 10^5 \text{ bar}$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma: >6 - > 10 \text{ kg/cm}^2$
- **Shkëmbinj mesatarë** kanë rezistencë në shtypje $50 - 500 \text{ kg/cm}^2$. Në këtë grup bëjnë pjesë: Konglomeratë e ranorë me çimentim mesatarë (KI), grupi i shkëmbinjve efuzivo-sedimentarë (Es), shkëmbinj të flishorë ritmikë argjilo-alevrito-ranorë (FI), dhe shkëmbinj të



mollasikë argjilor, ranoro-konglomeratike (Ma, Mrk). Parametrat gjeoteknik të përgjithshuar janë:

Pesha volumore	$\Delta = 1.8 - 2,6 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 5.0 - 85,0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	$R_{sh} = 50 - 500 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i elasticitetit	$E = 10^2 - 5 \times 10^3 \text{ bar}$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma: >2.5 - 20.0 \text{ kg/cm}^2$

- **Shkëmbini të butë:** përfaqsohen nga depozitime të vjetëra Kuaternare pjesërisht të çimentuara (De) me çimento karbonatike ose argjilore. Gjëjnë përhapje kryesisht në ultesiren (gropën e Kukësit), po edhe në forma fragmentare në periferi. Në këtë kategori futen edhe zhavorret e poplat me origjinë aluviale dhe proluviale (C) të përhapura kryesisht në fundshpatet apo në zonën e shkarkimeve të prrenjve, si dhe serpentinitet dhe millonitet (Ms). Parametrat gjeoteknik të përgjithshuar janë:

Pesha volumore	$\Delta = 1.7 - 2,4 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 2.0 - 85,0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	$R_{sh} = 50 - 10^3 \text{ bar}$
Moduli i elasticitetit	$E = <50 - 300 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma: 1.8 - >5.0 \text{ kg/cm}^2$

- **Dhera pa kohezion (c=0):** Këtu përfshihen formime të shkrifëta pa lidhje kohezionale (R) që mund të jenë rëra nga kokrrizmëdha deri kokrrizimët në surëra, me trashësi shtresash nga 2 deri në 20 m. si dhe depozitimet aluviale e aluviale-proluviale të sotme Holocenit (Qh) me pamjen e materialit të pa sortuar dhe i përbërë nga ranorë deri zhavorre kokërrtrashë e deri në poplor. Parametrat gjeoteknik të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 1.65 - 2,1 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 25.0 - 80,0 \%$
Kendi i fërkimit të brëndshëm	$\phi = 22 - 40^\circ$
Kohezioni	$c = 0.0 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i deformimit	$E = 150 - 250 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma: 1.8 - 4.0 \text{ kg/cm}^2$
Koefiçenti i filtrimit	$K > 50 \text{ l/24orë}$

Në territorin e bashkisë Kukës, janë të pranishëm edhe mjaft elemente të rrezikut gjeologjik, që jo rrallë, japin mpakte negative në veprat inxhinierike a sociale. Ndër to përmëdim: rrëshqitjet, rrëzimet, shëmbjet, vatrat e erozionit, zonat karstike, problematikat nga prania e përrrenjve dhe lumenjve, thyerjet tektonike, tërmetet, etj. – studimi i të cilave duhet bërë rast pas rasti.





Në "Studimi inxhinjero-sismologjik..." për këtë territor, rreziku sizmik është pasqyruar nëpërmjet nxitimit maksimal horizontal (P.G.A) dhe në analizën e bërë, rezulton se territori i bashkisë Kukës, karakterizohet nga vlera mjaft të larta të rrezikut sizmik, të cilat shkojnë duke u rritur nga veri-perëndimi drejt jugë-lindjes së këtij territori. Për qëllimet e mikrozonimit sizmik të këtij territori, rekomandohet të merren në konsideratë hartat probabilitare të rrezikut sizmik në kondita shkëmbi të paraqitura në këtë studim. Të dhënat e paraqitura, mund të përdoren për qëllime studimore dhe planifikim të territorit, ndërsa vlerësimet e treguesëve sizmik për objekte a vepra të veçanta, duhen bërë në vendin konkret e sipas rregullores në fuqi.

Në materialin e paraqitur tekst dhe grafikë, gjëjnë pasqyrim këto dukuri që shprehen me zonimin përkatës të territorit mbi bazën e kushteve gjeologjike – inxhinierike dhe pranisë së fenomeneve të rrezikut gjeologjik. Problemet e ndotjes mjedisore dhe burimit të tyre, nga stoqet apo minierat e abandonuara, nga karrierat, mbetjet urbane, shfrytëzimi i inerteve, etj. përbëjnë një tjetër aspekt ku tërhiqet vëmëndja në planifikimet dhe masat që do ndërmerren kjo Bashki.

Nevoja e mjedist të pastër, prania e pasurive të mëdha nëntoksore dhe resurseve gjeoambientale, H.C-te dhe vetë pozicioni gjeografik si nyje lidhëse me Kosovën, përbëjnë padyshim vlera e resurse për këtë Bashki, të cilat duhet të njihen dhe planifikohen për t'u kullandrisur me nikoqirllëk.

Gjërësisht, në materialin gjeologjik të paraqitur, jepen edhe rekomandimet përkatëse për çdo disiplinë dhe zgjidhja e tyre në ecuri e rast pas rasti, gjat planifikimit dhe ndërtimit të veprave të ndryshme në territoret e kësaj Bashkie.



3 PROJEKSIONE DEMOGRAFIKE 2030

3.1 Te dhena socio-demografike

Popullsia banuese e rrethit të Kukësit, sipas censusit të vitit 2011, është 47,985 banorë. Kjo popullsi është e shpërndarë në 15 Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV), 1 Bashki dhe 14 komuna. NJQV-te janë : Bashkia e Kukësit dhe Komunat e Bicaj, Bushtricë, Grykë Çajë, Kalis, Kolsh, Malzi, Shishtavec, Shtiqën, Surroj, Tërthore, Topojan, Ujëmisht, Zapod.

Popullsia e NJQV-ve të Kukësit, ashtu sikurse të gjithë qarqet periferike ka pësuar rënie të ndjeshme duke filluar që nga fillimi i viteve '90. Kjo rënie ka prekur të gjithë zonën në përgjithësi por disa komuna në vecanti, paraqesin shifra emblematike dhe vëne në dukje një shpopullim të përmesave shqetësuese. Në rast se në vitin 1989, popullsia e zonës në rang qarku ishte 79.568 banorë, ajo është reduktuar në 63.786 në vitin 2001 dhe ka vijuar zbritjen me ritme akoma të shpejta për dhjetëvjeçarin në vijim me -24.8 %. Humbja totale gjatë periudhës 1989-2011 është 39.7% dhe numri i popullsisë ka zbritur në 47.985 banorë në vitin 2011. Situata behet akoma më alarmante në rast se konsiderojmë komuna të vecanta, sidomos ato të zonave të thella malore si psh: Arren, Kalis, Topojan, Ujëmisht, Surroj, ku vëhet re një braktisje me shifra alarmuese

nr	komuna	Popullsia banuese			Diferenca në %		
		Popullsia viti 1989	Popullsia viti 2001	Popullsia viti 2011	Diferenca 2001-1989	Diferenca 2011-2001	Diferenca 2011-1989
1	ARREN	4,531	981	462	-78.3%	-52.9%	-89.8%
2	BICAJ	7,930	7,022	5,631	-11.5%	-19.8%	-29.0%
3	BUSHTRICE	4,180	2,560	1,486	-38.8%	-42.0%	-64.4%
4	GRYKE ÇAJE	3,315	2,492	1,440	-24.8%	-42.2%	-56.6%
5	KALIS	3,621	1,881	827	-48.1%	-56.0%	-77.2%
6	KOLSH	2,110	1,591	1,250	-24.6%	-21.4%	-40.8%
7	KUKES	16,555	17,157	16,719	3.6%	-2.6%	1.0%
8	MALZIU	6,351	5,017	3,072	-21.0%	-38.8%	-51.6%
9	SHISHTAVEC	6,871	5,871	3,835	-14.6%	-34.7%	-44.2%
10	SHTIQEN	2,570	3,777	3,438	47.0%	-9.0%	33.8%







11	SURROJ	2,846	1,950	1,099	-31.5%	-43.6%	-61.4%
12	TERTHORE	5,476	4,056	2,959	-25.9%	-27.0%	-46.0%
13	TOPOJAN	4,997	3,561	1,753	-28.7%	-50.8%	-64.9%
14	UJMISHT	4,970	2,913	1,797	-41.4%	-38.3%	-63.8%
15	ZAPOD	3,245	2,957	2,217	-8.9%	-25.0%	-31.7%
	TOTALI	79,568	63,786	47,985	-19.8%	-24.8%	-39.7%

Ne rast se konsiderojme dy periudhat 1989 -2001 dhe 2001-2011, vihet re qe shpopullimi ka filluar ne periudhen e pare por ka vijuar me ritme akoma me te theksuar ne periudhen ne vijim 2001-2011. Gjate kesaj periudhe te gjitha NJQV-te kane pesuar ulje te numrit te popullsisë me perjashtim ne bashkise Kukës dhe komunes Shtiqen, te cilat ishin gjithashtu te vetmet njesi vendore qe kishin regjistruar rritje gjate periudhes 1989-2001.

Konkretisht ne komunën Arren, popullsia është reduktuar me -78.3% ne periudhen 1989-2001 dhe ka vijuar me tej shpopullimi me ritme gjithësesi te larta gjate periudhes 2001-2011, duke regjistruar -52.9%. Ne total kjo komune ka humbur rreth 90% te popullsisë ne vetm 22 vjet dhe perben nje shembull emblematic per tu pasur ne konsiderate te vecante ne politikat e zhvillimore. Nje situatë e ngjashme vihet re edhe Kalis(-77.2%), Topojan(-64.9%), Ujmisht(63.8%), Surroj (61.4%).





Bashkia Kukës së bashku me komunën Selishtë janë të vetmet zona ku nuk kemi rritje por rritje të numrit të popullsisë. Bashkia Kukës ka regjistruar një rritje prej 3.6% gjatë periudhës 1989-2001 duke kaluar nga 16.555 banorë në 17.157 banorë por ka pasur një trend me shenjë të kundërt gjatë dekadës tjetër 2001-2011, me një rritje të popullsisë prej -2.6%. Sidoqoftë popullsia e bashkisë së Kukësit është rritur me 1% gjatë 1989-2011, pasi qyteti i Kukësit përben një pikë nervralgjike për zonën dhe destinacion kryesor të migrimit të brendshëm të popullsisë.

		Popullsia	Dendësia	Grupmosha			Perberja gjinore		Raporti Gjinor
				0-14	15-64	65+	Meshkuj	Femra	
	Gjithsej	47,985		13,719	30,956	3,310	24,229	23,756	
	Ne përqindje			28.6%	64.5%	6.9%	50.5%	49.5%	
1	ARRËN	462	7.9	161	272	29	240	222	108.1
2	BICAJ	5,631	71.1	1,595	3,613	423	2,802	2,829	99.0
3	BUSHTRICË	1,486	37.0	423	987	76	764	722	105.8
4	GRYKË ÇAJË	1,440	16.1	455	886	99	718	722	99.4
5	KALIS	827	27.8	271	508	48	439	388	113.1
6	KOLSH	1,250	28.6	352	831	67	650	600	108.3
7	KUKËS	16,719	1,221.6	4,612	11,021	1,086	8,385	8,334	100.6
8	MALZI	3,072	16.3	958	1,883	231	1,584	1,488	106.5
9	SHISHTAVEC	3,835	62.9	976	2,510	349	1,840	1,995	92.2
10	SHTIQËN	3,438	99.6	951	2,266	221	1,820	1,618	112.5



11	SURROJ	1,099	16.3	333	693	73	563	536	105.0
12	TËRTHORE	2,959	44.5	825	1,947	187	1,528	1,431	106.8
13	TOPOJAN	1,753	23.2	504	1,124	125	916	837	109.4
14	UJËMISHT	1,797	33.6	595	1,088	114	900	897	100.3
15	ZAPOD	2,217	52.3	708	1,327	182	1,080	1,137	95.0

3.1.1 Dendësia

Kukësi, si Bashki dhe qender urbane, ka dendësi populsi relativisht të lartë ,1.013 banorë/km². Dendësia mesatare e zones është 51 banorë/km². Vërehet se kjo shifër është mjaft e ulët në disa komuna, ku dendësia arrin në shifra fare minimale si komuna Arren me 8 banore/km² apo Surroj , Malzi dhe Gryk Cajë me rreth 16 banore/km².

Te vetmet komuna me dendesi mbi mesataren rajonale janë Shtiqen me 99 banore/km² dhe Bicaj me 71 banore/km². Dendesia mjaft e ulët në shumicën e komunave të Kukësit nga njëra ana vjen si konsekuencë e terrinit malor dhe shifrave historike të këtyre zonave por nga ana tjetër është dëshmi e shpopullimit në masë të motivuar nga kushtet ekonomike. Dendësia mjaft e ulët e disa prej komunave dhe vështirësitë e komunikimit midis tyre si pasojë e infrastruktures dhe terrenit malor, bëhet vertet penalizues kur bëhet fjalë për aksesin ndaj disa shërbimeve me karakter arsimor, Shëndetësor, Kulturor, Sportiv dhe të tjera shërbime me karakter social. Kjo për arsye se në një këndvështrim të optimizimit ekonomik të burimeve njerëzore dhe financiare nga ana e administratës publike, ofrimi i disa shërbimeve rezultoi ekonomikisht deficitar.

3.1.2 Përberja gjinore

Nga totali i popullsisë banuese prej 47.985 banorë, 24.229 janë meshkuj (50.5%) dhe 23.756 (49.5%) janë femra. Raporti gjinor është 1.01 dhe evidenton një dominancë të lehtë të meshkujve në krahasim me femrat. Ky fakt është karakteristikë socio-kulturore tipike e zonave të veriut të shqipërisë në lidhje me prezencën e femijëve meshkuj në berthamat familjare. Pothuajse në secilën nga komunat, koeficienti meshkuj/femra është më i madh se 1 (>1) por në vecanti në komunat Shtiqen dhe Kalis ky koeficient paraqet vlerat më të larta 1.12 (112 meshkuj për 100 femra).

3.1.3 Grupshat

Popullsia e Kukësit është një popullsi e re me grupmoshën 15-64 vjeç që zëpeshën kryesore, me 30.956 banorë dhe përbejnë rreth 64.5% të totalit të popullsisë banuese. Me pas renditet grupmosha 0-14 vjeç me 13.719 banorë e cila përben rreth 28.6% të totalit të popullsisë banuese. Numri i të moshuarve (mbi 65 vjeç) është 3.310 dhe përben 6.9 % të popullsisë.



Nr	NJQV-te	Raporti i varesise			Popullsia ne % sipas grupmoshes		
		se pergjitheshme	te rinjve	te moshuarve	(0-14)	(15-64)	(65+)
1	ARRËN	69.9%	59.2%	10.7%	34.8%	58.9%	6.3%
2	BICAJ	55.9%	44.1%	11.7%	28.3%	64.2%	7.5%
3	BUSHTRICË	50.6%	42.9%	7.7%	28.5%	66.4%	5.1%
4	GRYKË ÇAJË	62.5%	51.4%	11.2%	31.6%	61.5%	6.9%
5	KALIS	62.8%	53.3%	9.4%	32.8%	61.4%	5.8%
6	KOLSH	50.4%	42.4%	8.1%	28.2%	66.5%	5.4%
7	KUKËS	51.7%	41.8%	9.9%	27.6%	65.9%	6.5%
8	MALZI	63.1%	50.9%	12.3%	31.2%	61.3%	7.5%
9	SHISHTAVEC	52.8%	38.9%	13.9%	25.4%	65.4%	9.1%
10	SHTIQËN	51.7%	42.0%	9.8%	27.7%	65.9%	6.4%
11	SURROJ	58.6%	48.1%	10.5%	30.3%	63.1%	6.6%
12	TËRTHORE	52.0%	42.4%	9.6%	27.9%	65.8%	6.3%
13	TOPOJAN	56.0%	44.8%	11.1%	28.8%	64.1%	7.1%
14	UJËMISHT	65.2%	54.7%	10.5%	33.1%	60.5%	6.3%
15	ZAPOD	67.1%	53.4%	13.7%	31.9%	59.9%	8.2%

Ne rast se analizojme situaten e perberjes se popullsisë sipas grupmoshave ne secilen komune,ne disa raste vihen re devijime nga mesatarja e zones. Konkretisht, **grupmosha kryesore 15-64 vjec**, ka vlerat me te larta ne Kolsh(66.5%), Bushtrice(66.4%), Kukes(65.8%), Terthore(65.8%), Shishtavec(65.4%), ndersa ka vlerat me te uleta ne komunat Arren (58.9%), Zapod(59.9%), Ujmisht(60.5%), Malzi(61.3%), Kalis(61.4%) Gryke Caje(61.5%).

Grupmosha 0-14 vjec ka peshem me te larte ne komunat Arren(34.8%), Ujmisht(33.1%), Kalis 32.8% , Zapod (31.9%) dhe Gryk Caje(31.6%) ndersa vlerat me te uleta i gjeme ne komunat Shishtavec(25.4%) dhe Kukes (27.6%). Ne pjesen tjeter te komunave, kjo grupmoshe, regjistron vlera shume prane mesatares se zones prej 28.6%.

Pjesa e moshuar e popullsisë (mbi 65 vjec),ka peshen specifike me te ulet ne krahasim me grupmoshat e tjera dhe mesatarisht perfaqson me pak se 7% te popullsisë. Ajo kap vleren maksimale ne komunat Shishtavec(9.1%) dhe Zapod(8.2%) ndersa pjesa tjeter e komunave jane ose ne linje me mesataren ose nen te. Kane vlera ndjeshem nen mesataren komunat Bushtrice(5.1%),Kolsh(5.4%) dhe Kalis(5.8%). Pamvaresisht ndyshimeve te vogla midis komunave, padyshim qe zona e Kukesit ka nje perberje moshore te popullsisë mjaft te favorshme ne te tashmen por me edhe ne te ardhmen pasi pjesa aktive e popullsisë perben rreth 65% te popullsisë ndersa te moshuarit zene me pak se 7%. Pjesa e larte qe kane te riqite ne strukturen e popullsisë





perben faktore optimizmi per te ardhmen per nga aspekti I dinamikave te tregut te punes, por nga ana tjeter, ben te domosdoshme nje nderhyrje specifike per t'ju pergjigjur nevojave te kesaj grupmoshe per edukim,shendetesi, kulture, etj.

3.1.4 Koeficientet e varesise

Raporti I varesise se pergjitheshme tregon barren ekonomike te popullsisë aktive per te perballuar pjesn e popullsisë qe kane dale apo akoma nuk kane hyre ne ciklin produktiv. Raportet e varesise moshore kane rendesi ne planifikim public te sherbimeve dhe burimeve per tu destinuar seciles kategori moshore pasi pamvarsisht se sit e rinjte qofte te moshuarit jane ngarkese ekonomike per shoqerine por keto dy kategorik kane nevoja krejtesisht te ndyshme.

Nga sa pame me lart, zona e Kukesit karakterizohen nga dominimi i popullsisë aktive per pune (15-64 vjec, pesha relativisht e larte e grupmoshave te reja (0-14 vjec) si dhe perqindja e ulet qe zene te moshuarit ne totalin e popullsisë. Ne komunat ku kishim presence me te madhe te te rinjve si per shembull Arren(34.8%), Ujmisht(33.1%), Kalis 32.8% , Zapod (31.9%) dhe Gryk Caje(31.6%) raportet e varesise se te rinjve marrin vlerat maksimale me perkatesisht 59.2%, 54.7%, 53.3%, 53.4% dhe 51.4% ndersa vlen e kunderta per komunen Shishtave dhe bashkine e Kukesit me raporte te varesise rinore prej 38.9% dhe 41.8%.

Bashkia e Kukesit ka raportin me te ulet te varesise se te rinjve ne vecanti por paraqet edhe nje prej vlerave me te uleta te raportit te varesise se pergjitheshme, I cili jepet nga shuma e raporteve te varesise se te rinjve dhe te moshuarve.

Nr	Bashkia/Komuna	Ndryshimi ne % (2011-2001)		
		Totali I popullsisë	0-14 vjec	65+ vjec
1	ARRËN	-52.9%	-20.7%	-3.8%
2	BICAJ	-19.8%	-12.9%	0.2%
3	BUSHTRICË	-42.0%	-21.7%	-2.3%
4	GRYKË ÇAJË	-42.2%	-19.3%	-0.5%
5	KALIS	-56.0%	-25.6%	-2.4%
6	KOLSH	-21.4%	-16.5%	-0.5%
7	KUKËS	-2.6%	-8.0%	1.4%
8	MALZI	-38.8%	-19.6%	-2.1%
9	SHISHTAVEC	-34.7%	-20.3%	0.3%
10	SHTIQËN	-9.0%	-13.6%	0.9%
11	SURROJ	-43.6%	-19.9%	-2.3%
12	TËRTHORE	-27.0%	-17.1%	0.0%
13	TOPOJAN	-50.8%	-25.7%	-1.8%
14	UJËMISHT	-38.3%	-17.0%	-1.7%
15	ZAPOD	-25.0%	-14.5%	1.4%

Konkretisht ne rast se analizojme *ndryshimin e popullsisë ne dekadën 2001-2011*, vihet re nje fenomen mjaft domethenes ne perpjekje per te kuptuar tendencat demografike te se ardhmes.



Nga njera ane vihet re nje fakt te cilin e kemi nenvizuar tashme qe eshte **renja drastike e numrit te popullsise**. Nga ana tjetere edhe pse nje popullsia relativisht e re me peshe specifike te rinjve mjaft te larte, zona e Kukesit po perjeton nje **renje te numrit te rinjve** me ritme mjaft te larta ndersa popullsia ne moshe te thyer ka qene relativisht e stabilizuar me nje tendence ne rritje.

3.1.5 Lindshmeria

Kukesi se bashku me Dibren, paraqet koeficientin bruto te lindjeve me te larte ne shkalle vendi dhe regjistron rritje natyrore positive me reth 14 lindje per 1000 banore. Numri mesatar i femijëve për çdo grua është ndër më të lartit në krahasim me mesataren e Shqipërisë. Niveli i lindshmërisë është më i ulët, me të paktën një femijë, në zonat urbane në krahasim me ato rurale. Edhe pse lindshmeria ka pesuar renje ne krahasim me vitet 80-90 dhe vijon renjen edhe aktualisht, ajo perseri mbetet ne nivele te larta ne shkalle vendi.

3.1.6 Indeksi sintetik i fekonditetit

Indeksi sintetik i fekonditetit prej 2.33, tejkalon dukshem mesataren e vendit prej 1.7 dhe e ben Kukesin nder te paktit qarqe te vendin qe tejkalon normen prej 1.7, nivel ky qe perfaqson edhe vleren minimale te vetë riprodhimit te shoqerise per te garantuar vijueshmerine e saj ne kohe. Kukesi rezulton me rritje natyrore te popullsise positive. Arsyeya eshte niveli i larte i lindshmerise, i cili vijon te mbetet ne ritme te larta pamvarsisht tendencies ne rang vendi, si dhe reduktimi i vdekshemrise ne dekadat e fundit si pasoje e rritjes se nivelit te jeteses.

3.1.7 Vdekshmeria

Për shkak të përmirësimeve të mëdha në sistemin shëndetësor dhe në shëndetin publik, vdekshmëria ka pasuar rënie të qëndrueshme për të gjitha moshat. Ndërmjet viteve 1950 dhe 1989, jetëgjatësia në lindje u rrit nga për burrat dhe për gratë. Vdekshmëria e të rriturve vijon te jete ne renje. Vdekshmëria foshnjore, nga ana tjetër, ka qene ne nivele te larta të larta deri ne vitin 1989 me pas ka ardhur duke u reduktuar nga viti ne vit.

3.1.8 Popullsia urbane/rurale dhe migrimi i brendeshem

Popullsia e zones se Kukesit ka qene dhe eshte kryesisht rurale. Duke filluar qe nga fillimi i viteve '90, kemi nje tendence evidente te reduktimit ne numer te popullsise si dhe levizje te popullsise nga fshati ne drejtim te qytetit, duke shkaktuar luhatje te ndjeshme te raportit historik popullsi urbane- rurale. Popullsia urbane banuese eshte e perqendruar kryesisht ne qytetin e Kukesit. Ne rast se popullsia urbane perbente reth 21% te popullsise ne vitin 1989, ajo u rrit ne rreth 27% ne vitin 2001 dhe aktualisht perben rreth 35% te popullsise. Ndyshimi i raportit popullsi urbane/rurale i detyrohet kryesisht faktit se migrimi nga zonat rurale ka qene me i larte se ai urban.





komuna	Popullsia viti 1989	Popullsia viti 2001	Popullsia viti 2011	Diferenca 2001-1989	Diferenca 2011-2001	Diferenca 2011-1989
TOTALI	79,568	63,786	47,985	-19.8%	-24.8%	-39.7%
URBANE	16,555	17,157	16,719	3.6%	-2.6%	1.0%
RURALE	63,013	46,629	31,266	-26.0%	-32.9%	-50.4%

Popullsia e qytetit te Kukësit është rritur me 3.6% gjate periudhes 1989-2001 dhe me pas ne periudhen 2001-2011, ka pesuar nje renje prej 2.6%, duke shenuar nje rritje te akumuluar prej 7.6% (viti 2011 ne raport me vitin 1989). Kjo rritje e popullsisë ne zonat urbane l detyrohet prurjeve nga fshatrat, te cilat ne disa raste kane regjistruar renje deri edhe ne 50%.

Ne Analizen e tendencave ne perqindje duhet patur kujdes me relativizimin e indikatorëve pasi nese arsyetojme ne terma te absolute, shtimi i popllsise urbane prej 1% gjate periudhes 1989-2011, perfaqson nje shtim prej vetem 164 banoresh, ndersa renja prej -50.4% i popullsisë rurale l korrespondojne rreth 31.750 banore.

Kjo lloj levizje e popullsisë me **tendence drejt urbanizimit**, mundet te ndahet ne dy faza. Ne nje **faze te pare (viti 1989-2011)**, popullsia rurale e fshatrave ka levizur ne drejtim te qytetit te Kukësit dhe ndersa vete popullsia urbane e qytetit te Kukësit ka levizur drejt qendrave kombetare urbane si Tirana dhe Durresi. Gjate kesaj faze, zona humbi rreth 19.8% te totalit te popullsisë ose 15.782 banore , ku popullsia rurale u reduktua me 16.384 apo -18.6%, ndersa ajo urbane u shtua me 602 banore apo + 3.6%.

Ne ate qe mund te quajme **faze te dyte (viti 2001-2011)**, te dy kategorite, urbane dhe rurale, kane migruar ne drejtim te metropolit me ritme akoma me te larta se periudha paraardhese, duke regjistruar nje humbje ne numrin e popullsisë totale prej -24.8% nga -19.8% te periudhes paraardhese. Ne kete faze vihet re qe shpopullimi l fshatit ka vijuar akoma me shume por qe edhe popullsia urbane ka pesuar renje ne vlere absolute.

3.1.9 Emigrimi dhe migrimi l brendeshem

Zona e Kukësit ka nje nga normat me te larte te migrimit te brendeshem te popullsisë dhe renditet ne vendin e dytë menjehere pas zones se Dibres. Norma bruto e ndyshimit te popullsisë ka qene 9.6% ne 2014. Qarku l Kukësit së bashku me ate te Dibres, jane dy zona ku migrimi l brendeshem drejt zonave urbane është po aq l rendesishem sa migrimi nderkombetar. Keto zona kane pasur dhe vazhdojne te kene nje shpopullim te fshatrave te zonave malore drejt qendres rajonale (qyteti l kukësit) dhe ne te njejten kohe, nje fluks tjeter dales nga qyteti l Kukësit drej qendrave kombetare si Tirana dhe Durresi.



3.1.10 Tendenca demografike – Projektion 2031

Gjatë dy dekadave së fundit, situata demografike në zonën e Kukësit ka ndjekur të njëjtën tendencë me zonat e tjera në veri dhe veri-lindje. Ajo është karakterizuar nga një *lëvizje e përgjithshme e popullsië drej qendrave metropolitane të vendit (Tirane dhe Durrës)* si dhe nga *migracionit i popullsisë rurale drejt qendres Urabane rajonale te qytetit te Kukësit*. Migrimi më i lartë, ka ndodhur gjatë viteve 2000-2006. Që nga viti 2006, ndryshimi është më i vogël. Tendenca e lëvizjes ka qenë e pranishme pothuajse në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore por më e dukshme në disa fshatra malore ku për shkak të vështiresive ekonomike dhe aksesit në shërbimet përsosore, numri i popullsisë është reduktuar edhe me mbi 50%.

Projektionet demografike të INSTAT, sipas hipotezave të skenarit të mesëm, sygjerojmë për një *reduktim të vazhdueshëm të numrit të popullsisë në dy dekadat e ardhshme*. Shifra e parashikuar është mbi 30%. Ky fakt do të ketë ndikim të ndjeshëm në zhvillimet ekonomike dhe sociale të zonës ku rreziku është shpopullimi masiv i zonave malore si pasoje e spostimit drejt metropoleve të forca të punës aktive së bashku me kapitalin dhe energjitë njerëzore. Tjetër fakt shqetësues është se, migrimi prek fashen aktive të popullsisë duke bërë që të ndyshojnë raportet e varesisë moshore të popullsisë

Në aspektin e përberjes së popullsisë, lindshëmria pritet të ulet akoma me shumë duke reduktuar përpjesën e brezit të ri, ndërsa përmirësimet e kushteve të jetesës pritet të rrisin peshën e të moshuarve në shoqëri. Edhe pse popullsia është më e re se pjesa tjetër e vendit tendenca edhe në këtë zonë është drejt plakjes.

Sic konstatohet nga tabela e projektimit të popullsisë deri në vitin 2031 (sipas INSTAT), grupmoshat nga –60 vjeç do të reduktohen me norma nga 16.3% deri edhe në 60% ndërsa grupmoshat mbi 60 vjeç do të vijne në rritje me norma nga 1.5% deri në 118%.

Grupmosha	Viti 2011	Viti 2021	Viti 2031	ndryshimi 2031-2011	ndryshimi 2031-2011 ne%
0-4 vjeç	5876	4629	3282	-2594	-44.1%
5-9 vjeç	6380	4548	3706	-2674	-41.9%
10-14 vjeç	8135	4740	3879	-4256	-52.3%
15-19 vjeç	9293	5064	3724	-5569	-59.9%
20-24 vjeç	7467	5811	3581	-3886	-52.0%
25-29 vjeç	5722	5990	3638	-2084	-36.4%
30-34 vjeç	5184	4864	4190	-994	-19.2%
35-39 vjeç	5405	4060	4526	-879	-16.3%
40-44 vjeç	5813	4034	3957	-1856	-31.9%
45-49 vjeç	6210	4373	3401	-2809	-45.2%
50-54 vjeç	5890	4715	3370	-2520	-42.8%





55-59 vjec	4721	5055	3624	-1097	-23.2%
60-64 vjec	3754	4645	3807	53	1.4%
65-69 vjec	3335	3587	3932	597	17.9%
70-74 vjec	2845	2708	3461	616	21.7%
75-79 vjec	1796	2169	2435	639	35.6%
80-84 vjec	977	1521	1530	553	56.6%
85+	596	908	1297	701	117.6%
TOTALI	89399	73421	61340	-28059	-31.4%

Ne rast se analizojme ne brendesi te intervaleve moshore, renja e popullsisë do te jete me e madhe ne bazen e piramides se popullsisë me norma nga -40 deri ne -45% per moshat 0-9 vjec dhe nga -52% deri ne -60% per moshat 10-19 vjec dhe -52% per grupmoshen 20-24 vjec.

Tkurrja e mesit te piramidis perseri do te jete me ritme te larta edhe pse ne mase me te ulet se intervali paraardhes. Reduktimi i popullsisë per kete pjese te popullsisë (moshat 25-44 vjec) do te jete me e larte per moshat ne fillim te ketij intervali(ne masen 36% per intervalin moshor 25-29 vjec),do te stabilizohet disi ne pjesen e mesit te intervalit (moshat 30-39 vjec) por paraqet ritme te renjes perseri te larta ne fund , me grupmoshat 44-54 qe do te reduktohen me me shume se 40% .

Te vetmet grupmosha qe do te njohin rritje jane ato mbi 60 vjec. Rritja do te jete gati e paperfillshme per moshat 60-64(1.4%), relativisht e permbajtur per moshat 65-75 (17.9% dhe 21.7%) dhe do rritet ne menyre progressive per grupmoshat ne vijim. Popullsia ne pleqeri te thelle do kete rritjen me te madhe (+117.6% per 85+ dhe +56.6% per intervalin 80-84 vjec).

Pra ne konkluzion:

- Ne njezet vitet ne vijim, popullsia pritet te reduktohet me ritme mjaft te larta , rreth 30%
- Si rezultat i renjes se lindshmerise, migrimit te popullsisë drejt metropolit dhe jashte kufijve te Shqiperise si dhe rritjen e jetegjatesise, ky reduktim i popullsisë do te preki kryesisht grupmoshat e reja dhe ato ne moshe pune, ndersa popullsia e moshuar do te rritet me norma diametralisht te kunderta. Pra ne vetem 20 vjet, peshat e te rinjve dhe te moshuarve ne totalin e popullsisë, do te pergjysmohen ne rastin e te rinjve dhe do te dyfishohen ne rastin e te moshuarve, duke pasur per konsekuence nje plakje te paevitueshme te popullsisë me ritme shqetesuese.

3.2 SHËRBIMET PUBLIKE ose me PERDORIM PUBLIK

Rritja dhe zhvillimi i popullsisë në qytetet e Kukësit dhe Dibrës perfshin gjithashtu arsyetimin qe lidhet me shërbimet publike të cilat kanë të bëjnë me vendbanime si: shkollat dhe arsimit në përgjithësi, objektet sportive, objektet sociale për të rinjtë dhe të moshuarit, shëndetësia, transporti.

Dy jane nivelet qe duhet të merren ne konsiderate:



a) aspekti sasior. Sa dhe cilat duhet të jetë ndarjet e materialeve për çdo shërbim.

b) aspekti cilësor. Çfare niveli cilesie duhet te ofrojne shërbimet ekzistuese dhe ato të ardhshme që të quhen të tilla.

Eshte një aspekt i tretë, jo më pak i rëndësishëm, që lidhet me vlerësimin ekonomik. Shërbimet publike janë të lidhura, pothuajse në shumicën e rasteve, me fondet publike, veçanërisht në një ekonomi tradicionale socialiste. Me kalimin në një ekonomi liberale ato rregullohen me marrëveshje nga vet privatet ose në mes subjekteve publike dhe private. Rasti më i spikatur është Shëndetësia dhe sistemi shkollor Universitar plotësisht privat me një kosto shumë të lartë të implementimit dhe menaxhimit i cili bëhet i paarrtshëm për shumicën e qytetarëve. Shpenzimet për të paguar arsimin universitar ose shërbimet spitalore janë të pamundura për tu perballuar dhe për një familje mesatare amerikane.

Por në anen tjetër, resurset publike nuk janë të pafundme dhe janë subjekt i financimit që lidhet me Buxhetin kombëtar dhe transfertat nga Shteti në Entin lokal dhe më pas në atë fiskal (taksa për familjet dhe bizneset). Në rastin e Kukësit dhe Dibrës një burim shtesë mund të përfaqësohet nga shfrytëzimi i burimeve lokale: uji për energjinë elektrike dhe veprimtaritë e minierave. Pjesa shtesë (suficiti) e nxjerre nga këto burime nga investitorët privatë duhet të qëndrojë në vend për të realizuar punë dhe shërbime publike ose për përdorim publik.

Llogaritja e shperndarjes se shërbimeve duhet të bëhet si në raport me popullsinë ashtu dhe duke marrë në konsideratë shërbimet prezente dhe / ose të munguara. Në këtë fazë të punës (në pritje të të dhënave të kerkuara nga autoritetet lokale), mund të behen gjykime dhe vlerësime të përgjithshme, duke e lene për tu thelluar me teper në fazën e tretë.

1) Shërbimi shkollor_ Shërbimi shkollor fillor nuk duket i vogël. Reduktimi i popullsisë lejon për të programuar më mirë madhësinë e klasave dhe shërbimeve të lidhura me të. Më kritikë paraqitet cilësia e ndërtimit të objekteve të cilat shpesh janë të vjetra dhe mirëmbajtje të dobët.

Ekziston nevoja për të identifikuar hapësira publike për formimin profesional të fermerëve apo të ekspertëve të turizmit. Behet fjale për hapësira që do të përdoren kohe pas kohe. Megjithatë në këtë rast, komunat kanë hapësira kolektive që i japin hua për këtë lloj aktiviteti (p.sh.. sallat polivalente në Peskhopi dhe në Kukës).

2) Shërbimet sportive. Të dy vendet janë të pajisura me shërbime sportive, fusha futbollit dhe palestra. Ndoshta këto aktivitete duhet të zhvillohen më tej duke ndërtuar një ndertese sportive. Ndoshta mund të propozohet një pishinë e hapur në afërsi të bregut të liqenit të Kukësit.

3) Shërbimet sociale për të rinjtë dhe të vjetrit. Behet fjale për vende takimi për pjesën e popullsisë që kanë në dispozicion mjaft kohë të lirë. Për të rinjtë është e nevojshme për të gjetur vende ku ata mund të mbledhen dhe të kryejnë aktivitetet sociale. E njëjta gjë për të moshuarit që kanë arritur moshën e daljes në pension dhe dalin për të diskutuar dhe për të kryer aktivitete për të kaluar kohën. Për të dy këto grupmosha një praktikë e vlefshme është frekuentimi i "bareve të



sheshit". Në Kukës dhe Dibër ka zona që i nenshtrohen projekteve speciale të rikuperimit urban ku parashikohet dhe realizimi i këtyre hapësirave. Psh. në Kukës rigjenerimi i ish-zonës industriale do të sigurojë përfshirjen e strukturave për të rinjte dhe të moshuarit që mund të jepen një grupi qytetarësh të cilët do të marrin përgjegjësinë për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e zakonshme.

4) Shërbimet e Shëndetit. Përveç spitaleve ekzistuese që duhet të kryejnë mirëmbajtjen e zakonshme dhe riparimet, është e rëndësishme të disponohen shërbime të lokalizuara në qendrat me të vogla për ndihmën e parë dhe për transferimin e shpejtë (me ambulancë ose helikopter) në spitalin më të afërt.

5) Shërbimet e transportit publik. Në mungesë ose pamjaftueshmëri të një transporti publik ekstra-urban, transporti është organizuar privatisht me automjete të vogla (autobusë nga 9-12 vende). Behet fjale për një transferim të shërbimeve nga publike në private i cili ka ardhur në mënyrë spontane dhe jo të rregullt. Plani Urbanistik mund të favorizojë këtë lloj aktiviteti duke organizuar hapësira të caktuara për parkimin e këtyre mjeteve, duke krijuar stacione të mbërritjes / nisjes. Psh. Në Peshkopi një nga projektet e veçanta ofron pikërisht realizimin e një stacioni ndërlidhës të transportit ekstra-urban. Individët të cilët bëjnë përdorimin e këtij shërbimi mund të paguajnë një pjesë të kostos së biletës për të mirëmbajtur strukturën dhe shërbimet që lidhen me të.

TABELA E HAPESIRAVE STANDARTE TE NEVOJSHME DERI ME 2031 (Ref. Ligji 671/2015 – art. 81)


Viti	Popullsia viti	Hapësirë e gjelbër 9 m ² /banor	Kopsht, çerdhe, shkolla 4.5 m ² /banor	Struktura për përdorim publik 2 m ² /banor	Territor sportiv 1.6 m ² /banor	Parkim publik 6 m ² /banor
2011	47,985	431,865	215,933	95,970	76,776	287,910
2031	61,340	552,060	276,030	122,680	98,144	368,040

4 PERCAKTIMI I TERRITORIT NE TE 5 SISTEMET DHE ANALIZA SWOT

Territori i bashkise , me qëllim të përgatitjes së PPV, është ndarë në pesë sisteme në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 107/2014 dhe te rregullores aktuale:

1. Sistemi Urban (UB)
2. Sistemi Infrastruktural (IN)
3. Sistemi Natyror (N)
4. Sistemi Ujor (U)
5. Sistemi Bujqesor (B)

Këto sisteme nuk duhet të lexohen si komponente të izoluara, por në ndërveprim të vazhdueshëm dhe lidhje midis tyre në një perspektivë të zhvillimit strategjik të territorit, në bazë të potencialeve, problemeve dhe nevojave te mundshme dhe specifike të çdo sistemi.



Sistemi	Ha	%
<i>Sistemi Urban (UB)</i>	1.598	1,7%
<i>Sistemi Infrastrukturor (IN)</i>	1.421	1,5%
<i>Sistemi Natyror (N)</i>	74.307	79,6%
<i>Sistemi Ujor (U)</i>	2.989	3,2%
<i>Sistemi Bujqesor (B)</i>	13.060	14,0%

4.1 Sistemi Urban (UB)

Per sa i perket insediamentit, sistemi territorial i Kukësit është strukturuar në invariantet e medha natyrore: luginat e ngushta të Drinit të Zi (që shkojnë në drejtimin veri jug) dhe Drinit të Bardhë (lindje-perëndim, në kufi me Bashkinë e Pukës dhe Tropojës), në kryqëzimin e te cilave, mbi fushën bujqësisore, shtrihet qyteti i Kukësit dhe lokalitete të tjera kryesore; në perëndim pjesa kodrinore e mbuluar me pyje dhe lokalitete të tjera kryesore; në perëndim toka kodrinore e mbuluar me pyje dhe burime minenrre; në lindje Parku Kombëtar Korab-Koritnik.

Nga pikëpamja e zhvillimit urban, siç shpjegohet në seksionin e analizës dhe vlerësimit të territorit, Bashkia e Kukësit duket se ka ndjekur gjatë 25 viteve të fundit një trend që ka çuar në shpopullimin, sidomos nga zonat rurale drejt zonave qendrore por edhe, pjesërisht, nga qyteti i Kukësit drejt Tiranës dhe Durrësit. Faktorët përcaktues të kësaj dukurie janë kryesisht të lidhura me kushtet e këqija të punës në bujqësi, produktiviteti i ulët i sektorit dhe cilësia e dobët e aksesit në shërbime të tilla si rrugë, kanalizime, shkollë, ujësjellës. Qarku i Kukësit është konsideruar si një nga më të varfërit në vend (2015) dhe densitetet e ulët të popullsisë në disa zona rurale gjë që pengon investimet në infrastrukturë dhe shërbime, në favor të një zhvillimi të monocentrik. Në qytetin e Kukësit jeton rreth 34% të popullsisë së përgjithshme të qytetit dhe zonat me dendësi të ulët janë ato të Arrën dhe Kalis.




Figura 1: Dendësia e banimit e sistemit insediativ të bashkisë Kukës

Qyteti i Kukësit është qendra administrative, ekonomike dhe sociale rreth të ciles sillen tërë qarku i Kukësit. Qendrat e tjera të një farë rëndësie nga pika dimensionale dhe ekonomike janë Bicaj, Shtiqën, Shishtavec dhe Shmri (Malzi), por qyteti i Kukësit është konsideruar si i vetmi treg i rëndësishëm në të cilin realizohen shkëmbimet kryesore. Roli primar i Kukësit është dhënë edhe nga ndërveprimi fqinj me Kosovën dhe qytetet e Prizrenit dhe Gjakovës.

Si rezultat i reformës administrative, bashkia e Kukësit është e përbërë nga 14 Njese Administrative që përmbajnë në brendësi nga 3 në 11 fshatra plus qytetin e Kukësit

Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Kukës	Qyteti Kukës - Fshatrat: Gostil, Drinas
Malzi	Shëmri, Shtanë, Petkaj, Mguille, Çam, Gdheshte, Pistë, Spas, Shikaj, Dukagjin, Kalimash, Kryemadh
Bicaj	Bushat, Bicaj, Osmane, Mholaj, Mustafaj, Nangë, Kolesjan, Domaj, Gabricë, Tërshenë
Ujmisht	Lusën, Zallë, Malqene, Resk, Ujmisht, Skavicë, Tejdrine
Tërthore	Morinë, Bardhoc 1, Bardhoc 2, Breg-Lumë, Pobreg, Gjegan
Shtiqën	Shtiqën, Koder Lume, Krenze, Gjallicë
Zapod	Orgjost, Kosharisht, Pakisht, Zapod, Orçikël, Bele, Lojmë
Shishtavec	Shishtavec, Novosej, Kollovoz, Shtrezë, Borje, Oreshkë, Cërnavë

Topojan	Topojan, Xhaferraj, Turaj, Breklje, Nimçë
Bushticë	Bushticë, Gjegje, Matranxh, Palush, Vilë, Barruç, Shpat
Gryk-Çajë	Fshat, Çajë, Buzëmadhe, Shkinak
Kalis	Gështejë, Kodër-Gështejë, Kalis, Gurrë, Pralisht
Surroj	Çinamak, Fusharë, Surroj, Aliaj
Arrën	Arrën, Arrëz, Barrë, Vërrij, Tejmollë
Kolsh	Kolsh, Mamëz, Myç-Mamëz

Në qytetin e Kukësit, edhe pse në vitet e fundit popullsia nuk ka pësuar luhatje të veçanta, ka pasur një zhvillim të shtëpive të reja, veçanërisht në zonat periferike me disponueshmëri të ulët të shërbimeve bazë si furnizimi me ujë, kanalizimet, sanitare. Rreth 43.3% e popullsisë merr ndihmë ekonomike dhe numri me i madh i tyre është regjistruar në Njesite Administrative Kolsh (69.8%) dhe Ujmisht (66.4%).

Numri i banesave sociale është aktualisht 62 apartamente, ndërkohë që kërkesa e familjeve pa shtëpi dhe që kanë nevojë për programet sociale të strehimit është 706. Nga këto të dhëna është e dukshme nevoja për investime në fushën e strehimit social për grupet e ekspozuara.

Nga pikëpamja e shërbimeve shëndetësore në qytetin e Kukësit është një spital në nivel rajonal dhe në vitet e fundit është rritur disponueshmëria e klinikave në zonat rurale, me qëllim ofrimin e shërbimeve bazë dhe të aksesueshme për popullsinë rurale. Çdo fshat ka një klinikë dhe çdo Njesi Administrative ka një qendër shëndetësore. Megjithatë trajnimi i stafit ende nuk është adekuat dhe pajisje dhe furnizimet duhet të përmirësohen.

Për sa i përket shërbimeve arsimore në qytetin e Kukësit kemi: 6 shkolla fillore dhe 3 shkolla të mesme. Ka edhe 3 fakultete që kanë të bëjnë në Universitetin e Tiranës që regjistrojnë gjithmonë e me pak ndjekes.

Ne përfundim të analizës mundet të rëndesim pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kercenimet e sektorit urban:

Anët e Forta

- Pozicioni i favorshëm gjeografik, mundësi për shfrytëzimin e fondeve të BE-së për bashkëpunimin ndërkufitar
- Kukësi sipas politikave kombëtare është qendra sekondare e aglomerateve rajonale, që nenkupton avantazhe nga prania e zyrave dhe shërbimeve publike.

Dobësitë

- Ekspansioni i paplaifikuar i qendrave urbane me mungesë hapësirash publike dhe cilësie urbane
- Eficencë e ulët në ofrimin e shërbimeve
- Infrastrukturë arsimore me cilësi të ulët
- Cilësi e ulët shërbimesh në zonat rurale
- Zhvillim monocenrik



- Mungese banesash sociale per grupet vunerabel

Mundësitë

- Bashkepunim ekonomik dhe social ne nivel rajonal dhe nderkufitar
- Zona industriale per tu rikuperuar dhe rikualifikuar
- Sistemet e fortifikimit për tu kualifikuar si pika identifikuese

Kërcënimet

- Fenomeni i migrimit nga keto zona drejt Tiranës dhe Durrësit
- Tendenca e të rinjve për të braktisur zonën
- Rajoni i Kukesit eshte nder me te varferat ne Shqiperi

4.2 Sistemi Infrastruktural (IN)

Pjese e sistemit infrastruktural jane :

- Rrjetet rrugore te nivelit kombëtar, rajonale dhe lokale
- Linjat hekurudhore
- Porte e aeroporte
- Rrjetet teknologjike që përfshijnë: linjat e energjisë, tubacionet e gazit, ujësjellës, kanalizime

Sistemi Infrastruktural i Kukesit përfshin rrjetet rrugore te nivelit kombëtar, rajonale dhe lokale Qyteti i Kukesit shërben si pikë lidhëse mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë. Në këtë zonë kalon autostrada Durrës-Morinë e cila është pjesë e aksit rrugor kombëtar që lidh Shqipërinë me Kosovën. Në këtë zonë ndodhet pika kufitare më e rëndësishme që lidh Shqipërinë më Kosovën, Morinë/Kukës dhe katër pika kufitare të tjera: Shishtavec, Orgjosë, Borje për këmbësorët dhe Qafa Prush për ngarkesa dhe mjete.

Në qytetin e Kukësit ndodhet aeroporti i Kukësit ndërtuar në 2004, por për shkak të kushteve koncesionare të Aeroportit të Rinasit nuk është në funksion ndersa përbën një potencial për zonën.

Cilësia e infrastrukturës rrugore lë shumë për të dëshiruar ku shume pak nga rrugët lokale janë të asfaltuara dhe pjesa tjetër është e pashtuar. Aktualisht, afërsisht 120 rrugë rurale në këtë zonë janë ende të paasfaltuara. Për të përshkuar rrugën nga komunat deri në Kukës duhen mesatarisht rreth 50-60 min. Ndersa disa komuna te tjera te largeta (> 25 km) si psh: Arren, Ujmisht, Bushtrice, Gryke Cajë, Kalis duan rreth 3 ore udhetim.

Akset kryesore që lidhin qendrën e kësaj zone, qytetin e Kukësit me zonat e tjera janë:

- aksi Kukës - Durrës (1.5 orë)
- aksi Kukës-Peshkopi (1.5 - 2 orë)
- aksi Kukës-Has (40 min)
- aksi Kukës- Shishtavec (30 min)
- aksi Krumë-B.Curri (1.5 – 2 ore)



Megjithëse ngritja e autostradës Durrës-Kukës-Morinë ka krijuar një lirshmëri mjaft të madhe të aksesit nga brenda vendit e krijimit të urave lidhëse me vendet e tjera, infrastruktura e brendshme midis komunave e bashkisë ende ka punë për shkak edhe të terrenit mjaft të vështirë e kushteve të pafavorshme klimaterike. Në katër vitet e fundit investimet në infrastrukturën rrugore kanë qenë shumë të kufizuara dhe të pakta.

Tabela 19: Distancat e udhëtimit nga qendra , Qyteti Kukës

Nr.	Qender Urbane	Qender NJA	Distanca (Km)	Intervali kohor i bllokuar gjate dimrit
1	KUKËS	Malzi (shemri)	35	Periodike
2		Kolsh	11.5	0
3		Surroj	24	2 Jave
4		Arren	51	12 Jave
5		Terthore	13.5	0
6		Ujmisht	24	Periodike
7		Bushtrice	31	Periodike
8		Kalis	46	4 Jave
9		Gryke-Çaje (Fshat)	36.5	Periodike
10		Bicaj	11	0
11		Topojan	20.5	Periodike
12		Shishtavec	31	1 Jave
13		Zapod	21	Periodike
14		Shtiqen	6	0

Burimi: Qarku Kukës

Mirëmbajtja konsiston në pastrim nga dëbora, por edhe mbushje të gropave. Kukësi duke qenë qendër urbane në mirëmbajtjen e rrugëve përfshin edhe mirëmbajtje të trotuareve dhe pushtave të rrjetit KUZ. Në komuna mirëmbajtja është krejt minimale dhe pjesa më e madhe e shërbimeve të mirëmbajtjes konsiston në pastrimin e rrugëve nga dëbora. Ky shërbim në shumë raste bëhet edhe në bashkëpunim me qarkun dhe prefekturën kur ka situata emergjence. Komunitat që ofrojnë mirëmbajtje për rrugët komunale që kanë në administrim ofrojnë një mirëmbajtje krejt të papërfillshme për standartet..

Në qytetin e Kukësit, përdorimi i transportit publik nga qytetarët për lëvizje ndërmjet zonave të ndryshme është tepër minimal. Pjesa më e madhe e shërbimeve të transportit ofrohet nga sektori privat nëpërmjet shërbimit të furgonave dhe shërbimit taksi. Aktualisht, infrastruktura e fragmentuar ndërmjet bashkive e komunave bën që aksesin ndaj këtij transporti të jetë i ulët. Në gjithë zonën mungojnë stacionet e udhëtarëve, c'ka bën që lëvizja e automjeteve dhe pikat e ndalimit të pasagjerëve të vendosen arbitrarisht edhe pa një plan të caktuar të pikave të transportit urban e ndërurban.

Transporti i udhëtarëve nga komunitat drejt Kukësit bëhet në mënyrë jo të rregullt. Edhe pse Transporti nga Kukësi në komunitat e afërta është i shpeshtë pothuaj cdo orë, nuk ka linja të dedikuara për shërbimin e transportit të qytetarëve nga komunitat drejt Kukësit.



Linjat kryesore të transportit të udhëtarëve me qendrat kryesore të vendit si Tiranë dhe Durrës bëhen nga Kukësi. Nga Kukësi në drejtim të Tiranës dhe Durrësit transporti është disi më i rregulluar. Janë dy kompani të licensuara që ofrojnë shërbimin ndërqytetas me autobusë. Transporti i udhëtarëve kryhet edhe me mjete si mjete 8+1 dhe mjete taksì, por këto nuk kanë orare të rregullta pasi lëvizin në varësi të nevojave dhe në mes të orareve të autobusëve.

Shërbimi i Ujësjiellës-Kanalizime

Në zonën funksionale të Kukësit ekziston ndërmarrja e ujësjiellës kanalizime Kukës. Ndërmarrja i shërben qytetit të Kukësit dhe dy komunave përreth dhe përkatësisht Shtiqen dhe Bicaj. Ndërmarrja ka një staf prej 70 punonjësish që i shërben një popullsie rreth 40,000 banorë me një orar mesatar prej 9 orësh në ditë dhe një cilësi uji brenda normave. Cilësia e ujit në komuna është e mirë dhe nuk janë raportuar raste sëmundjesh për shkak të ujit, megjithëse është zonë me potenciale minerare.

Prodhimi i ujit është me rënie të lirë gjë që lehtëson kostot operative të ndërmarrjes. Gjatësia totale e sistemit të ujësjiellësit është 115.6 km . Në komuna shërbimi i ujësjiellësit është komunal (Shishtavec, Terthore, Kolsh, Malzi, Topojan, Ujmisht, Grykë-Cajë, Arren, Surroj). Furnizimi i banorëve me ujë në disa fshatra bëhet përmes cezmave publike gjë që e bën mjaft të vështirë situatën e banorëve në komuna.

Problematike mbetet arketimi i faturave në komuna për arsye të gjendjes ekonomike të popullsisë. Kemi një diferencë prej 17.5% të shërbimit të pafaturuar, e cila shkaktohet për shkak të dëmtimeve të rrjetit dhe carjeve të tubacioneve të cilat janë në një nivel shumë të lartë. Përgjithësisht në komuna nuk merret tarifë për ujin pasi gati të gjithë ujësjiellësit në këto komuna janë me rrjedhje të lirë e rrjedhimisht nuk kanë kosto energjie elektrike.

Në zonë ka problematika që kanë të bëjnë me zonat informale dhe të drejtat e pronësisë mbi kanalizimet dhe tubacionet e ujësjiellësit.

Kanalizimet

Ndërsa shërbimi i sistemit të ujërave të zeza i ofrohet vetëm banorëve të qytetit në masën 100%, banorëve të komunave nuk i ofrohet fare ky shërbim. Gjatësia totale e sistemit është 32 km. Vetëm 60.4% e shërbimit arrijn të faturon. Norma mesatare e arkëtimit është 55,3%

Shërbimi i pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve

Në NJQV-te e Kukësit shërbimi i menaxhimit të mbetjeve është shumë i kufizuar dhe lë shumë për të dëshiruar. Komunitat në përgjithësi nuk e kanë këtë shërbim dhe kufizohet kryesisht në mbledhje të mbeturinave sipas një grafiku i cili nuk është i rregullt. Duke qenë se komunitat në përgjithësi kanë konsum të prodhimeve organike, banorët në shumicën e rasteve i trajtojnë vetë mbetjet duke i groposur. Por duke mos patur plane të mirëfillta kompostimi, menaxhimi i mbetjeve ngelet problematik në komuna. Kjo vlen edhe për komunitat që e ofrojnë këtë shërbim, pasi jo gjithmonë banorët dërgojnë mbetjet në vendet e caktuara.



Komunat kanë vende te depozitimit te mbetjeve te cilat ne fakt nuk i kanë standartet dhe nuk plotesojne kushtet per tu quajtur si te tilla. Perjashtim bën Komuna Shishtavec e cila ka një venddepozitim në Madenë dhe ka vendosur një tarifë prej 100 lekë për familje, përqindja e arkëtimit është rreth 20%. Gjithsesi, edhe ne kete rast, shërbimi nuk i ofrohet gjithë banorëve dhe përqindja e mbulimit të shërbimit është minimale.

Të gjitha komunat kane mungesë kapacitetesh financiare për të ofruar shërbimin dhe mungesë të ndërgjegjësimit të banorëve. Komunat vuajnë mungesën e mjeteve dhe të pikave të grumbullimit të mbetjeve në lagjet ose fshatrat e komunës. Në komunat ku ky shërbim bëhet me punonjës të komunës dhe me mjete të vogla, jo mjete teknologjike. Te gjitha komunat buxhetojne shuma modeste per kete qellim, zakonisht me pak se 200.000 leke.

Problematikë vazhdon të mbetet ndërgjegjesimi i banorëve të komunave në lidhje me mbetjet plastike dhe amballazhet. Shpesh nëse nuk groposen ato hidhen në lumej ose përrenj ose në vende të hapura.

Shërbimi i pastrimit të qytetit realizohet nga sektori i pastrimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Bashkisë Kukës. Gjithsesi përqindja e pagesës së tarifave është e kënaqshme, por mbulimi i kostos së shërbimit me tarifë nuk është i kënaqshëm. Shërbimi i pastrimit nga ndërmarrja e pastrimit të Bashkisë konsiston edhe në fshirjen e rrugëve dhe trotuareve të cilat fshihen dhe pastrohen cdo dite. Mbetjet spitalore dhe mbetjet inerte trajtohen nepermjet subjekteve private të kontraktuar nga Bashkia. Grumbullimi i mbetjeve urbane grumbullohen nga bashkia cdo ditë, ndërsa mbetjet inerte një herë në javë.

Problematike ngelet *Liqeni i Fierzës*, gjendja e te cilit sa vjen dhe perkëqsohet për shkak të hedhjes së mbetjeve, sidomos plastike, drjteperdrejte ne liqen por edhe nga lumejtë që e furnizojnë nga komunat fqinje dhe ato të Kosovës.

Nuk ekziston një plan riciklimi apo kompostimi mbetjesh, por persona të ndryshëm, kryesisht shtresa ne varferi ekstreme dhe te emargjinalizuar, mbledhin nga kontenierët materialet metalike dhe plastike, për t'i dërguar në subjektet që merren me trajtimin e tyre.

Elektrifikimi

Nga raporti i Analizes se Detajuar te Zhvillimit Ekonomik e Social të Bashkisë Kukës, niveli i elektrifikimit rezulton si me poshte. Elektrifikimi i qytetit te Kukësit ka përfunduar ne vitin 1975. E megjithatë nevoja për përmirësim të rrjetit sa vjen edhe shtohet.

OSHEE ka nisur investimet për vitin 2015 në Bashkinë Kukës. Vlera e këtij investimi shkon deri ne 26.1 millionë lekë dhe konkretisht konsiston në vendosjen e një rrjeti të ri me kapacitet 20kV, rinkonstruksioni dhe ndërtimi i kabinave 20/0.4 dhe blerja e makinerive apo pajisjeve te nevojshme. Qyteti i Kukësit furnizohet nga 5 fidera (burime energjie elektrike) të ndryshëm që ndahen në 85 kabina elektrike. Ndërsa pjesa tjetër e Njërive Administrative të Bashkisë Kukës furnizohen nga 8 fidera që ndahen në 216 kabina elektrike. Ndarja sipas pikave të nënstacioneve të furnizimit vijon si më poshtë:



- Bashkia Kukës (me përjashtim të NJA Bushtricë, Grykëçajë, Kalisë, Malzi, Surroj dhe Kolsh) furnizohet nga nënstacioni elektrik në fshatin Rexhepaj të NJA Shtiqen e cila është ndërtuar në vitin 1967 dhe ka një kapacitet prej 10KË.
- NJA Bushtricë, Grykëçajë dhe Kalisë furnizohen me energji elektrike nga nënstacioni i Fushë Aliaj (që i përket rajonit të Dibrës).
- NJA Malzi, Surroj dhe Kolsh furnizohen me energji elektrike nga nënstacioni i Kalimashit.
- Humbjet në rrjet për qytetin e Kukësit janë në nivelin 45% , ndërsa niveli i arkëtimeve mbetet i ulët: (i) 15% nga abonentët familjarë; (ii) 70% nga abonentët privatë dhe 80% nga abonentët me statusin institucione shtetërore.

Ne përfundim të analizës mundet të rendesim pikat e forta, dobësitë , mundësitë dhe kërcënimet e sektorit Infrastruktural:

Anët e Forta

- Lidhja me Tiranën përmes autostradës KUKES-DURRES
- Lidhja nepermjet Kosoves me korridorin 10
- Pozicioni strategjik, si porta e hyrjes së veriut të Shqipërisë
- Prezenca e infrastruktures aeroportuale

Dobësitë

- Cështja kyçe kritike është qasja e dobët në brendësi: rrugët në zonat rurale nuk janë të shtruara dhe shpesh bëhen të pakalueshme, sidomos në dimër
- Akses i varfër në ujë dhe pishëm
- Rrjeti infrastrukturor i ujesjellesit i demtuar
- Lidhjet e paligjshme
- Administrimi i mbetjeve joefektiv
- Mungesë e trajtim-largimit të shkarkimeve
- Mungesë parkimesh
- Mungesë e njeve të transportit
- Përdorim joefektiv i burimeve energjitike

Mundësitë

- Kukësi si HUB ndërkombëtar dhe motor zhvillimi ndërkufitar
- Lidhjet me Kosovën e Maqedoninë
- Prezenca e aeroportit, edhe pse i pa shfrytëzueshem
- Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm
- Aktivizimi i aeroportit
- Kukësi si stacion intermodal për të përmbushur nevojat e lëvizjeve ndërkombëtare dhe ato të tranzitit

Kërcënimet

- Fshatrat e brendshme të pa aksesueshem, me rrugë shpesh të pakalueshme
- Transporti publik me Tiranën i dobët



4.3 Sistemi Natyror (N)

Sistemi natyror i Kukësit karakterizohet nga një sasi e madhe e burimeve mjedisore, të tilla si parqet, rezervat, burimeve ujore, shumëllojshmëri të pasur të biodiversitetit. Rreth 40% e territorit është përfshirë në zonën e mbrojtur. Shumëllojshmëria e burimeve natyrore të Kukësit përfshijne: malet, shpellat, kanionet, lumenjtë, liqenet, pyjet dhe kullotat, flora, fauna. Janë gjithsej 41 zona të mbrojtura, ndër të cilat:

1. Pylli I Lisave Novosej,
2. Mështekna Shishtavec,
3. Pishat e Topojanit.

Zonat e mbrojtura, monumentet e natyrës e të kulturës në kufij me liqenin e Fierzës janë:

- Parku Natyror Korab-Koritnik,
- Monumentet e natyrës:
 - Ekosistemi ligatinor Këneta e Kashtës,
 - Ahishta e Liqenit të Kuq,
 - Pisha e Gjinajve,
 - Pisha e Gjeganit,


Në veçanti zonat e mbrojtura të Kukës mbulojnë sipërfaqet e mëposhtme:

Nome Area Protetta	Categoria	Superficie (ha)
Lumi i Gashit	IUCN I: Rezerve rreptesisht natyrore/rezerve shkencore	3.000
Lugina e lumit të Valbones	IUCN II: Park kombetar	8.000
Tej Drini Bardhe	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	30
Nikaj Mertur	IUCN IV/1: Park natyror rajonal	17.505
Korab-Koritnik	IUCN IV/1: Park natyror rajonal	26.535 (përfshire pjesen takuese të bashkë Diber)

Nga pikëpamja mjedisore, pikat më kritike janë menaxhimi i dobët i pyjeve gjë që çon në një humbje progresive të resurseve pyjore, menaxhimi dhe zhvillimi i dobët i parqeve dhe rezervave në zonë, degradimi i mjedisit lidhur me praninë e minierave të shumta dhe gurorëve.

Shfrytëzimi i paplanifikuar i tokës ka çuar si në një fragmentim të hapësirës të lirë ashtu dhe në një përdorim të burimeve të përvetshme natyrore, duke shkaktuar një varfërim të përgjithshëm të cilësisë së mjedisit dhe biodiversitetit.

Menaxhimi i mjedisit dhe sistemit natyror duhet të orientohet jo vetëm për ruajtjen dhe mbrojtjen e zonës, por edhe për rritjen e saj në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe në shërbim të aktiviteteve njerëzore.



Ne perfundim te analizes mundet te rendesim pikat e forta, dobesite , mundesite dhe kercentimet e sektorit Natyror:

Anët e Forta

- Burimet natyrore dhe biodifersiteti
- Peisazhet panoramike
- Prezenca e parqeve natyrore, pyjeve, liqeneve dhe lumenjve te njohur
- Turizmi i lidhur me liqenin dhe rrjedhat ujore
- Lidhja me rrjetin rrugor kombetar (Dures-Kukes)

Dobësitë

- Zona te degraduara mjedisore
- Shfrytezim i ulet i burimeve ekzistuese
- Kapacitete pritese te limituara dhe shërbime me cilesi te ulet
- Bashkepunim i ulet mes autoriteteve publike dhe operatoreve turistik
- Mungesa e inovacionit dhe integritimit mes llojeve të ndryshme të turizmit
- Ndotja urbane



Mundësitë

- Mundesi zhvillimi i turizmit sportiv (sporte ujore – liqen, alpinizem, etj.)
- Pjesëmarrja në programet dhe iniciativat e bashkëpunimit ndërkufitar
- Turizmi rural i lidhur me malin
- Turizmi natyror: Shishtaveci si vend që karakterizohet nga prania e sporteve dimerore dhe i lokalizuar ne menyre te pershtatshme ne lidhje me flukset nderkufitare
- Zhvillimi i prodhimit te energjise hidroelektrike(energji e paster)

Kërcënimet

- Ndotja
- Mungesa e kontrollit mjedisor
- Erozioni dhe shpyllezimi

4.4 Sistemi Ujor (U)

Rrjedhjet ujore kryesore që formojnë rrjetin hidrografik të Kukësit janë: lumi Drin i Zi, lumi Drin i Bardhë ,lumi i Lumës dhe përroi i Tërshenës. Gjithashtu edhe liqeni i Fierzes që është një liqen artificial i krijuar në luginën e lumit Drin.

Tabela 1: Të dhenat hidrike të zonës së Kukësit

Lumenjte	Gjatesia (km)	Sip. E pellgut (km ²)	Norma e rrjedhjes(m ³ /s)	Vellimi i rrjedhjes ne %
Drin i Bardhe	134	4964	68.2	2.151
Drin i Zi	149	5885	118	3.721
Drin I bashkuar	685	14173	352	11.110

Qyteti i Kukësit është e pasur me burime ujore dhe ofron një shumëllojshmëri të biodiversitetit. Zona e Kukësit karakterizohet nga prania e liqenit të Fierzës që përfaqëson bashkimin e disa përrenjeve dhe lumenjve. Lumejte rrezikohen nga ndotja e ujit si rezultat i dekompozimit tembeturinave me origjine urbane bujqesore dhe industriale.

Sistemi i ujit që përfshin liqene dhe lumenj është përdorur kryesisht për energjisë elektrike, bujqësisë dhe furnizimin me ujë problemi kryesor i të cilit është i lidhur me ndotjen si pasojë e shkarkimit të ujit të patrajtuar. Monitorimi i analizave te kryera në vitet e fundit në Shqipëri, tregojnë një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e ujit të lumenjve dhe liqeneve. Në mënyrë të veçantë, përveç dëmit të shkaktuar nga shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtuara në afërsi të qendrave urbane, ujërat më të ndotura janë në afërsi të burimeve të ndotjes, si zonat industriale, ekzistuese, komplekseve të dikurshme industriale dhe vendeve të minierave dhe të përpunimit mineral.

Sistemi i ujrave përbëhet nga rrjeti hidrografik kryesor plotësohet nga prania e burimeve të shumta dhe ujërave nëntokësore.



Burimi: Strategjia kombëtare për menaxhimin e integruar të territorit

Për sasinë e burimeve ujore që ka, territori i Kukësit, ka një potencial të madh nga pikëpamja hidroenergetike si në aspektin e stacioneve të rëndësishme hidroelektrike dhe atyre të vogla.

Operimi privat i centraleve të vogla të energjisë ka filluar në vitin 1999 me hyrjen në fuqi të ligjit për privatizimin e asetëve shtetërore në sektorin e energjisë, që fillimisht menaxhoheshin tërësisht nga kompania KESH. Raporti komercial mes KESH-it dhe operatorëve privat u stabilizua në vitin 2002 dhe, deri më sot, janë nënshkruar disa marrëveshje të blerjes së energjisë.

Për territorin e Kukësit një aspekt veçanërisht i rëndësishëm është ai në lidhje me shitjen e energjisë hidroelektrike, një burim kryesor i të ardhurave të qeverisë që ka një ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin e të ardhurave publike.

Kuadri ligjor përfshin ndër të tjera: 1. Ligji për privatizimin e hidrocentraleve lokale e n. 8527/1999, ndryshuar me ligjin nr. 9479/2006; 2. Ligji për sektorin e energjisë n. 9072/2003; 3. Vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Energjinë Nr 424/2003; 4. Ligji për sigurimin e kushteve të favorshme për ndërtimin e instalimeve të reja për gjenerimin e



energjisë n. 8987/2002; 5. Vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e Modelit Tranzitor Tregut të Energjisë Elektrike n. 539/2004; 6. Ligji për efikasitetin e energjisë n. 9379/2005.

Për përdorimin e ujit për përdorim të përditshëm, problemet kryesore që ndodhin në përgjithësi në vend, janë konfirmuar edhe për Bashkinë e Kukësit, dhe i referohen:

- Mungesa e infrastrukturës adekuate;
- Vetëm 28 nga 56 kompanitë e ujit shqiptare janë në gjendje për të siguruar furnizimin me ujë dhe kanalizimeve;
- Mbulimi i shëndetit dhe higjienës në zonat urbane dhe rurale qëndron në vetëm 47.9%;
- Ka lidhje të shumta informale dhe të paligjshme nga 8 impiantet të ndertuara të trajtimit të ujërave të zeza, vetëm 5 janë në veprim

Ne përfundim të analizës mundet të rëndesim pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e sektorit Ujor:

Anët e Forta

- Prania e një rrjeti të dendur ujqor nëntokësor dhe sipërfaqësor
- Lumenj malor që ofrojnë energji hidroelektrike dhe janë burim ujitje për bujqësinë
- Bashkimi i rrjedhave të Drinit të zi dhe Drinit të bardhe

Dobësitë

- Ndotje e fortë nga derdhjet e patrajuara në pellgun e Fierzës
- Kontrolli sanitar: për tu përmirësuar dhe shtrirë në të gjithë sistemin
- Vështirësi dhe pengesa në lidhje me shërbimet e kanalizimeve të ujërave të zeza
- Paqartësi mbi pronësinë e rrjeteve të kanalizimeve të ujërave të zeza
- Verifikimi i ofrimit të shërbimeve në zonat informale urbane
- Mungesa e infrastrukturës adekuate
- Mbulimi i shëndetit dhe higjienës në zonat urbane dhe rurale qëndron në vetëm 47.9%

Mundësitë

- Riorganizim i përpunimit të ujërave
- Përfshirja e burimeve ujore të përbashkëta në shoqëri të ekzistuesë Kukës sh.a.
- Bashkëpunimi me agjentët fiskal apo subjekte të tjera
- Investime për të përmirësuar mbulimin me shërbime

Kërcënimet

- Shfrytëzimi hidroenergjetik i territorit pa impakt ekonomik në zone
- Rrezikun e përmbytjeve gjatë periudhave të reshjeve të rënda në dimër / pranverë
- Ka lidhje të shumta informale dhe të paligjshme



4.5 Sistemi Bujqesor (B)

Blektoria është një sektor prioritar dhe jetik për zhvillimin e zonës rurale dhe ekonomisë në zonën e Kukësit. Ajo nuk ndahet nga zhvillimi i bujqësisë dhe është pjesë integrale e zhvillimit të këtij sektori. Blektoria luan një rol të rëndësishëm dhe kryesisht mbarështrohet për qumësht dhe mish. Vitet e fundit ka një tendencë për mbarështrimin e bletarisë .

Lidhja e bujqësisë me blektorinë është e pandalshme, prandaj dhe sipërfaqja më e madhe e tokës mbillet me foragjere për ushqim për bagëtitë. Karakteristikë është që pjesa fushore merret më shumë mbarështrimin e gjedhit, ndërsa pjesa malore në zonën ku ka kullota alpine më shumë merren me mbarështrimin e deleve ndërsa pjesa e zonës së pyjeve të larta dhe të ulta më shumë me dhinë. Blegtoaria është e shtrirë në të gjithë zonën, me dominim më të madh të kafshëve të imta (dele, dhi). Por përqëndrimi më i madh i saj është në zonat e Shishtavecit dhe Bicajt, ku numri i krereve të imta, gjedhëve është më i madh, për të gjitha llojet e tyre, ndjekur nga Grykë Cajë e Bushtricë për numrin e të imtave dhe Topojan për njëhundurakët. Blegtoaria në Komunën e Shishtavecit është pjesë e rëndësishme e ekonomisë së zonës pasi siguron një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave që sigurohen nga mishi, ndërsa produktet e nënproduktet e tjera përdoren kryesisht për përdorim familjar dhe nuk tregtohen në treg.

Dhentë përdoren kryesisht për prodhim mishi, kryesisht për tregun lokal në Kukës, kurse qumështi dhe leshi për përdorim familjar, shumë pak tregtohet ose aspak. Raca më përhapur në zonë është tipi i deles "Rude".

Prodhimi blektoral nuk është në rendimente të larta kjo për shumë arsye, por më kryesorja është që tregu i produkteve blektorale është i vogël dhe racat e mbareshtuara nuk janë të shquara për prodhimtari të lartë. Prodhimi i qumështit është më i lartë, por rendimenti dhe përfitimi nuk është shumë i lartë. Përpunimi i prodhimeve blektorale, kryesisht i qumështit është në formën tradicionale dhe bëhet nga çdo familje , ku merren kosi, gjalpi, gjiza dhe djathi, kryesisht për nevojat familjare dhe pak për treg.

Prodhimit vendas është i kercenuar nga konkurrenca e mallin që vjen nga importi. Nje nga problemet e blegtorise eshte fitimii ulet.

Problemi më i madh që ekziston është se ky liqen ndotet shumë nga mbetjet urbane ku pjesa më e madhe vjen nga rrjedhjet e lumenjve të Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi, të cilat ndikojnë negativisht në cilësinë e ujit, faunës. ambjetit përreth, si dhe shfrytëzimin e terrenit për plazh dhe aktivitete ujore.

Ndërkohë, sic është shprehur edhe në Strategjinë Rajonale të Kukësit edhe në atë të Bashkisë Kukës, ky potencial natyror i pa shfrytëzuar, ka një kërkesë në rritje nga banorët për t'u vizituar dhe interes nga pushteti vendor për ta shndërruar në një destinacion turistik. Marrja e masave për të përmirësuar kushtet aktuale të liqenit e rritur peshkimin, nëpërmjet pastrimit i liqenit të Fierzës dhe zonës përreth tij, sistemimit të bregut të liqenit dhe përshtatjes së tij në një pike



Turistike , si dhe peshkezim artificial si të Liqenit te Fierzes dhe ujembledhesve te Qarkut Kukes ka qënë dhe mbetën si prioritete të për zhvillimin e këtij sektori në mënyrë të qëndrueshme dhe kthimin e tij në një potencial për zhvillimin e ekonomisë lokale dhe turizmit.

Ne perfundim te analizes mundet te rendesim pikat e forta, dobesite , mundesite dhe kercenimet e sektorit Bujqesor:

Anët e Forta

- Klima të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë;
- Kosto e lire e krahut te punes;
- Tregu potencial eshte i konsiderueshem pasi imazhi I produkteve bujqësore dhe blektorale eshte mjaft pozitiv;
- Tradita historike familjare në sektorin e bujqësisë dhe blektorisë dhe eksperiencia e përfituar në vite perben nje baze te rendesishme per sektorin;
- Akses per tregun nder rajonal dhe vendet vqinje

Dobësitë

- Mungesë e infrastrukturës së përshtatshme bujqësore, mungesa e teknologjive te reja bujqësore dhe teknikave të reja;
- Problemet me pronen dhe fragmentimi I saj;
- Mungese e kontrollit dhe e informimit ne perdorimin e pesticideve dhe helmeve;
- Mungesa e konsorceve rajonale dhe strukturave te tjera private apo qeveritare per te rritur aksesin ne treg nepermjet, markave, pikat e grumbullimit, dyqanet e shitjeve, promocionit që produktet bujqësore të kenë markën dhe linjën e tyre të tregu;
- Eficence e ulet e prodhimit per efekt te fragmentarizimit te lartë te tokës bujqësore në ngastra të vogla dhe mungesa e kulturës së bashkëpunimit mes fermerëve ne forme cooperative;
- Mungesa e pikave të grumbullimit të prodhimeve bujqësore veshtirson aksesin ne treg te prodhimit dhe gjeneron stoqe dhe humbje te prodhimit;
- Kostoja e lartë e prodhimit dhe rendimenti i ulët i prodhimit gjeneron norm ate vogla fitimi, Investime të vogla në bujqësi;
- Mungesa e aksesit per te përfituar nga programet dhe skemat qeveritare;
- Mungesa e shkollës profesionale me profil bujqësor, numri i ulët i specialistëve këshillues të bujqësisë për fermer, mungesa e aftësisë në përdorimin e inovacioneve teknike dhe teknologjike nga fermerët;
- Mungesa e promovimit të produkteve bujqësore dhe blektorale Kuksiane.

Mundësitë

- Kërkesa e tregut për produkte BIO dhe te cerifikuara;
- Bujqesia eshte sektor me prioritete per qeverine;
- Mundësi për zhvillimin e agrobizneseve nëpërmjet zhvillimit të agroturizmit;
- Skema e subvencionit nga ministria e Bujqësisë, dhe e donatorëve te huaj;
- Përdorimi i farave të zgjedhura që rrisin produktivitetin e prodhimeve bujqësore;
- Interes në rritje per eksportin e bimeve medicinale dhe aromatike



Kërcënimet

- Mungesa e aftësisë për të bashkëpunuar dhe kooperuar mes fermerëve;
- Mungesa e studimeve dhe orientimeve të fermerëve për të kaluar nga bujqësia tradicionale dhe primitive në bujqësinë intensive dhe të integruar;
- Fatkeqsitë natyrore, sëmundjet dhe viruset e kulturave dhe mungesa e programeve dhe mjeteve të pershtatshme për parandalimin e tyre;
- Mungesa e politikave afatgjate në mbështetjen e sektorit të Bujqësisë;
- Kostoja e lartë e shpenzimeve të transportit;
- Niveli i ulët i eksporteve si pasojë e përdorimit pa kriter të pesticideve;
- Siguria ushqimore; Konkurenca rajonale nga importet

4.6 Tema emergjente dhe ceshtje të ngritura

Ne mënyrë të veçantë, mund të behen vleresimet e para të përgjithshme, duke i kaluar me pas në përshkrime specifike për çdo sektor të përpunimit të bashkangjitur.

- a) Situata administrative në teresinë e saj është perceptuar dhe ka nisur. Ashtu si të gjitha reformat, edhe kjo është ende në fazë eksperimentale, sepse implikon gjithashtu dhe një ndryshim kulturor e strukturor. Transformimi nga 15-20 komuna në një Krye-Komune të përbashkët nënkupton implikon një teresi dorezimesh mes ish-komunave të ndryshme me një zbatim jo të lehtë.
- b) Behet fjale për kalimin nga qeverisja e një territori prej disa dhjetra km katrorë në një sipërfaqe prej mbi 900 km katrorë për të dy vendet së bashku.
- c) Reforma duhet të parashikojë me tutje hapa të tjera të rëndësishme, të tilla si përcaktimin e përgjegjësive në lidhje me sektoret dhe çështjet të rëndësishme.
- d) Për shembull, përcaktimi i pronësisë së tokës pyjore dhe shfrytëzimin e tij për qëllime agro-pylltare dhe të ekonomisë turistike.
- e) Ose përcaktimin e shfrytëzimit të burimeve hidroenergjetike, tanime prerogative e pushtetit qendror, pa ndonjë ndikim në zonën lokale, nga ku dhe është marrë. Shqetësimi vecanerisht i madh nga komuniteti i Kukësit që me centrali e saj prodhon energji për pjesën më të madhe të shtetit, dhe ku kompanive private u është lejuar mundësia e shfrytëzimit të burimeve me investimet e tyre, por që në fakt ky ndikim financiar nuk kthehet në vendin që i ka prodhuar.
- f) Haset akoma një ekonomi e dobët që ka parë shumë prej forcave rinore e sipërmarrëse të punës të emigrojnë drejt kryeqytetit apo qyteteve më të pasura bregdetare dhe me më tepër mundësi punësimi dhe investimi. Kjo dobesi është ndihet veçanerisht në Peshkopi.



- g) Haset akoma nje qendrese e forte ne sektorin bujqesor e cila ka zevendesuar vetem pjeserisht ate mbizoteruese (ose ekskluzive) me vlere publike. Kalimi nga ekonomia shterore-publike ne ate private ka pasuar mbylljen e qendrave te grumbullimit dhe perpunimit te prodhimeve bujqesore qe ishin qeverisur nga bota e bashkepunimit te shteteror. (Peshkopi)
- h) menyre analogjike ne fushen e resurseve minerale, me te cilat e gjithë zona (e Kukesit) eshte shume e pasur, me renien e sistemit komunist edhe keto pesuan nje braktisje qe nuk eshte kompesuar nga hyrja e investimeve te huaja apo te sipermarrejeve lokale.
- i) Nje perqindje e mire e popullsisë se mbetur fokusohet ne bizneset e vogla te cilat ne vetvete kontribuojne ne nje integrim te te ardhurave
- j) Sektori i ndertimit mbahet ende ne kembe, edhe pse haset ne kerkesa te uleta per strehim shkaktuar nga renia e numrit te popullsisë prej emigracionit. Kerkesa mbizoteruese eshte ajo e mundesise se realizimit te baneses private me vetendertim mbi token vetjake te njohur sit e tille pas renies se sistemit komunist. Ne numer te pakte hasen disa iniciativa ndertimi te tipologjise se pallatit. Ato pak te ndertuara kohet e fundit kane mbetur pjeserisht te pabanuara.
- k) Ndertimet Publike trasheguar nga regjimi paraardhes jane ne faza braktisjeje e kundrejt kushteve me te keqija. Ajo qe duhet bere eshte parashikimi i operacioneve ndaj pasurive te patundshme per rigjenerimin urban me prishje dhe rindertime.
- l) Gjendja e infrastruktures rrugore eshte e dobet. Mirembajtja eshte e manget per shkak te mungeses se burimeve si dhe per menaxhimin e atyre ekzistuese si nga autoritetet shteterore ashtu dhe nga kompetencat lokale. E vetmja arterie e rendesishme dhe ne gjendje mjaft te mire mirembajtjeje eshte autostrada me 4 korsi qe lidh Kryeqytetin Tiranen me Kukesin e me tutje me kufirin me Kosoven dhe kryeqytetin e saj. Per tu lidhur me Peshkopine rruga shteterore ende ka segmente te medha te lena pas dore dhe jo te mirembajtura. Nje trakt ne ndertim, dhene ne koncesion nje investitori te huaj (Kinez) nuk ka perfunduar akoma dhe ne kantier puna eshte ndaluar. Rruget me rendesi komunale si brenda qytetit ashtu dhe ato te lidhjeve nder qytete jane te keq-mbajtura. Hasen ne shkalle te madhe prania e segmenteve te rrugeve te paasfaltuara, me gropa apo me rreshqitje te dheut. Shenjat rrugore mungojne dhe / ose jane te paqarta.
- m) Edhe pse perballe ketyre çështjeve kritike, gjenden ende mundesi interesante qe mund te shfrytezohen dhe qe mund te perbejne gjithashtu perkufizimin e pare te nje projektimi programator ekonomik dhe urbansitiko-territorial.
- n) Kryesisht burimi ekologjik_ Keto terriore jane te pasura me burime dhe bukuri natyrore. Zonat pyjore zene rreth 60-70% te terriorit. Haset gjithashtu prania e nje sistemi ujqor te



rendesishem, lumenj dhe liqenet qe jane te pranishme per te dy vendet, Kukusin dhe Dibren. Ne keto zona mund te perqendrohen projekte specifike per sektorin e turizmit.

- o) Sektorit ambjental I eshte lidhur sektori I bukurive arkitektonike dhe ai i pranise si te te mirave monumentale te njohura, ashtu dhe te nje arkitekture deshmuese historike qe shpreh nje identitet dhe nje komunitet lokal.
- p) Sektori bujqesor mund te zhvillohet me promovimin e produkteve lokale (geshtenja, molle, patate etj.) qe shfaqin persosshmeri.
- q) Sektori i minierave duhet te rishqyrtohet teresisht ne perpjekje per te terhequr investimet e huaja.
- r) Sektori i sherbimeve me perdorim publik, mund te jete nga ana e vet nje force levizese ne punesimin e te rinjve per t'i mbajtur ne vend. Riorganizimi administrativ eshte gjithashtu nje mundesi per te favorizuar nje profesion universitar adekuat per ndryshimin e klases se punetoreve te vjeter ne prag te daljes ne pension dhe qe lidhen me strukturen e meparshme organizative.



5 VIZIONI DHE STRATEGJIA TERRITORIALE

Pershkrimi i strategjise territoriale eshte i ndare ne dy seksione:

- Strategjia territoriale e vendndodhjeve që integron ne menyre transversale disa elemente kyçe që dalin nga leximi i territorit në 5 sistemeve territoriale (UB, NË, N, U, B);
- Objektivat dhe veprimet te ndara sipas pesë sistemeve te përmendura, me qartesine që nuk behet fjale per sektorë te izoluar dhe te pavarur, por të ndërlidhura ngushtë me njeri tjetrin në të cilin zhvillimi i çdo sistemi individual drejton dhe është drejtuar nga të tjerët.

Këto elemente të vijnë së bashku në formulimin e një vizioni rajonal që, duke filluar nga analiza e mësipërme SWOT, shpreh objektivin kryesor drejt të cilit orjentoohen ndryshimet e viteve të ardhshme. Strategjia territoriale bazohet edhe ne kerkesat zhvillimore derivuese nga Plani Kombetar, pershkruar ne paragrafin e meposhtem.

5.1 Parashikimet e detyrueshme te planit kombetar te integruara ne strategji territoriale

Strategjia territoriale e Kukësit, përfshin brenda saj parashikimet zhvillimore të përcaktuara apo të sugjeruara nga Plani Kombëtar.

Në terma të përgjithshme, territori i Kukësit, së bashku me rajonet e Shkodrës dhe Lezhës, perfaqesojne porten veriore te Shqiperise. Projekti Porta e Veriut është fokusuar në aksin Transport / Turizëm / Ekonomi dhe sipas kesaj, Kukësi ka fokusin në artikulimin e rrjetit shperndares të gazsjellësit drejt Malit të Zi dhe Kosovës (Serbi).

Pozicioni i tij ndërkufitar me Kosovën, paraqet një mundësi shumë të rëndësishme në aspektin ekonomik. Rajonet ndërkufitare në fakt, në sajë të politikës së kohezionit të Bashkimit Evropian, janë të prekur nga fondet e IPA Ndërkufitare, qe për 2014-2020 do ti japë Shqipërisë 75 milionë € te ndara në:

- rreth 42 milione euro per projektet Shqiperi-Greqi
- rreth 12 milione euro per projektet Shqiperi-Mal I Zi
- rreth 12 milione euro per projektet Shqiperi-Maqedoni
- rreth 8,5 milione euro per projektet Shqiperi-Kosove.

Këto fonde jane te lidhur me projekte në fushen e ekonomise, infrastruktures, trashegimise natyrore, historike e kulturore, shëndetësisë, arsimit dhe kulturës. Rajonet e Kukësit dhe Prizrenit kanë pasur lidhje të forta historike dhe tregtare që mund te vazhdojne të forcohen në sajë të këtyre financimeve, duke rritur potencialin për zhvillimin e turizmit, kultures dhe shkembimin komercial të produkteve plotësuese bujqësore.



Nga pikëpamja e infrastrukturës, ekzistojnë faktorë të rëndësishëm të zhvillimit për zonën e Kukësit:

1. Çështja e energjisë: Shqipëria është një territor tranzit për koridore të ndryshme ndërkombëtare. Rajoni i Kukësit ndikohet nga kalimi i linjës së projektit TAP - Gazsjellësi Trans Adriatik që shkon paralel me autostradën Durrës-Morinë në drejtim të Kosovës;
2. Çështja e transportit me parashikimin e linjës hekurudhore që do të lidhë Tiranë-Durrës me Kosovën duke kaluar përmes Kukësit. Edhe në këtë rast, rruga e projektit është paralele me autostradën ekzistuese. Ky parashikim paraqet një potencial të madh si për forcimin e lidhjeve të brendshme të vendit ashtu dhe për marrëdhëniet tregtare, logjistike, turistike.
3. Prania e aeroportit: hapja e tij mund ta shnderroje atë në aeroportin e dytë për sa i përket rëndësisë për Shqipërinë. Potencialisht do të shërbejë si pikë lidhje midis Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë. Avantazhi strategjik i këtij aeroporti është pozicioni si vend-kyc mes të tre vendeve fqinje, me të cilat në të ardhmen e afërt do të lehtësojë komunikimin social dhe ekonomik. Kjo është një mundësi për të gjithë rajonin e, mbi të gjitha, për zhvillimin e turizmit vendas.
4. Nevoja për të forcuar rrugën lidhëse midis Kukësit dhe Peshkopisë

Nga pikëpamja ambientale, strategjia territoriale reflekton dhe përfshin në brendësi të strategjisë së vendndodhjeve, vlerësimin e potencialit të turizmit në zonën e Shistavecit dhe praninë e Korridoreve Blu dhe Jeshile. Në veçanti, është identifikuar kalimi i Bregut të Gjellbër Evropian, një lidhje e rëndësishme ekologjike, një nga akset e rrjetit ekologjik Pan-Evropian, ndërtimi i të cilit është bazuar në praninë e zonave të mëdha natyrore që u zhvilluan në mungesë të aktiviteteve antropogjene.

Gjithashtu e rëndësishme është dhe çështja e ndërlidhjeve dhe marrëdhënieve mes qendrave të mëdha, të specializuara dhe lokale: Kukësi është futur në një model radial të marrëdhënieve kryesore me qendrat shqiptare të Dibrës, Mirditës, Hasit dhe Tropojës, përveç se me qendrën kosovare të Prizrenit, i cili ben me pas lidhjen me Prishtinës, dhe jep një rrjet marrëdhëniesh sekondare me ish-njësite administrative të brendshme në rajon.

5.1.1 Aeroporti i Kukësit

Ndër mundësitë potenciale ekonomike që ofrohen nga zona e Kukësit rezultojnë shumë e rëndësishme prania e një pistë aeroporti. Aeroporti ndërtuar kohët e fundit, pas luftërave ballkanike nga shpërbërja e shtetit të Jugosllavisë, në sajë të një ndihme nga shtetet arabe, paraqet një mundësi reale për të zhvilluar edhe atë sinergji ekonomike të përfshirë në Planin Kombëtar të qeverisë shqiptare si një " motor zhvillimi."





PANGEA

Në shqyrtimin e kësaj infrastrukture është e rëndësishme të analizohen mundësitë dhe sfidat për një analizë priare të SWOT-it.

Mundesite

1. Aeroporti është e vendosur në një vend ideal: në afërsi të qytetit të Kukësit, por në të njëjtën kohë edhe mjaft larg nga destinacionet e banimit.
 2. Aeroporti është e vendosur përgjatë rruges prioritare lidhëse mes të qyteteve kryesore të Shqipërisë (Tiranë dhe Durrës) dhe kryeqytetit të shtetit fqinj, Kosovës. Të dy kryeqytetet janë të arritshme nëpërmjet rrugëve të gjera e me shumë korsitrafiku në një kohë maksimale prej 2.0 deri në 2.30 orësh për llojin e trafikut të rëndë (TIR dhe kamionë), dhe në më pak kohë akoma për rastin e trafikut jo-të rëndë (makina dhe autokorriera). Në këtë kontekst ofrohen përfitime si për trafikun e mallrave ashtu dhe për atë të pasagjerëve.
 3. Prania e një aeroporti përfshin rritjen e trafikut të pasagjerëve drejt qytetit të Kukësit dhe të zonës përreth. Kjo përfshin kryesisht një rritje në sektorin e turizmit, një rritje të numrit të turistëve, një rritje të pranisë së hoteleve, një rritje të numrit të vendeve të fjetjes/krevat dhe aktiviteteve të akomodimit. Midis tyre edhe një rritje të aktiviteteve në zonën rurale apo në ish qytetet, sidomos atyre që lidhen direkt me territoret e parqeve dhe sportive në natyrë (Hiking, ciklo-turizmit, shetitjeve në këmbë, etj) dhe me turizmin kulturor (qytetet historike, etj). Turizmi i këtij aspekti, ofron gjithashtu një mbështetje financiare për familjet rurale.
 4. Prania e aeroportit përfshin dhe rritjen e zhvendosjes së mallrave në mënyrë të vecante produkteve me cilësi të lartë bujqësore dhe që njihen si të tilla. Brenda ditës, këto mund të transportohen në tregjet evropiane ndërkombëtare dhe të vendosen në shitje direkte.
 5. Prania e aeroportit përfshin gjithashtu një rritje në mundësitë e punësimit që lidhen me si me funksionet e vetë aeroportit, si me industrinë, të tipit agjenci turistike, zyra në shërbim të aktivitetit të transportit të mallrave, hoteleri, taksi, etj.
- Zakonisht në afërsi të aeroportit, vendosen aktivitete të lidhura ngushtë me të, të tilla si logjistika, drejtimi (orientimi), etj.
6. Ekziston edhe një komponent i mëtejshëm që mund të merret parasysh dhe që mund të bashkëpunojë për të shtuar burimet ekonomike. Behet fjale për komponentin "ushtarak". Aeroporti mund të jetë me interes për strategjinë ushtarake si kombëtare ashtu dhe ndërkombëtare për afërsinë në territorin Ballkanik, e për një komb që filloi anëtarësimin si në Aleancën Atlantike ashtu edhe në Bashkimin Evropian. Një arsye me tepër, që, disponimet financiare (burimet) duhet të trajtohen në një nivel më të lartë se ai i planifikimit urban.



Kercenimet

S'ka dyshim se hapja e një aeroporti, si çdo infrastrukturë tjetër e madhe, sjell edhe aspekte negative që duhet të studiohen dhe kontrollohen për të minimizuar ndikimet.

1) Impakti ambjental. Nuk duket sikur ka ndikime të veçanta në mjedisin rrethues. Vendndodhja e tij është në fakt në një distancë të konsiderueshme nga afërsia e strehimit dhe nga qyteti. Kjo do të thotë se aeroporti përfshin edhe krijimin e një fashe (kufiri) të mosndertimit, ose të ndertimit ku duhen kontrolluar lartësitë. Ndikimi më i madh mund të haset nga zhurma e cila ndodh gjatë uljes dhe ngritjes së avionëve. Kjo duhet të vlerësohet nga një studim i veçantë edhe pse numri i fluturimeve të planifikuara pas hapjes nuk do të jetë i konsiderueshem për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë (10-20 vjet).

2) Kostot e menaxhimit. Vështirësia më e madhe është natyrisht në kostot e aktivizimit dhe menaxhimit të aeroportit. Ballafaqimi mes Hyrje / Daljeve pozicionohet në dy parametra themelore: zëri që i perket stafit (kulla e kontrollit dhe pritesën në tokë) dhe zëri që i perket numrit të udhëtarëve e mallrave që mbërrijne dhe nisen. Edhe në këtë rast është e nevojshme të përdoruret një Studim Fizibiliteti ad hok në mënyrë që të vlerësojë më saktë numrat dhe mundësitë. Në fazën e parë të menaxhimit, aeroporti do duhet të mbështetet financiarisht nga burime publike, si shtetërore dhe lokale. Por gjatë menaxhimit të tij do duhet të hyjnë edhe burime private ekonomike që lidhen me të interesuarit me të medhenj private, e të cilët nga fluksi i pasagjerëve dhe mallrave do të kenë përfitimin më të madh ekonomik. Nuk mund të parashikohen lëvizje të njerëzve apo të mallrave në sasi të mëdha për 10-15 vitet e para.

Në konkluzion, hapja aeroporti sjell më shumë mundësi sesa kërcënime. Aeroporti mund të konsiderohet në të gjitha efektet një "infrastrukturë e motorit të zhvillimit", si në nivel lokal dhe kombëtar, si për shembull për rritjen e mundësive të punësimit, sidomos për moshat rinore me përvojë kompjuterike dhe njohuri të mira të gjuhëve të huaja, për rritjen e sektorit të turizmit, për sinergji me sektorët e ekonomisë në perspektivën eksport-importit, për sinergji me vendet fqinje të Kosovës dhe Maqedonisë, për sinergji ushtarake në nivel ndërkombëtar.

5.2 Vizioni i të ardhmes për Kukësin

Në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Plani Kombëtar, strategjia është e bazuar në një vizion të Kukësit si Porta e verilindjes të vendit, në qendër të marrëdhënieve ndër-kufitare, duke pasur parasysh afërsinë e saj me Kosovën dhe aksin e përcaktuar në mes të Kukësit dhe Prizrenit, dhe me tej me Prishtinën. Potenciali i Kukësit si një qendër multimodale për statusin rajonal, kombëtar dhe në nivel ndërkombëtar është përcaktuar edhe me praninë e aeroportit dhe autostradës Durrës-Tiranë-Kosovë.

Vizioni në të cilin bazohet strategjia territoriale e Kukësit në vecanti është :



Te promovojë një zhvillimin të integruar territorial, që mbështet zhvillimin ekonomik të bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të potencialeve territoriale të tilla si burimet hidro-energjisë, trashëgimisë kulturore dhe natyrore, depozitat minerare, pozicionin ndërkufitar strategjik për të përmirësuar cilësinë e jetës me qasje në rritjen dhe më të mirë të shërbimeve si për qytetarët ashtu dhe për vizitorët.

Nisur nga ky vizion dhe përmes ripërpunimit të Analizës SWOT, u përcaktuan 4 objektiva strategjike që veprojnë në mënyrë të integruar me strategjinë e vendndodhjeve.

Objektivi Strategjik 1 - Një cilësi më e mirë banimi në territorin e Kukësit

Kjo linjë e ndërhyrjes referohet në mënyrë të veçantë në Sistemin Urban dhe Strategjinë e Vendbanimeve dhe ka si fokus zhvillimin policentrik të bazuar në forcimin e hierarkisë së sistemeve urbane. Në veçanti tenton që të përmirësojë cilësinë urbane në aspektin fizik, me ndërhyrje kualifikimi dhe përmirësimi të tesutit urban, si dhe përmirësimi të cilësisë dhe sasisë së shërbimeve bazë dhe në këtë mënyrë rritjen e numrit të vendbanimeve që aksesojnë në shërbimet themelore të tilla si transporti, ujësjellësi, kanalizimet. Kjo linjë veprimi gjithashtu ndikon në temën e banesave informale dhe sociale.

Objektivi Strategjik 2 - Aksesimi më i mirë në zonën e brendshme të Kukësit dhe vlerësimi i lidhjeve ndër-rajonale dhe ndërkufitare

Çështja e aksesibilitetit është në fakt e lidhur me infrastrukturizimin e zonës dhe konsiston në: lëvizshmërinë e ngadalte duke krijuar rrugët dhe itineraret që ndikojnë në shfrytëzimin e potencialeve turistike (shih sistemin natyror); transportit publik me racionalizimin dhe përmirësimin e shërbimit të mobilitetit publik lokal dhe lidhjen midis Kukësit dhe pjesës tjetër të nivelit rajonal dhe kombëtar; qasja fizike që matet nga infrastrukturat e mëdha (aeroport, autostradë), rrjetit rrugor sekondar që ka nevojë për masa të rëndësishme për tu përshtatur dhe përmirësuar

Objektivi Strategjik 3 - Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve mjedisore si në aspektin e turizmit ashtu dhe të energjisë dhe minierave

Kjo linjë e ndërhyrjes i referohet kryesisht sistemit natyror dhe sistemit të ujërave. Tema qendrore është të optimizojë në mënyrë të qëndrueshme potencialin ekonomik të burimeve në zonë: nga njëra anë për të rritur turizmin përmes një oferte të organizuar në bazë të trashëgimisë mjedisore, peizazhit dhe kulturës në territor, në anën tjetër për të shfrytëzuar burimet ujore në aspektin e prodhimit të energjisë si dhe burimeve minerare të përhapura.


Objektivi Strategjik 4 - Vlerësimi i zinxhirit të prodhimit lokal

Vlerësimi i zinxhirit të prodhimit lokal i cili, duke u bazuar në sistemin e bujqësisë dhe atë artizanal lokal, ngre nevojën për të kombinuar njohuritë tradicionale me egzigjencat e inovacionit të



modeleve të prodhimit dhe infrastrukturave të lidhura me to në mënyrë që të jenë në treg në kushte konkurruese. Në zonen e Kukësit ka burime territoriale, por edhe profesionale, që duhen ri-zbuluar në mënyrë që të rrisin traditat dhe njohuritë lokale. Nga ana tjetër janë të nevojshëm edhe proceset inovative, të cilat nuk janë të lidhura domosdoshmërisht me produktet, por me mënyrën në të cilën këto produkte prodhohen dhe tregtohen. Nevoja është nga njera ane për të koordinuar dhe të integruar kompanitë / forcuar shërbimet e kompanive dhe nga ana tjetër për të bërë produktet të njohur dhe kualifikuar. Inovacioni dhe promovimi i sistemit të prodhimit, mund të luajë një rol edhe aktivizimin e marrëdhënieve me qendrat e mësimin / hulumtimeve / universiteteve edhe jashtë territorit.

Duke u nisur nga vizioni dhe nga objektivat strategjike është percaktuar strategjia e vendndodhjeve që përveç se tregon strukturën territoriale, jep dhe udhëzime operative për hapin e ardhshëm të përgatitjes së Planit Vendor Urban. Vizioni i përgjithshëm prezantohet në diagramin e mëposhtëm





5.2.1 Objektivi Strategjik 1 - Një cilësi e mirë e jetesës në territorin e Kukësit

Cilësia urbane dhe rajonale i referohet kryesisht cilësisë së jetës së atyre që banojnë në territorin e Kukësit, do të thotë i kushton vëmendje pjesëve të ndryshme të territorit dhe marrëdhënieve në mes të sistemeve të ndryshme që e përbëjnë atë: të maleve dhe luginave, zonave urbane dhe fshatrave, poleve qendrore dhe zonave më marginale.

Qendrat kryesore dhe fshatrat me te vegjel nga të cilat karakterizohet territori duhet të bëhen vende të socializimit dhe të ofrimit të shërbimeve bazë. Duehen vlerësuar rrugët dhe vendet publike si vende takimi dhe konfrontimit.

Dimensionet e cilësisë së jetës janë të lidhura ngushtë me komponentët e tjerë si ato ekonomike, infrastrukturore, sociale, mjedisore. Cilësia urbane dhe mjedisore nuk lidhet vetëm me aspektet materiale / fizike të qytetit dhe të territorit, por përfshin të gjithë sferën jomateriale të lidhur me mirëqenien lokale. Ajo përshtatet në këtë aspekt me masën e ndryshimeve demografike të lidhura veçanërisht me probleme të mëdha sociale, me shpopullimin e territorit dhe shërbimeve të shperndara me karakter inkluziv dhe social. Në të njëjtën kohë merr rol qendror dhe ofrimi i shërbimeve dhe hapësirave për të rinjtë, me qëllim jo vetëm të ofrojë mundësi për brezin e ri, por edhe për të jetuar dhe shijuar territorin në mënyrë të përgjegjshme, të vetëdijshme dhe të motivuar.


Ne sinteze mund të themi që tema i perket:

- Hapësira urbane, në kuptimin e evolucionit urban, të gjendjes së ndërtesave, pajisjeve dhe sistemit të parkimit, arredimit urban dhe gjelbërimit publik;
- shërbime individuale (kopshtet e fëmijëve, kujdesin për njerëzit, rrjetet e kujdesit) dhe për kohën e lirë.

Indikatorët kyç janë pra :

- forcimi i rolit të Kukësit si qendër kryesore e funksioneve rangut rajonal;
- fuqizimi i lokaliteteve kryesore për të përmbushur kërkesën për shërbime afersie
- kualifikimi i shërbimeve baze në lokalitetet më të vogla /fshatra

Diagrama e mëposhtme tregon strategjinë për sistemin urban që rrjedh nga analiza SWOT dhe përpunimi i elementeve të përshkruara më sipër:






Figura 2: Sistemi Urban

	Zhvillimi i shërbimeve në zonën urbane të Kukësit		Aeroporti i pashfrytëzuar për tu vlerësuar
	Izokron- brenda 15 minutave nga Kukësi		Qendrat urbane kryesore për tu vlerësuar
	Izokron- rreth 15 - 30 minuta nga Kukësi		Qendrat e vogla
	Izokron- rreth 30 - 45 minuta nga Kukësi		Qendrat dytesore
	Izokron- rreth 45- 60 minuta nga Kukësi		Vlerësimi i qendres nga pikëpamja turistike
	Zonat me përqendrim më të madh të ndërtimeve		Shtimin e shërbimeve për popullsinë (shkollë, ambulancë, spitale, kopështe, cerdhe)
	Zona e zhvillimit turistik		Korridori lumor
	Lidhjet kryesore infrastrukturore		
	Itineraret panoramik dhe turistik për tu zhvilluar		
	Linjat hekurudhore Tiranë – Kosovë në projekt		
	Lidhjet rrugore për tu përmirësuar - çështje prioritare		
	Lidhjet rrugore për tu përmirësuar në një fazë të dytë		
	Rrugët për tu asfaltuar		
	Kufijta – Vlerësimi i lidhjeve ndërkufitare		

Per cdo program strategjik janë identifikuar veprime e projekte te qëndrueshme dhe funksionale ne arritjen e objektivi strategjik, të cilat do të përshkruhen në shtojcën e bashkëngjitur *Bashkëngjitur.01 - Skedat e Projekteve Strategjike*

PROGRAMI STRATEGJIK	VEPRIMI	PROJEKTI
1.A Rritja e cilësisë urbane të Bashkisë Kukës	1.A.1 Shtimi i numrit dhe i cilësisë së shërbimeve	1.A.1.1 Përmirësimi i rrjetit nentokesor
		1.A.1.2 Zhvillimi i infrastruktures sanitare baze
	1.A.2 Kualifikimi i zonave qendrore	1.A.2.1 Rikualifikimi i bulevardit
		1.A.2.2 Rikualifikimi i lidhjes hotel-qender
		1.A.2.3 Rikualifikimi i zones së molit
		1.A.2.4 Rikualifikimi i qendres së Shishtavecit
	1.A.3 Përcaktimi i hierarkisë së qendrave të banuara	1.A.3.1 Përcaktimi i shërbimeve minimale baze sipas hierarkisë së qendrave të banuara.



		1.A.3.2 Zhvillimi policentrik dhe percaktimi I zonave urbane paresore
1.B Vleresimi I zonave bosh/te paperdoruar	1.B.1 .Rigjenerimi I zonave te boshatisura/ te braktisuara dhe nga kendveshtrimi I trashegimise kulturore.	1.B.1.1 Rikualifikimi I zones industriale te zbrazur (rikualifikim urban)
		1.B.1.2 Rikualifikimi I hotelit te zbrazur KUKES
		1.B.1.3 Vleresimi I objekteve nentokesore te mbrojtjes.
	1.B.2 Permiresimi I lidhjeve ndermjet zones industriale dhe qendres.	1.B.2.1 Lidhja e zones se rivleresuar (ish zona industriale e zbrazur) me zonen e qendres dhe rrugen panoramike.
1.C Minimizimi I abuzivizmit dhe I lagjeve informale	1.C.1 Rritja dhe permiresimi I cilesise se sherbimeve (si 1.1.1)	1.C.1.1. Hedhja ne harte e sherbimeve egzistuese(formale dhe informale).
	1.C.2 Plani per ndertimet sociale	1.C.2.1 Ndertimet sociale
	1.C.3 Sistemimi i lagjeve informale.	1.C.3.1 Sistemimi i lagjeve informale.

5.2.2 Objektivi Strategik 2 - Nje akses me i mire ne brendesi te territorit te Kukedit dhe vleresimi i lidhjeve nder-rajonale dhe nderkufitare

Tema e aksesibilitetit vjen në një kuptim të gjerë, duke përfshirë si çështjet që lidhen me sistemin e lëvizshmërisë ashtu dhe zhvillimi i rrjeteve të infrastrukturës e tet nenshërbimeve. Çështja e lëvizshmërisë i referohet si asaj ne zonën e brendshme, në mes të qendrave kryesore dhe fshatrave më të vogla, por edhe asaj të jashtme ne nje zonë me të gjerë. Temat janë ato të raporteve ndërmjet mënyrave të transportit, sigurisë rrugore dhe implementimin e shërbimeve lokale të transportit publik. Vendosja ndërkufitar i Kukedit është një element force i territorit i aftë te involvoje potencialisht, në sektorët e ndryshme lokale (bujqësore, komerciale, industriale, etj turizmi), përdorues te jashtëm..


Gjithashtu lehtësia e aksesit në sajë të pranisë së autostradës, krijon shume mundesi. Në anën tjetër duhet të sigurohet qe lidhja e brendshme, me zonat më të marginalizuara dhe aktualisht cilesi me te ulet sherbimi. Problem është cilesia e rrugëve të brendshme, te paaksesueshme në periudha të caktuara të vitit. Duhet të mendojmë për mënyrat e reja të të shërbimit transportit që te jene sa me eficente dhe ekonomikisht.

Ne kuadrin e prodhimit dhe përdorimit te energjisë, skenarët e planit kërkojnë theksimin e përdorimit te burimeve hidro energjike

Indikatorët kyc jane pra :

- Permiresimi i lidhjeve te brendeshme ne vecanti per lokalitetet kryesore e sekondare;
- Aktivizimi i aeroportit dhe permiresimi i transportit publik;
- Unifikimi i korridoreve te transportit me ato energjitike per nje tutele me te mire te territorit

Diagrama e mëposhtme tregon strategjinë për sistemin infrastrukturor që rrjedh nga analiza SWOT dhe përpunimi i elementeve të përshkruara më sipër:






Figura 3: Sistemi Infrastrukturor



Hub Nderkombetar



Qender e banuar deri ne 2.000 banore



Qender e banuar nga 2.000 – 5.000 banore



Qender e banuar me mbi 5.000 banore



Lidhje e mundshme aeroportuale



Kufiri



Lidhjet nderkombetare per tu forcuar - Hub Kukës



Linjat kryesore nder rajonale



Itinerari per zhvillimin turistik



Linjat hekurudhore ne projekt (Plani Kombetar)



Lidhjet nderkombetare per tu forcuar



Lidhjet nder rajonale per tu forcuar



Lidhjet e brendshme per tu forcuar



Zona e zhvillimit ekonomik (turizmi)



Zona e zhvillimit ekonomik (prodhimi)



Miniera



Fabrike - Pasuri te kromit



Depozitat minerare



TPS



Linjat energjitike ekzistuese



Linjat energjitike ne projekt



Hidrocentral kryesor



Hidrocentral i vogel



Nenstacion



Depozitim inertesh



Brez lumor





Per cdo program strategjik janë identifikuar veprime e projekte te qëndrueshme dhe funksionale ne arritjen e objektivit strategjik, të cilat do të përshkruhen në shtojcën e bashkangjitur *Bashkengjitur.01 - Skedat e Projekteve Strategjike*

PROGRAMI STRATEGJK	VEPRIMI	PROJEKTI
2.A Rritja e cilesise dhe eficenses se sherbimeve	2.A.1 Menaxhimi I mbetjeve	2.A.1.1 Menaxhimi I mbetjeve
	2.A.2 Permiresimi I rrjetit te ujesjellesit	2.A.2.1 Permiresimi I rrjetit te ujesjellesit
	2.A.3 Permiresimi I rrjetit te kanalizimeve	2.A.3.1 Permiresimi I rrjetit te kanalizimeve
	2.A.4 Permiresimi I menaxhimit te burimeve te disponueshme	2.A.4.1 Permiresimi i teknologjise në nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve 2.A.4.2 Projektimi I parqeve energjistik(energjia e diellit dhe e eres)
2.B Permiresimi i aksesibilitetit	2.B.1 Permiresimi I organizimit te transportit publik	2.B.1.1 Permiresimi I organizimit te transportit publik
	2.B.2 Permiresimi I rrjetit rrugor ekzistues	2.B.2.1 Vleresimi I gjendjes se rrjetit rrugor
		2.B.2.2 Mirembajtja dhe permiresimi I rrugeve te pakalueshme
		2.B.2.3 Reduktimi I numrit te rrugeve te paasfaltuara
		2.B.2.4 Zgjerimi dhe mirembajtja e rrugeve urbane dhe e ndricimit te tyre
2.B.3 Krijimi I rrugeve te bicikletave	2.B.3.1 Zhvillimi i projekteve të infrastrukturës ndërkufitare mbi temen e levizjes së qëndrueshme	
2.B.4 Vleresimi I lidhjeve nderkombetare	2.B.4.1 Zhvillimi I projekteve per transportin nderkufitare dhe per infrastrukturen	
2.C Zhvillimi i sitemit ekonomik	2.C.1 Krijimi I paketave turistike rajonale	2.C.1.1 Mundesi itinerarësh rajonal per eksplorimin e vlerave historike dhe natyrore
	2.C.2 Pakete turistike rajonale	2.C.2.1 Krijimin e paketave turistike qe perfshijne Kukesin, Prizrenin, Tropojen e Gjakoven
	2.C.3 Ritja e mundesise se shkollimit	2.C.3.1 Shkollimi profesional(turizem, gastronomi, agrikulture) 2.C.3.2 Permiresimin e infrastruktures se sitemit parashkollor dhe shkollor



5.2.3 Objektivi Strategik 3 - Vleresimi i qendrueshem i burimeve ambjentale si ne terma turistike dhe energjitike e minerare

Pasuria e burimeve natyrore të territorit duhet të jetë në radhë të parë e mbrojtur dhe administruar në mënyrë që të ruhet ose rivendoset cilësia e tij. Kjo në mënyrë të veçantë lidhet me ndotjen nga hedhja e mbeturinave dhe ujërave të zeza të patrajtuara në rrjedhat e ujit dhe në basenin e Fierzës, me varferimin e pyjeve që rezulton nga menaxhimi i dobët, me praninë e aktiviteteve minerare që edhe pse përfaqësojnë një potencial ekonomik, ato janë gjithashtu objekte të degradimit të mjedisit për tu menaxhuar.

Sigurimi i cilësisë dhe ruajtja e burimeve natyrore është kusht i nevojshem për vleresimin e tyre. Aksioni i sistemit është strukturimi i një oferte të koordinuar turistike në nivel rajoni, duke siguruar një shërbim me cilësi të lartë, të plotë dhe konkurrues. Përdorimi i pakët i burimeve lokale është e lidhur me një veprim të dobët promovues nga ana e enteve lokale dhe mungesa e një strategjie globale të marketingut, me vështirësi për të bërë të njohur jashtë, atë që territori është në gjendje të ofrojë.

Turizmi mund të jetë një pasuri e vërtetë për Kukësin, megjithatë, duhen mjete, përfshirë dhe ato operative, për të ofruar shërbime për turistët dhe përdoruesit që lejojnë një transferim me të vërtetë aktiv të elementeve identitare, të përkatësisë dhe të pritjes.

Paralelisht territori i Kukësit ka një kapital hidrik i cili mund të shfrytëzohet për projekte hidroenergjitike, me një rikthim afatshkurtër në ekonomine lokale. Ky është një element kyç rreth të cilit lëvizin interesat e investorëve potencial të cilët mund të jenë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe për të përmirësuar shërbimet dhe infrastrukturën. Në një kontekst dhe në një kohë kur burimet publike janë të kufizuara është thelbësore mundësia e formave të partneritetit publik-privat, që synon zbatimin e masave të cilat nga njëra anë janë në gjendje të kthehen në përfitim për komunitetin dhe në anën tjetër të sigurojnë investorët për qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të operacionit. Marrëveshjet publike-private, në formë të ndryshme praktike, janë një nxitje e nevojshme për investimet ekzistuese.


Mbrojtja, promovimi, njohja, duket të jenë elementet në qendër të strategjive të nevojshme për të shfrytëzuar këtë trashëgimi të madhe, e aftë për gjenerimin e lëvizjeve të reja turistike dhe ekonomike.


Treguesit kryesore janë si më poshtë:

- Cilësia e mjedisit nepermjet reduktimit të ndotësve, rritja e sigurisë së brendshme dhe menaxhimi më i mirë i mbeturinave (në veçanti uljen e ndotjes në Drin);
- Zhvillimi i turizmit malor dhe ekoturizmit;
- Përfitimi ekonomik në shkallë lokale nga investimet në sektorin e energjisë dhe minierave.

Diagrami i mëposhtëm tregon strategjinë për sistemin natyror dhe hidrik që rrjedh nga analiza SWOT dhe përpunimi i elementeve të përshkruar më sipër:







Trashëgimia kulturore



Monument natyror



Zona e mbrojtur



Rrjeti emerald



Koridori lumor

Figura 4: Sistemi Natyror






Figura 5: Sistemi Ujor



Per cdo program strategjik janë identifikuar veprime e projekte te qëndrueshme dhe funksionale ne arritjen e objektivi strategjik, të cilat do të përshkruhen në shtojcën e bashkangjitur *Bashkengjitur.01 - Skedat e Projekteve Strategjike*

PROGRAMI STRATEGJIK	VEPRIMI	PROJEKTI
3.A Menaxhim dhe mbrojtje me e mire e sistemit ambiental	3.A.1 Rritja e kontrollit dhe e mbrojtjes së mjedisit	3.A.1.1 Parandalimi i ndotjes se ajrit dhe ujit si pasojë e shfrytëzimit të mineraleve
		3.A.1.2 Krijimi dhe permiresimi i Korridoreve ekologjike përgjatë luginave dhe përgjatë zonave të mbrojtura
		3.A.1.3 Krijimi I nje sistemi monitorimi ambiental
		3.A.1.4 Zone mbrojtese per te limituar fenomenin e shpyllezimit
		3.A.1.5 Krijimi I zonave tampon perreth zonave te rrezikshme
		3.A.1.6 Rritja e cilesise se menaxhimit te zonave te mbrojtura nga stafi lokal
3.B Vleresimi i trashegimise natyrore dhe kulturele nga pikepamja turistike	3.B.1 Permiresimi i infrastruktures dhe rritja e investimeve per turizmin natyror(turizmi malor dhe ekoturizmi)	3.B.1.1 Rregullimi dhe permiresimi I plazhit
		3.B.1.2 Vleresimi turistik I Zones malore ne kufi me Kosoven dhe Maqedonine
		3.B.1.3 Sistemimi I zonave pyjore pergjate liqenit
3.C Vleresimi i qendrushem i burimeve natyrore ne terma energjitike dhe te nxjerrjes	3.C.1 Administrim me i mire i ciklit te ujit	3.C.1 Administrim me i mire i ciklit te ujit
	3.C.2 Vleresimi i hidrocentraleve lokal	3.C.2.1 Regjistrimi dhe gjeoreferencimi I centraleve ekzistuese
		3.C.2.2 Tarifa te pershtatshme per konsumin e energjise
	3.C.3 Vleresim lokal i potencialit minerar	3.C.3.1 Vleresim lokal i potencialit minerar

5.2.4 Objektiv Strategjik 4 - Vleresimi i zinxhirit te prodhimit bujqesor

Promovimi i dobët i produkteve vendore është i lidhur pjesërisht me mungesën e integritetit midis komponentëve të ndryshëm të transformimit: territorit, prodhimit, marketingut, trajnimeve. Kjo mungesë kufizon aftësinë për ti dhënë vlerën neto çdo burim potencial për zhvillim ekonomik lokal.




Vlerësimi i ulët mund t'i atribuohet mungesës së formave të perfshirjes dhe mungesës së rrjeteve organizative të brendshme ndërmjet sektorëve ekonomikë dhe vete sektoreve. Thelbesore, në këtë kontekst, është krijimi i një marke, si një element i rëndësishëm për të dhënë identitetin dhe njohjen territorit, si dhe promovimin e markave të produkteve të njohura për veçoritë territoriale. Për krijimin e markës mund të krijohet një sinergji e ngushtë në mes të kërkimit, kërkimit të aplikuar, eksperimentimit, prodhimit, universitetit me trajnimet në fushën e bujqësisë së bashku me prodhuesit vendor. Inovacioni është shumë i rëndësishëm si proces. Nevoja për të nxitur dhe zhvilluar koordinimin dhe integrimin në mes të ndërmarrjeve funksionon edhe për forcimin e shërbimeve për bizneset si një mjet për të përmirësuar konkurrueshmërinë e produkteve. Promovimi i një kulture bashkepunimi në rrjet, kryesisht ka të bëjë me fushat e kërkimit dhe inovacionit, marrëdhëniet me sistemin e kredive dhe iniciativat e ndërkombëtarizimit.

Treguesit kryesore janë si më poshtë:

- Zhvillimi i rritjes së blegtorisë kryesisht në zonat kodrinore e malore;
- Përmirësimi dhe vlerësimi i zinxhirit bujqësor deri në krijimin e një Marke;
- Rregullime në administrimin e Zonave Pyjore

Diagrami i mëposhtëm tregon strategjinë për sistemin bujqësor që rrjedh nga analiza SWOT dhe përpunimi i elementeve të përshkruar më sipër:






Figura 6: Sistemi Bujqesor



Per cdo program strategjik janë identifikuar veprime e projekte te qëndrueshme dhe funksionale ne arritjen e objektivi strategjik, të cilat do të përshkruhen në shtojcën e bashkangjitur *Bashkengjitur.01 - Skedat e Projekteve Strategjike*

PROGRAMI STRATEGJIK	VEPRIMI	PROJEKTI
4.A Permiresimi i menaxhimit ne sektorit bujqesor	4.A.1 Kualifikimi i krahut te punes	4.A.1.1 Promovimi I eksperiencave te mira agrare
		4.A.1.2 Permiresimi I zinxhireve BIO
	4.A.2 Bashkepunimi dhe koordinimi mes aktoreve te sektorit agrar	4.A.2.1. Promovimi i iniciativave private për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit bujqësor
		4.A.2.2 Krijimi i pikave të reja për mbledhjen dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale
		4.A.2.3 Krijimi I markave/Certifikatat e cilesise
	4.A.3 Permiresimi I procesit prodhues	4.A.3.1 Zhvillimi i infrastrukturës bujqësore
		4.A.3.2 Masa agroteknike per permiresimin e terrenit bujqesor
		4.A.3.3 Rekuperimi dhe shtimi I rrjeteve ujtese
		4.A.3.4 Legalizimi I pronave bujqesore
		4.A.3.5 Identifikimi i zonave të zhvillimin e peshkimit

5.3 Strategjia insediative


Duke u nisur nga vizioni dhe nga objektivat strategjike eshte percaktuar strategjia e vendndodhjeve qe pervec se pershkruan strukturen territoriale, jep dhe udhezime operative per hapin e ardhshem (faza3) te pregatitjes se Planit Vendor Urban. Strategjia e vendndodhjeve vjen ne renie si në nivel territorial ashtu dhe në nivel urban te qendrës kryesore të Kukësit.

Strategjia për sistemin insediativ Kukës ofron strukturimin e vendbanimeve në mënyrë që ato të kontribuojnë për:

- ✓ Per te forcuar hierarkinë e sistemeve urbane në mënyrë që të optimizohet lokalizimi dhe menaxhimi I atrezaturave te shërbimeve sipas kategorive , qasja dhe lëvizshmëria.
- ✓ Per të siguruar që vendbanimet mund të jenë strukturat mbështetëse dhe monitoruese per potencialitet e territoreve dhe promovimin e burimeve të tyre: bujqësore , natyrore, kulturore, logjistike.

Nderkohe për qendrat dhe aglomerimet e sistemit insediativ janë planifikuar:

- Forcimi i rolit të qendrës primare të Kukësit për funksionet e rangut të rajonit, edhe njekohesisht në funksion të rolit të tij te portës për Kosovën;
- Identifikimi dhe forcimi i disa "lokaliteteve kyçe", qendra apo grupe të qendrave të ndërmjetme të mesme, të afta për të përmbushur kërkesën për shërbimet te afersise per popullsinë e përhapur nëper fshatra dhe në aglomerime; këto qendra janë identifikuara në bazë të madhësisë dhe / ose aksesit, si dhe te atrecaturave tashmë të pranishme ne to:
- Ruajtja e lokacioneve të mesme, të klasifikuara si fshatra dhe aglomerime, një karakter kryesisht rural, duke stimuluar ndërhyrje të vogla që synojnë kualifikimin e shërbimeve bazë.



- **Figura 7: Dendësia e banimit për sistemin insediativ të Bashkisë Kukës**

- QENDRAT E BANUARA**
 - Qendra me vlera nderkombetare
 - Qendra me vlera rajonale
 - Qendrat e zjedhura
- MONUMENTET**
 - Natyrore
 - Historike
 - Blu
- ZONAT**
 - Zonat turistike
 - Zonat Agrikulturore - Bletoreale
 - Zonat e konsoliduara
 - Lidhjet kombetare dhe nderkombetare
- ITINERARET NATYRORE**
 - Itinerari alpin
 - Itinerari natyralistik/peisazhistik
- LEVIZSHMERIA**
 - Makine- Tren e parashikuar
 - Makine- Bicklete
 - Makine
 - Bicklete
 - Ujore
- EKONOMIA**
 - Zonat bujqesore
 - Zonat me kullota / Pyje
 - Depozitat e Kromit
 - Depozitat e Metalit
 - Depozitat e Bakrit
 - Industria




Figura 8: Strategjia Kombetare per qarqet Kukes Diber



Sistemi insediativ është e përcaktuar edhe strukturuar me qendër primare Kukësin dhe katër lokalitete të tjera, me funksionin e mbulimit lokal: Shëmri, Nange, Bicaç dhe Shishtavec. Katër lokalitetet kryesore janë "themelet" e territorit, në pikat me dendësi më të madhe të popullsisë, dhe konfigurohen si vende ku ofrohen shërbime baze cilesore. Përveç dendësisë së popullsisë, këto qendra janë përzgjedhur duke kontrolluar sasinë e popullsisë të arritshme me një kohë udhëtimi prej jo më shumë se 30 minuta. Ky prag është identifikuar prej pragut minimal të përcaktuar në Planin Kombëtar për arritjen e qendrave primare, ku janë të lokalizuara funksionet kryesore, nga ato sekondare. Secila nga këto qendra specializohet gjithashtu në varësi të burimeve që i përkasin asaj pjese të territorit, duke luajtur kështu rolin e "referencës rajonale" për të gjitha aktivitetet që zhvillohen aty:

- Bujqësia, peshkimi dhe blegtoaria, me prodhimet që lidhen me to (përpunimi primar i prodhimeve bujqësore, peshkut dhe qumështit, përgatitja për nxjerrjen në treg), duke siguruar strukturat për modernizimin e tyre dhe kualifikimin inovativ në sektorët organike (strukturat për trajnim dhe hulumtim)
- Turizem i natyrës dhe sportiv, në lidhje me trashëgiminë e pasur natyrore që e lejon një përdorim të gjerë dhe të përhapur gjatë gjithë vitit: hiking, trekking, sportive dimërore, sportet e ujit.
- Turizmi kulturor, në sajë të pranisë së aseteve fikse të tilla si mbetjet e jetës primitive, kështjella, fortifikimeve, kishat dhe banesat tradicionale "Kulla", si dhe të rrjetit të tuneleve dhe bunkerëve në Kukës, ndërtuar në kohën e komunizmit.
- Logjistika dhe trafiku ndër-rajonal dhe ndërkufitar, me të gjitha funksionet që lidhen me to: tregtia, mikpritja, shërbimet, aksesimi dhe promovimi i resurseve lokale në rajon, në mënyrë për ta bërë "tërheqës" dhe lehtësisht i arritshëm të gjithë qarkun dhe për të vlerësuar vecantitë e tij natyrore, historike dhe kulturore.

5.3.1 Sistemi territorial

Sistemi territorial i Kukësit është strukturuar mbi invariantet e medha natyrore: luginat e ngushta të Drinit të Zi (që shkon nga veriu në jug) dhe Drinit të Bardhë (lindje perëndim, në kufi me Bashkië e Pukës dhe Tropojës), në udhëkryqin e të cilave, në pllajen bujqësore, shtrihet qyteti i Kukësit dhe vende të tjera të rëndësishme; në perëndim kodrat e mbuluara me pyje dhe resurse minerale; Më në fund në lindje parku kombëtar Korab-Koritnik.

Kjo ndarje e madhe dhe polarizimi i fortë ekzistues në kryeqendër, formojnë bazën e strategjisë territoriale në lidhje me sistemin insediativ, pare në marrëdhëniet e saj të forta dhe lidhjet me mjedisin dhe peizazhin, dhe politikën për lëvizshmërinë dhe qasjen; strategji që përbëhet nga:


- 1. Përcaktimi i drejtimeve të medha "te gjelber dhe blu"**
- 2. Vlerësimi i pasurisë historike dhe natyrore**
- 3. Përcaktimi dhe vlerësimi i qendrueshëm i sistemeve insediative**
- 4. Përcaktimi i rolit të qendrës kryesore të Kukësit**
- 5. Përcaktimi i lokaliteteve kryesore**



1. PERCATIMI I DRJETIMEVE TE MEDHA "BLU DHE I GJELBER"

Në përputhje me strategjinë e Planit Kombëtar, janë percaktuar "linja e gjelbër dhe blu", si korridore ekologjike rajonale dhe në të njëjtën kohë rrugë kryesore të komunikimit rajonale dhe ndër-rajonal, përgjatë të cilave janë nyjet e shkëmbimit, qendrat kryesore urbane, burimet kryesore natyrore të territorit:

- o *lidhjet gjatësore*: korridori ekologjik dhe shfrytëzues i luginës së ngushtë të Drinit, aks i vërtetë mjedisor për të gjithë territorin, por pak i arritshëm për shkak të formës të territorit, për të cilën strategjia e shfrytëzimit është që të rivendosë kontaktet me ujin; dhe të kualifikojë gjurmet e rrugës rajonale Kukës-Peshkopi dhe SH 31.
- o *lidhjet transversale* për bashkimin e zonave kodrinore dhe malore në lindje dhe në perëndim të nyjes së Kukësit dhe të krijojë një rrjet të rrugëve që lidhin vendbanimet dhe burimet natyrore dhe kulturore: nga SH 5 që lidh Shëmri në Kukës dhe SH 26 bashkimin Kukës e Topojan dhe vazhdon deri sa të arrijë Shishtavec.



- Zonat e mbrojtura
- Rrjeti ekologjik Natyra 2000
- Zonat e gjelberta

Figura 9: Korridoret blu e i gjelber ne strtegjine kombetare per qarqet Kukës e Diber




Figura 10: Drejtimet e gjelber dhe bu



2. VLERESIMI I PASURISE KULTURORE E NATYRORE

Strategjia territoriale synon të të kuptoje dhe vleresoje në sistemet e përdorimit elementet e natyrës dhe trashëgimisë kulturore. Përcaktohet nderkohe një sistem për vlerësimin e rrjeteve të mobilitetit të qëndrueshëm dhe në të njëjtën kohë linjat e gjelbër dhe blu.

Elementet e trashëgimisë natyrore të identifikuar janë: Liqeni i Kukësit, Gryka e Çajës, Guri i Mëngjezit-Shishtavec, Kroji i Kuq-Gjallice, Cirku akullnajor të Zepës, karsti i Arnit, Mështekna e Shishtavecit, kanioni Bicajt, kanioni i Vanave, Kënetës dhe Kukësit, ndërsa në mesin e atyre të trashëgimisë kulturore të një rëndësie të veçantë bashkë me rezidencat: Vendbanimi në Kodrën dhe Peces, Kalaja dhe Gradishta e Bardhocit; kështjella: Kështjella dhe Bushatit, Kalaja e Lekës në fshatin Vau-Spas, Kalaja Hisari në Domaj, Kalaja dhe Kosturit, Kalaja e Viles në Kukës; dhe më në fund shtëpitë tipike të traditës vendore: Banesa dhe Asllan Fetahut, banesa dhe Hasan Rexhepit, banesa dhe Rrustem Shahirit, Shkolla e Vjetër Bicajt, Kulla dhe Shaqir Pulashit, Kulla dhe Ismail Aga Lumes, Kulla e Rezistencës.




Figura 11: Vlerësimi i pasurisë natyrore e kulturore

3. PERCAKTIMI DHE VLERESIMI I QENDRUESHEM I SISTEMEVE TE VENDBANIMEVE

Nyja e Kukësit, ose sistemi insediativ, perbehet nga pajisjet dhe mobiliteti i fushës së Kukësit, për funksionet urbane, prodhimit, shërbimeve dhe lëvizshmërisë, në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Sistemi shtrihet në të gjithë pllajen nga Kukësi në Bicaj, dhe plotësohet me praninë e autostradës për Kosovë dhe aeroportit, lumi në pjesët e tij më lehtë të lundrueshme. "Nyjes së Kukësit" gjithashtu i përkasin qendrat Nange dhe Bicaj, që në strategjinë e territoriale luajnë një rol plotësues në lidhje me kryeqendren, siç shpjegohet dhe më poshte. Nëpërmjet këtij sistemi janë gjithashtu lehtë të arritshme sistemet e tjera të vendbanimeve dhe burimet kryesore natyrore dhe kulturore që karakterizojnë territoret.




Figura 12: Nyja e Kukësit



Sistemi i zones së Shishtavecit, i formuar nga qendrat malore të Parkut Kombëtar Korab-Koritnik; ky sistem i qendrave ka si lokalitete kryesore qendrat e Shishtavecit dhe Novosejes, stacionin e skive në të cilën mund të promovet oferta turistike edhe nëpërmjet rritjes së kapaciteteve pritese, dhe lokalitetin e Topojanit, qender me funksione mbi lokale në fushen e shëndetësise.



Figura 13: sistemi i zones se Shishtavecit

Sistemi i zones së Shëmrise, formuar nga qendrat kodrinore përgjatë SH 5, qendra kryesore e të ciles i referohet Shëmrise, për të vlerësuar si stacion rajonal për shfrytëzimin e turizmit natyror përgjatë luginave të ngushta në Drinit të Bardhë, gjithashtu duke përdorur qendrën e Petkal si një hyrje në fjordin me të afërt të Drinit.



Figura 14: sistemi i përdorimit Shemri

Në fund sistemet lineare të qendrave në ultësirë drejt Kosovës, përgjatë autostradës në drejtim të kufirit (Pobreg, Gjegjan, Bardhë, Bardhë I Ri, Matine) që do të vlerësohen si qendra rajonale për zhvillimin e turizmit të natyrës në Parkun Kombëtar, dhe ato lineare përgjatë SH 31, një nga linjat e gjelbra identifikuar në Planin Kombëtar, i përbërë nga lokalitetet sekondare në jug të rajonit, me karakter kryesisht rural, të cilat si referencë territoriale për aksesin në shërbimet lokale kanë në veri Bicajn, dhe në jug qendrën e Ceren, në rrethin e Dibrës.

4. PERCAKTIMI I ROLIT TE QENDRES PRIMARE TE KUKESIT

Kukësit i është caktuar roli i qendres administrative, për shërbime dhe funksione të vecanta për arsimin e lartë, administratën, shëndetin dhe prodhimin e, përmes të cilit aksesohet në sistemet e përdorimit të cituara dhe në lumin Drin; gjithashtu Hub multimodal i nivelit rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke pasur parasysh praninë e aeroportit dhe autostradës së Kosovës




Figura 15: Kukësi si HUB multimodal i nivelit rajonal, kombëtar e ndërkombëtar



5. PERCAKTIMI I LOKALITETEVE KYESORE

Percaktimi i lokaliteteve kryesore ne brendesi ose ne distance te shkurter nga sistemet e permendura, identifikuara - siç shpjegohet në hyrje - në përputhje me kushtin e arritjes nga ana e lokaliteteve te tjera me te vogla (brenda 30 ') dhe në funksionin që duhet kryejne per bërjen të aksesueshme dhe të shërbyeshme te burimeveve kryesore të territoreve fqinje:

- **Bicaj dhe Nange**, ne një distancë të shkurtër nga Kukësi, qe, në strategjinë insediative, së bashku kryejnë funksionin e "lidhesve" te zonës me burimet natyrore dhe te trashegimise; në mënyrë të veçantë Nange në drejtim të lumit Drin dhe përgjatë tij, Bicaj në drejtim te malit te Korab-Koritnik, Parkut Kombëtar dhe monumenteve natyrore qe perbëhen nga kanioni, nga gryka, nga ura te gurta dhe burime, duke arritur në Shishtavec, "duke prekur keshtu" pjesët më të paarritshëm malore dhe më të paprekura nga pikepamja natyraliste;
- Qendrat e siperpermendura te Shishtavecit dhe Novosejes, stacioni i skive në të cilat mund te promovohet oferta turistike edhe nëpërmjet rritjes se kapaciteteve pritese, si dhe qendra e Topojanit, e paisur me funksione mbilokale në fushën e shëndetësisë;
- Qendra kryesore e Shëmrise, përgjatë rruges SH 5, nje reference për të gjithë pjesën perëndimore të territorit të rajonit.

Sistemi I përbëre nga këto qendra (pra qendra kryesore e Kukësit dhe katër lokalitetet kryesore) është "i arritshem", prej 43,625 njerëzve, dmth 91% e popullsisë së përgjithshme qe jeton në Bashkine e Kukësit, me një kohë udhëtimi prej jo më shumë se 30 minuta. Qendra kryesore e Cerenit, e vendosur në Bashkine e Dibër, lejon për tu shërbyer, me të njëjtën kohë udhëtimi, 668 banorë që jetojnë në lokalitetet më të largëta rezidente në Bashkine e Kukësit.






Figura 16: Aksesibiliteti ne 30 minuta i Kukësit, Shemrise, Bicaj-Nanges e Shishtavecit

5.3.2 Sistemi urban

Strategjia për qendrën kryesore të Kukësit është ndërtuar në koherencë me strategjinë e përgjithshme për zgjidhjen e sistemit insediativ të Kukësit, i cili parashikon strukturimin vendbanimet në mënyrë që ai të kontribuojë për:

- ✓ forcimin e hierarkisë së sistemeve urbane në mënyrë që të optimizojë pozicionimin dhe menaxhimin e atrecaturave dhe shërbimeve të rangut, qasjen dhe lëvizshmërinë
- ✓ të sigurojë që vendbanimet të mund të jenë strukturat mbështetëse për potencialet e territoreve dhe promovimin e burimeve të tyre: bujqësore, natyrore, kulturore, logjistike etj



Në fakt qëllimi perfundimtar i sistemit të vendbanimeve është që të krijoje një strukturë territoriale kundër shpopullimit, duke qenë se rrethi i Kukësit, së bashku me atë të Dibrës, ka regjistruar normen më të lartë të migrimit, si atij të brendshëm, në zonat perëndimore të kombit - veçanërisht në ato bregdetare dhe nën-bregdetare metropolitane si Tirana – dhe vete Kukësit, si në drejtim të Evropës Perëndimore në vendet fqinje. Prandaj veprimet strategjike kanë për qëllim kufizimin e rënies së popullsisë që do të çonte, me normat e sotme, në humbjen e 31.4% e banorëve deri në 2031, duke siguruar që vendbanimet mund të jenë struktura mbështetëse të territoreve dhe vleresimin e burimeve të tyre : bujqësore, natyrore, kulturore, përdoruese, logjistike. Në këtë kuptim është e rëndësishme të orjentohej ndryshimet territoriale drejt forcimit të hierarkisë së sistemeve urbane, në mënyrë që të optimizohet vendosja dhe administrimi i atrecaturave dhe shërbime të rangut, e aksesit dhe lëvizshmërisë.




Figura 17: Strategjia urbane e kryeqendres

Ndërhyrje ne funksion te nevojave te ndërlimeve egzistuese

Forcimi dhe krijimi i qendrave per zonat urbane ekzistuese

Forcimi dhe krijimi i qendrave per zonat urbane ekzistuese përmes i zonave te karakterizuara nga ndërlimet apo sistemet e ndërlimeve ekzistuese dhe përmes iuar funksionet, përmes iuar e aksesit dhe shfrytëzueshmëria, evitazmin e hapësirave publike penetru, përmes iuar e lidhjeve midis elementeve

- Infrastruktura ne funksion te Universiteteve, kerkimin dhe arsimin
- Infrastruktura ne funksion te administrates publike
- Infrastruktura ne funksion te spitoleve dhe sherbimeve sanitare
- Infrastruktura per sportin, kulturen, argetimin dhe kohën e lire
- Infrastruktura ne funksion te turizmit
- Hapsirat e hapura dhe akses me vlera kolektive
Krijimi i sheshëve, sheshet, bulevardet, rrgonem i lasadave historike dhe te shërbimit
- Infrastruktura ne funksion te sherbimeve dhe te tregtise
- Infrastruktura ne funksion te fese
- Infrastruktura te tjera

Krijimi i qendrave te pajisura urbane

Forcimi i zonave te karakterizuara nga ndërlimet apo te pasura urbane ekzistuese dhe përmes iuar funksionet, përmes iuar e aksesibilitetit ne vend dhe dhe forcuar lidhjet midis elementeve

- Infrastruktura ne funksion te Universiteteve, kerkimin dhe arsimin
- Infrastruktura ne funksion te administrates publike
- Infrastruktura per sportin, kulturen, argetimin dhe kohën e lire
- Infrastruktura per sportin, kulturen, argetimin dhe kohën e lire
Duke perfshire shfrytëzimin e tregut per struktura plazhi, bashkimi amator dhe sportiv, sportet uore amatore
- Infrastruktura ne funksion te turizmit
- Hapsirat e hapura dhe akses me vlera kolektive
Krijimi i sheshëve, sheshet, bulevardet, rrgonem i lasadave historike dhe te shërbimit
- Infrastruktura ne funksion te sherbimeve dhe te tregtise
- Infrastruktura ne funksion te porteve
- Infrastruktura te tjera

Figura 18: Legjienda (ekstrakt)

Kukësi në sistemin insediativ territorial

Qendra e tanishme urbane e Kukësit te Ri ngrihet në bashkimin e dy luginave që mbledhin ujrat e dy lumenjve Drin Zi dhe Drinit të Bardhë, dy rrjedha uji përmes territorit një në drejtimin gjatësor (veri-jug) dhe tjetri tërthor (lindje-perëndim). Qyteti merr rolin e pikës së bashkimit dhe për sistemet insediative dhe infrastrukturore . Aksi tërthor shkon nga perëndimi në lindje SH5 dhe lidh Tiranën, dhe pjesën perëndimore të vendit me Kosovën (Prizrenin) nëpër qendrat Pobreg, Gjegjan, Bardhoc, Bardhoc i Ri, Matine; ndërsa në drejtimin gjatësor, në jug, SH31 shkon deri në Peskopi dhe Maqellarë nëpër një rrugë që kalon nga Nange dhe Bicaj.

Pozicioni qendror në lidhje me sistemet e infrastrukturës, dhe prania e strukturave te mobilitetit te rëndesise se vecante sic eshte aeroporti, i japin qytetit te Kukësit rolin e Hub rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe në pikë e vecante per hyrjen ne Evropën Lindore (Kosova, Serbia, Rumania, etj.)

Aksionet strategjike të zhvillimit territorial lokal te lidhura me sistemin insediativ janë të orientuara për ti dhënë qytetit te Kukësit rolin e gurthemelit ne rang rajonal, nepermjet konsolidimit të shërbimeve parësore dhe të specializuara, keto te fundit te orjentuuar tek sportet dhe përdorimi i mjedisit natyror, si dhe për ti njohur qendrës urbane një rol kryesor në vënien në



evidence te burimeve natyrore dhe vlerës së rëndësishme të peizazhit - mjedisit me objektiv përdorimin e tyre për qëllime turistike.

Veprimet strategjike në qendren urbane

Qendra urbane e Kukësit është rindërtuar nga viti 1976 pas braktisjes së qendrës së vjetër, zhytur për shkak të rritjes së nivelit të pellgut të ujit si rezultat i ndërtimit të digës Fierzës dhe hidrocentralit. Qendra e tanishme urbane Kukësi i Ri ngrihet në bashkimin e dy lumenjve Drini i Zi dhe Drini i Bardhë mbi pllajën e një gadishulli.

Veprimet strategjike fillojnë me riformulimin e një marrëdhënie në mes të qendrës urbane dhe ujit, një marrëdhënie të pa adresuar plotësisht deri tani edhe për shkak të frekuencës së ndryshimit të nivelit në basene. Prania e rrjedhave ujore ofron mundësi për të rritur aktivitetin në sektorin primar të peshkimit si dhe për të shfrytëzuar përdorimin e kanaleve të lumenjve, si transport i ngadalte nepermjet nje anije transportuese lokale. Prania e ujit si një element i rëndësishëm i peizazhit lejon gjithashtu dhe promovimin e aktiviteteve të lidhura me pushimin dhe kohën e lirë, rekreacion dhe sport, për përdorimin e qëndrueshëm të zonave anës qytetit: sic është rasti i zonës perëndimore tek Parku dhe bulevardit Rruga Zogu i Pare dhe ajo përgjate Rrugës së Tiranës.

Veprimi tjetër është konsolidimi i qytetit të stabilizuar duke potencuar armaturen ekzistuese urbane, rikualifikimin e akseve ekzistuese kryesore të rëndësishme të tillë Rruga ZOGU I PARE, Rruga Dituria dhe Rruga Islam Spahiu apo konsolidimin dhe pajisjen me karakteristika të reja dhe parametra të ri urbane dhe territoriali i rrugëve të tjera që ekzistojnë sot, por me një rëndësi më të vogël të tilla si Rruga Kukësi i Ri. Kjo e fundit është identifikuar në veprimin strategjik, si gjurma më e rëndësishme që lidh nga veriu në jug në mënyrë gjatësore të gjithë strukturën e re urbane duke filluar nga parku multifunksional bujqësor në veri të gadishullit, duke kaluar nëpër zonën e vjetër të prodhimit, duke arritur në qendrën e re urbane të konsoliduar dhe duke përfunduar para pikeprerjes me SH31 në zonën e re prodhuese të konceptuar ekologjikisht.

Pjesa qendrore e rrugës së re mirëpret funksione të reja urbane dhe përmirësimin e atyre ekzistuese, përfundimisht politikave të rigjenerimit urban orientuar në konservimin dhe vlerësimin e ndertimeve historike ose të konsoliduara, në zëvendësimin e ndërtesave të degraduara, mirëmbajtjen dhe mbështetjen e perzierjes funksionale, në atrecimin e hapësirave publike dhe objekteve të rëndësishme, dhe në rivlerësimin e hapësirave boshe.

Përdorimi i rikonceptuar i zonave fundore dhe vlerësimi i rrethave historike dhe tradicionale kanë rolin për të përcaktuar kufinj të ri të ndërtimit.

Në zonat marginale që karakterizohen nga shperdorimi i territorit dhe ndërtimi informal është planifikuar riorganizimi i strukturës së vendbanimeve me ridefinimin e një rrjeti rrugor dhe rrjetit të infrastrukturave; rihvillimi i shtetit ndërtimor ekzistues formal dhe informal, dhe përkufizimi i rrjeteve të reja; rihvillimi i hapësirave të hapura publike dhe private të përdorura dhe të keqpërdorura

Rigjenerimi i zonave që dikur ishin të destinuara për prodhim, të cilat janë të pranishme në pjesën veriore të vendbanimit, konceptohet nëpërmjet futjes së përdorimeve të reja, të qëndrueshme dhe sociale, të orientuar drejt zbutjes së problemit të strehimit, për riformulimin e hapësirave shtëpi-punë, hotelerise, krijimin e qendrave të reja të trajnimit për mbrojtjen dhe zhvillimin e njohurive të artizanatit lokal.

Zona e re e prodhimit do të rivendoset në jug, përgjatë boshtit kryesor Rruga Kukësit i Ri. Marrëdhënia në mes zones së banimit me atë me funksion prodhimi ndërmjetësohet nga një brez ekologjik që lidh njëkohsisht bregun lindor me bregun perëndimor. Riformulimi i ofertës së hapësirës për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve do të zhvillohet në një zonë shumë të arritshme duke pasur parasysh afërsinë me autostradën, duke ndjekur standardet e qëndrueshmërisë mjedisore dhe pajtueshmërisë me peizazhin përmes parimeve të orientuara në zbutjen e ndikimeve vizuale dhe ekologjike, për racionalizimin e cikleve të ujit dhe mbeturinave, të menaxhimit të unifikuar dhe përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të infrastrukturave të përbashkëta.

Strategji dhe projekte pilot

Veprimet strategjike të përshkruara më lart, mund të identifikohen në tre kategoritë e ndërhyrjeve që konsiderohen të rëndësishme dhe prioritetare për të orientuar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

Për çdo kategori janë identifikuar projekte pilot që mund të shpjegojnë në mënyrë me të thjeshtëzuar mjetet e ndërhyrjes:

1. Rigjenerimi ndërtimor dhe mjedisor i zonave industriale
Projekt Pilot: Konvertimi i ish-zonës disused industriale
2. Kthimi i ujit qytetit
Projekt pilot: Rigjenerimi i zonave të bregut dhe paisja me struktura portuale
3. Rigjenerimi ndërtimor dhe ambjental i zonave të banimit
Projekt pilot: Rigjenerimi i bulevardeve urbane dhe ndërtimeve informale

6 PLANI I AKSIONIT

6.1 Matrica e prioriteteve dhe e investimeve te nevojshme

Tabela më poshtë tregon planin e veprimit që paraqet kuadrin sintezës se projekteve te identifikuar në kapitullin e mëparshëm dhe në të cilin tregohen:

- Obiektivi Strategjik
- Programi Strategjik
- Veprimi
- Projekti
- Prioritetet terminologjia kohore e referimit (Periudhe afat shkurtër (5 vjet) - (A Sh); Periudhe afat mesme (5-10) - (A M); Periudhe afat gjate (10) - (A Gj)
- Tipologjia e investimit (Publik – PU; Privat – PR; Miks – PU+PR)
- Vlera e investimit

Shpenzimet maksimale te mëposhtme janë llogaritur në bazë të kriterëve të kostove për njësi mase. Varësisht nga lloji i veprimit / projektit shpenzimet bazë reference duhet të lexohen me vemendjen e mëposhtme:

a) kostoja e realizimit të ndërtimit: Kjo është kostoja mesatare për metër kub. duke përfshirë edhe fitimin e kompanisë dhe përjashton projektimin,

b) kostoja e rrugëve të ndërtimit, shesheve, rrugëve të ciklabel, etj është kostoja mesatare për metër katror apo metra. linear përfshin fitimin e ndërmarrjes dhe përjashton projektimin

c) Shpenzimet e kurseve të trajnimit ose të ngjashme: është kostoja parametrizuar për nxënës / përdoruesi, duke përfshirë shpenzimet për çdo qira të klasave, kompensim të stafit të përkushtuar, shpërblimit për mësuesit, etj

d) kosto e realizimit të rrjeteve nëntokësore: kjo është një kosto mesatare për m.linear përfshirëse e fitimit të ndërmarrjes,

e) shpenzimet e projektimit urban apo ndërtim arkitektonik: kjo është një kosto një tantum, duke përfshirë inspektimet dhe prodhimin e përpunimeve, etj

f) kosto e ripyllezimit ose sitemimit te terreneve : behet fjale per nje kosto te parametruar ne m.katror qe perfshin fitimin e firmes

Të gjitha shpenzimet nuk marrin në konsideratë tarifatat dhe taksat ligjore si dhe ngjarje të paparashikuara.



Programi Strategjik	VEPRIMI	PROJEKTI	VLERA E INVESTIMIT	PRIORITETET PERIUDHE AFAT SHKURTËR, MESME, GJATE	INVESTIM PUBLIK OSE PRIVAT	
Objektivi Strategjik 1						
Një cilësi e mirë e jetesës në territorin e Kukësit						
1.A Rritja e cilësisë urbane të Bashkisë Kukës	1.A.1 Shtimi i numrit dhe l cilësisë së shërbimeve	1.A.1.1 Permiresimi i rrjetit nentokesor	Shiko piken 11	A Gj	Pu	
		1.A.1.2 Zhvillimi i infrastruktures sanitare baze	Hipoteza: ndërtimit dhe pajisjes së një klinike: 100.000Euro + kostot e menaxhimit dhe të pajisjeve shpenzimet në vit për person 30.000Euro	A M	Pu	
	1.A.2 Kualifikimi i zonave qendrore	1.A.2.1 Rikualifikimi i bulevardit	Sipas nje projekti qe duhet percaktuar _ Vleresimi 100 Euro per mq	A M	Pu	
		1.A.2.2 Rikualifikimi i lidhjes hotel-qender	Rruge kembesore _Sipas nje projekti qe duhet percaktuar _ Vleresimi 100 Euro per mq	A M	Pu	
		1.A.2.3 Rikualifikimi i zones se molit	Zona e Molit_ Pontile ne dru_ Sipas nje projekti qe duhet percaktuar _ Vleresimi 100 Euro per mq	A Gj	Pu+Pr	
		1.A.2.4 Rikualifikimi i qendres se Shishtavecit	Projekt dhe sistemim i sheshit_ Sipas nje projekti qe duhet percaktuar _ Vleresimi 100 Euro per mq	A M	Pu	
	1.A.3 Percaktimi i hierarkise se qendrave te banuara	1.A.3.1 Percaktimi i shërbimeve minimale baze sipas hierarkise së qendrave të banuara.	Per tu percaktuar	I vazhdueshem	Pu	
		1.A.3.2 Zhvillimi policentrik dhe percaktimi i zonave urbane paresore	Per tu percaktuar	I vazhdueshem	Pu	
	1.B Vleresimi i zonave bosh/te paperdoruar	1.B.1 .Rigjenerimi i zonave te boshatisura/ te braktisuara dhe nga kendveshtrimi i trashegimise kulturore.	1.B.1.1 Rikualifikimi i zones industriale te zbrazur (rikualifikim urban)	Rilindja urbane/ Sipas nje projekti qe duhet percaktuar _ Vleresimi 100 Euro per mq.per rruge e sheshe _ 500 Euro per mq. per Ristrukturimet ndertimore	A M	Pu+Pr
			1.B.1.2 Rikualifikimi i hotelit te zbrazur KUKES	Ristrukturimi i hotelit/ Sipas nje projekti qe duhet percaktuar _ Vleresimi 500 Euro per mq	A M	Pr
1.B.1.3 Vleresimi i objekteve nentokesore te mbrojtjes.			Sipas nje projekti qe duhet percaktuar _ Vleresimi 250 Euro per mq _ Duhet nje harte e qytetit nentokesor	A Gj	Pu	



	1.B.2 Permiresimi i lidhjeve ndermjet zones industriale dhe qendres.	1.B.2.1 Lidhja e zones se rivleresuar (ish zona industriale e zbrazur) me zonen e qendres dhe rrugen panoramike.	Rruge pedonale/ Sipas nje projekti qe duhet percaktuar _ Vleresimi 100 Euro per mq	A Sh	Pu
1.C Minimizimi i abuzivizmit dhe i lagjeve informale	1.C.1 Rritja dhe permiresimi i cilesise se sherbimeve (si 1.1.1)	1.C.1.1. Hedhja ne harte e sherbimeve egzistuese(formale dhe informale).	Studim qe i duhet besuar profesionisteve / 30.000 Euro per harten dhe relievin informatik	A Sh	Pu
	1.C.2 Plani per ndertimet sociale	1.C.2.1 Ndertimet sociale	Projekt dhe realizim Banesa per familje ne nevoje_ 250Euro/mc	A Sh	Pu
	1.C.3 Sistemimi i lagjeve informale.	1.C.3.1 Sistemimi i lagjeve informale.	Projekt per tju besuar profesionisteve/ 30.000Euro	A M	Pu
Objektivi Strategik 2					
Nje akses me i mire ne brendesi te territorit te Kukesit dhe vleresimi i lidhjeve nder-rajonale dhe nderkufitare					
2.A Rritja e cilesise dhe eficenses se sherbimeve	2.A.1 Menaxhimi i mbetjeve	2.A.1.1 Menaxhimi i mbetjeve	Per tu percaktuar	A M	Pu
	2.A.2 Permiresimi i rrjetit te ujesjellesit	2.A.2.1 Permiresimi i rrjetit te ujesjellesit	100 € per meter linear	A M	Pu
	2.A.3 Permiresimi i rrjetit te kanalizimeve	2.A.3.1 Permiresimi i rrjetit te kanalizimeve	100 € per meter linear	A M	Pu
	2.A.4 Permiresimi i menaxhimit te burimeve te disponueshme		2.A.4.1 Permiresimi i teknologjise në nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve	Ne ngarkim te pronareve private te	A M - A Sh
2.A.4.2 Projektimi i parqeve energjistik(energjia e diellit dhe e erez)			50.000 €	A M	Pu
2.B Permiresimi i aksesibilitetit	2.B.1 Permiresimi i organizimit te transportit publik	2.B.1.1 Permiresimi i organizimit te transportit publik	Rinovimi i parkut te mjeteve / 100.000_Euro per mjet	A M	Pu
	2.B.2 Permiresimi i	2.B.2.1 Vleresimi i gjendjes se rrjetit rrugor	Projekt per tju besuar profesionisteve/ 50.000Euro	A M	Pu
		2.B.2.2 Mirembajtja dhe permiresimi i rrugëve te	Sipas nje projekti / Vleresimi 100Euro per mq.	A M - A Sh	Pu



	rrjetit rrugor ekzistues	pakalueshme			
		2.B.2.3 Reduktimi i numrit te rrugeve te paasfaltuara	Sipas nje projekti / Vleresimi 100Euro per mq.	A M - A Sh	Pu
	2.B.3 Krijimi i rrugeve te bicikletave	2.B.2.4 Zgjerimi dhe mirembajtja e rrugeve urbane dhe e ndricimit te tyre	Sipas nje projekti / Vleresimi 100Euro per mq.Ndricim publik i realizueshem 2000 Euro per pike ndricimi	A M - A Sh	Pu
		2.B.3.1 Zhvillimi i projekteve të infrastrukturës ndërkufitare mbi temen e levizjes së qëndrueshme	Pista ciklabel / 100 Euro per m. linear	A M - A Sh	Pu
2.B.4 Vleresimi i lidhjeve nderkombetare	2.B.4.1 Zhvillimi i projekteve per transportin nderkufitare dhe per infrastrukturen	Linja autobus te dimensioneve te vogla / 100.000Euro per mjet/ 30.000Euro per shofer /vit	A M - A Sh	Pu	

2.C Zhvillimi i sitemit ekonomik	2.C.1 Krijimi i paketave turistike rajonale	2.C.1.1 Mundesi itineraresh rajonal per eksplorimin e vlerave historike dhe natyrore	Realizimi i kalimeve kembesore / 100Euro per m. linear	A M	Pu
	2.C.2 Pakete turistike rajonale	2.C.2.1 Krijimin e paketave turistike qe perfshijne Kukusin, Prizrenin, Tropojen e Gjakoven	Projektim i paketave turistike / ne ngarkim te privateve	A M	Pr
	2.C.3 Ritja e mundesise se shkollimit	2.C.3.1 Shkollimi profesional(turizem, gastronomi, agrikulture)	Kurse profesionale /500 euro per kursant simestrale duke perfshire leksionet me docente , kosto jete	A M	Pu
		2.C.3.2 Permiresimin e infrastruktures se sitemit parashkollor dhe shkollor	Kopshte / zbatimi 250 euro për metër kub. + Kushton Personeli 30.000Euro në vit për person	A M	Pu

Objektivi Strategik 3**Vleresimi i qendrueshem i burimeve ambjentale si ne terma turistike dhe energjitike e minerare**

3.A Menaxhim dhe mbrojtje me e mire e sitemit ambjental	3.A.1 Rritja e kontrollit dhe e mbrojtjes së mjedisit	3.A.1.1 Parandalimi i ndotjes se ajrit dhe ujit si pasojë e shfrytëzimit të mineraleve	Fushate monitorimi / 50.000Euro _ Realizimi i depuratorit 130Euro per person	A M - A Sh	Pu
		3.A.1.2 Krijimi dhe permiresimi i Korridoreve ekologjike përgjatë luginave dhe përgjatë zonave të mbrojtura	Sistemime agro-pyjore 1,0 Euro per mq.	A M - A Sh	Pu
		3.A.1.3 Krijimi i nje sistemi monitorimi ambjental	Central monitorimi / Qera 3500 Euro ne muaj	A Gj	Pu
		3.A.1.4 Zone mbrojtese	Sistemime agro-pyjore 1,0 Euro per mq.	A Gj	Pu



		per te limituar fenomenin e shpyllezimit			
		3.A.1.5 Krijimi i zonave tampon perreth zonave te rrezikshme	Sinjalizime vizive / 300Euro per shtylle ose 50Euro per mq per rrethimet	A Gj	Pu
		3.A.1.6 Rritja e cilesise se menaxhimit te zonave te mbrojtura nga stafi lokal	Formacioni dhe modulet per tu percaktuar	A Gj	Pu
3.B Vleresimi i trashegimise natyrore dhe kulturele nga pikepamja turistike	3.B.1 Permiresimi i infrastruktures dhe rritja e investimeve per turizmin natyror (turizmi malor dhe ekoturizmi)	3.B.1.1 Rregullimi dhe permiresimi i plazhit	Sipas nje projekti / Vleresimi 50 Euro per mq.	A Gj – A M	Pu
		3.B.1.2 Vleresimi turistik i Zones malore ne kufi me Kosoven dhe Maqedonine	Shtigjet / 10 Euro per m. linear perfshi dhe kartolerine	A Gj – A M	Pu
		3.B.1.3 Sistemimi i zonave pyjore pergjate liqenit	Sistemime agro-pyjore 1,0Euro per mq.	A Gj – A M	Pu
3.C Vleresimi i qendrueshem i burimeve natyrore ne termat e energjise dhe nxjerrjes	3.C.1 Administrim me mire i ciklit te ujit	3.C.1 Administrim me mire i ciklit te ujit	Per tu percaktuar	A M	Pu
	3.C.2 Vleresimi i hidrocentraleve lokal	3.C.2.1 Regjistrimi dhe gjeoreferencimi i centraleve ekzistuese	Realizimi i studimeve specifike – 30.000 €	A Gj – A M	Pu
		3.C.2.2 Tarifa te pershtatshme per konsumin e energjise	Politike per tu aktivizuar	A Gj – A M	Pu + Pr
	3.C.3 Vleresimi lokal i potencialit minerar	3.C.3.1 Vleresimi lokal i potencialit minerar	Per tu percaktuar	A M	Pu + Pr
Objektivi Strategik 4 - Vleresimi i zinxhirit te prodhimit bujqesor					
4.A Permiresimi i menaxhimit ne sektorit bujqesor	4.A.1 Kualifikimi i krahut te punes	4.A.1.1 Promovimi i eksperiencave te mira agrare	Kurse profesionale/ 500 Euro per kursant per kurse simestraleqe perfshin leksionet me docent dhe kosto jete	A M	Pu
		4.A.1.2 Permiresimi i zinxhireve BIO	Kurse profesionale/ 500 Euro per kursant per kurse simestraleqe perfshin leksionet me docent dhe kosto jete	A M	Pu
	4.A.2 Bashkepunimi dhe koordinimi mes aktoreve te sektorit agrar	4.A.2.1. Promovimi i iniciativave private per zhvillimin e mtejshem te sektorit bujqesor	Per tu percaktuar	A M	Pu+Pr
		4.A.2.2 Krijimi i pikave te reja per mbledhjen dhe ruajtjen e produkteve bujqesore dhe blegtorale	Mbledhja dhe konservimi i prodhimeve bujqesore / Realizimi i nje strukture te pershtateshme 200 Euro per	A M	Pu+Pr





	4.A.2.3 Krijimi i markave/Certifikatat e cilesise	Krijimi i nje marke /lenia ne ngarkim nje studioje te specializuar/50.000 Euro nje tantum	A M	Pu+Pr
4.A.3 Permiresimi i procesit prodhues	4.A.3.1 Zhvillimi i infrastrukturës bujqësore	Per tu percaktuar	A Gj – A M	Pu+Pr
	4.A.3.2 Masa agroteknike per permiresimin e terrenit bujqesor	Informim i kutivuesve direkt/kurse specializimi 250 Euro per person	A Gj	Pu
	4.A.3.3 Rekuperimi dhe shtimi i rrjeteve ujtese	Projektimi 30.000 Euro	A Gj	Pu
	4.A.3.4 Legalizimi i pronave bujqesore	Politike per tu implementuar	A Gj	Pu+Pr
	4.A.3.5 Identifikimi i zonave të zhvillimit e peshkimit	Projekti per identifikimin ... / 30.000Euro	A Gj	Pu+Pr



7 SKEDAT E PROJEKTEVE STRATEGJIKE

Për çdo projekt strategjik janë hartuar disa skeda për zbatimin që përcaktojnë:

- objektivat e projektit
- permbajtja e projektit
- pika kritike ose lidhjeje me projekte te tjera
- aktoret ne termat e perfituesve dhe zbatuesve
- kohet
- kostot

Për projektet strategjike t shkalles urbane që marin rëndësi të veçantë për zhvillimin e territorit, janë hartuar projekte specifike pilote në të cilat është bërë e mundur edhe grafikiisht paraqitja e shtrirjes në terma fizike dhe hapësinore.

Bordet e projekteve strategjike janë dhënë në *"Bashkengjitur.01-Skedat e Projekteve Strategjike"*.

Këto projekte pilot janë dhënë në *"Bashkengjitur.02-Albumi e Projekteve Pilot"*.



